

RAPORT VJETOR PËR TE

DREJTAT E NJERIUT

NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT
PËR VITIN 2020



KOMITETI I
HELSINKIT PËR
TË DREJTAT E
NJERIUT



Botues

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, përfaqësuar nga kryetarja
Prof. Dr. Neda Zdraveva

Redaktimi

Uranija Pirovska

Përkthimi

Luljeta Jusufi

Dizajni

RSI Copy



Ky projekt është mbështetur financiarisht nga Bashkimi Evropian.



Ky raport u hartua me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij raporti është në përgjegjësi ekskluzive të autorëve dhe në asnjë mënyrë nuk mund të konsiderohet se i përfaqëson qëndrimet e Bashkimit Evropian.

PËRMBAJTJA

HYRJE	4
NDIHMA JURIDIKE FALAS	7
TË DREJTAT E PUNËTORËVE	8
GRATË PUNËTORE NË INDUSTRIJË E TEKSTILIT	21
DISKRIMINIMI	25
PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA.....	33
BARAZIA GJINORE	38
SISTEMI GJYQËSOR	44
INSTITUCIONET E MBYLLURA	47
GJUHA E URREJTJES	51
VEPRA NGA GJUHA E URREJTJES	58
QENDRA PËR MBËSHTETJE LGBTI.....	61

HYRJE

Kriza shëndetësore me përmasa globale e vitit 2020 ka sjellë botën në një gjendje pasigurie dhe frike, me pasojë të shumta sociale dhe ekonomike. Masat për të mbrojtur shëndetin publik dhe përpjekjet për të parandaluar përhapjen e koronavirusit në mënyrë të pashmangshme patën përparësi mbi të drejtat dhe liritë e qytetarëve. Miratimi i vendimeve për karantinë dhe orë policore nënkuptonte gjithashtu një shkelje të drejtëpërdrejtë mbi të drejtat themelore të njeriut, siç është lëvizja e lirë. Sidoqoftë, duke pasur parasysh dinamikën me të cilën u përhap pandemia Sars Cov 19 dhe shumë të panjohurat që lidhen me natyrën e saj, këto kufizime u pranuan gjerësisht si një "e keqe e domosdoshme". Një analizë më e thelluar e efekteve të krizës globale mbi situatën me të drejtat e njeriut mbetet për t'u parë, duke pasur parasysh implikimet e thella të krizës në konstelacionet politike dhe ekonomike brenda dhe midis vendeve. Por mbetet përfundimi, i cili u imponua qysh në muajt e parë të krizës - se njerëzit e varfër dhe të marginalizuar ishin dhe janë ende në mënyrë disproporcionale më të prekur nga gjendja e krizës. Këtë e dëshmon edhe numri rekord i kërkesave për ndihmë juridike falas të parashtruara në Komitetin e Helsinkit gjatë vitit pandemik 2020.

Shkeljet e rënda të të drejtave të punëtorëve filluan menjëherë pas shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme, kur disa ndërmarrje filluan të pushonin punonjësit nga puna përpara se të ndjeheshin efektet reale të krizës. Shumica e numrit të rasteve të denoncuar në Komitet kishin të bënin me ndërprerjen e kontratave të punës, ndërprerjen e detyruar të marrëdhënies së punës, dhe uljen dhe mospagimin e pagave. Shpesh ishin shkelur edhe masat qeveritare për të parandaluar dhe mbrojtur nga koronavirusi, kurse gratë punëtore në industrinë e tekstilit ishin ndër më të ekspozuarat për nga rreziku shëndetësor për shkak të kushteve të papërshtatshme të punës dhe transportit deri në vendin e punës.

Krizës nuk i munguan as përfitimet e institucioneve private të kujdesit shëndetësor, por edhe format e tjera të keqpërdorimit të situatës së krizës. Rastet e përfitimit të paligjshëm nga ndihma buxhetore u vunë re gjatë zbatimit të masave-paketë kundër krizës të Qeverisë së RMV-së, përkundër thirrjeve të shumta se qëllimi i mbështetjes financiare të shtetit duhet të ishte ruajtja e vendeve të punës.

Sa i përket ndryshimeve në legjislacionin e punës, megjithëse Ligji i ri për Marrëdhëniet e Punës filloi të hartohet në gjysmën e parë të vitit 2018, ai nuk hyri në procedurën parlamentare as në vitin 2020. Në muajin dhjetor, teksti i ri i Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna ndaj Grave dhe Dhuna në Familje hyri përsëri në procedurën parlamentare, por nuk u miratua deri në fund të vitit. Sidoqoftë, më në fund u miratua Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, pas një procesi të mundimshëm dhe pengesave të shumta, të cilat prekën më së shumti ata që duhet të mbrohen nga këto dispozita ligjore. Komisioni për parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi, si një mekanizëm mbrojtës, ishte i paarrtshëm për qytetarët nga gushti i vitit 2019 dhe gjatë gjithë vitit 2020, gjë që uli mbrojtjen efektive nga diskriminimi.

Gjatë vitit 2020, Komiteti i Helsinkit vazhdoi të monitoronte reformat dhe punën e gjyqësorit si një anëtar aktiv i Grupit Blueprint. Lidhur me procedurat e përgjithshme për miratimin e zgjidhjeve të reja ligjore, procesi i miratimit të disa prej ligjeve u vlerësua si transparent dhe gjithëpërfshirës, gjë që kontribuon në rritjen e besimit të qytetarëve në institucionet gjyqësore, por në disa prej ligjeve, procedura dhe procesi i miratimit të zgjidhjeve të reja ligjore nuk u vlerësua pozitivisht. Pjesa më e madhe e ligjeve, të parapara për miratim me Strategjinë për Reformën e Sektorit Gjyqësor (2017-2022), të cilët u miratuan dhe hynë në fuqi në periudhën e kaluar, zbatimi i zgjidhjeve ligjore në praktikë vlerësohet si korrekt dhe me kohë. Ministria e Drejtësisë gjithashtu ndërmori aktivitete të rëndësishme në mënyrë që të promovojë Ligjin për Ndhimën Juridike Falas dhe për të rritur shkallën e informimit të qytetarëve. Mirëpo, ka vërejtje sa i përket procesit të zbatimit të Ligjit për Prokurorinë Publike, Ligjit për Kontestet Administrative, Ligjit për Këshillin Gjyqësor të RMV-së, si dhe pjesëve të Ligjit për Ndhimën Juridike Falas.

Më 25 mars 2020, Këshilli i Bashkimit Evropian, bazuar në rekomandimet e Komisionit Evropian, pa kushte mori një vendim politik për fillimin e negociatave për anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian. Në të njëjtën kohë, Komisioni Evropian mori përsipër të përgatisë kornizën negociuese në kohën më të shkurtër të mundshme në përputhje me metodologjinë e re të negociatave. Kjo konfirmoi përsëri rëndësinë e Kapitullit 23 - Gjyqësori dhe të Drejtat Fundamentale si një bazë kryesore në përparimin e negociatave, si dhe ndikimin e tij në procesin e përgjithshëm të përafrimit. Prandaj, monitorimi i progresit të organizatave të shoqërisë civile në Kapitullin 23 është e një rëndësie thelbësore. Duke marrë parasysh këtë dhe duke ndjekur zhvillimet e ngjarjeve, Komiteti i Helsinkit bëri thirrje për respektimin e të drejtave të njeriut duke informuar me kohë dhe në mënyrë transparente publikun me informacion të saktë në mënyrë që të rritet mbikëqyrja publike ndaj pushtetit ekzekutiv gjatë gjendjes së jashtëzakonshme.

Përkundër përpjekjeve të presidencës gjermane dhe negociatave intensive midis delegacioneve nga Republika e Maqedonisë së Veriut dhe Republikës së Bullgarisë, më 16 nëntor, Këshilli i Bashkimit Evropian nuk arriti të vendosë njëzëri për fillimin e negociatave dhe mbajtjen e konferencës ndërqeveritare në muajin dhjetor. Megjithatë Bullgaria ka insistuar të përfshijë kërkesat e saj në kornizën e negociatave, megjithatë vendet e tjera anëtare kanë hedhur poshtë njëzëri këtë kërkesë bullgare. Bashkimi Evropian, i përfaqësuar nga presidenca gjermane, theksoi se çështjet dypalëshe duhet të mbahen jashtë kornizës negociuese.

Në planin politik, gjithashtu dominoi edhe debati mbi mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare më 15 korrik. Konstatimet paraprake të OSBE/ODIHR-it përmes misionit të tyre të vëzhgimit vunë në dukje se zgjedhjet e parakohshme parlamentare u kryen përgjithësisht në mënyrë efektive megjithë adaptimeve si përgjigje ndaj pandemisë, dhe që stabiliteti juridik u çrregullua nga rishikimet thelbësore të Kodit Zgjedhor dhe rregullativës vijuese ad hoc të miratuar gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme. Fushata, megjithatë me një ton negativ, ishte me të vërtetë konkurruese dhe pjesëmarrësit ishin në gjendje të përçonin mesazhet e tyre pavarësisht kufizimeve në komunikimin e zakonshëm.

Në një vit të dominuar nga tendencat negative në shumë fusha të jetës njerëzore, ne jemi dëshmitarë të dy rezultateve pozitive sa i përket përfaqësimit ndërkombëtar - aktgjykimi për rastin e Leonit të vogël, çështja e të cilit krijoi një precedent për shkak të pranimit të një aplikimi në emër të një të mituri me aftësi të kufizuara, pa qenë në gjendje të jep dakordin që të përfaqësohet para Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. Suksesi i dytë është ankesa/kundërshtia, e cila u parashtrua vitin e kaluar nga Komiteti i Helsinkit në Komitetin CEDAW¹, i cili më pas konstatoi padrejtësi dhe i dha rekomandime shtetit për ndryshime strukturore dhe çrënjosjen e praktikave të dëmshme në aksesin në shërbimet gjinekologjike për gratë romë. Diskriminimi i shumëfishtë sistematik i romëve në Maqedoninë e Veriut në vitin 2020 u manifestua edhe përmes rasteve të brutalitetit policor ndaj anëtarëve të këtij komuniteti, si dhe mungesës së qasjes në ujë të pastër, materialeve sanitare dhe kujdesit shëndetësor në kushtet e një pandemie.

Mbyllja e qendrave të kujdesit ditor, mësimi në distancë i papërshtatur, si dhe pamundësia e distancës sociale për njerëzit e varur nga mbështetja në kryerjen e nevojave të përditshme, janë vetëm disa nga sfidat me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara. E vetmja rrethanë lehtësuese për ta ishte përjashtimi nga vendimet që parandalojnë lëvizjen, si dhe vendimet e qeverisë për të zvogëluar procedurat administrative.

Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve në përgjithësi është përballur mirë me pandeminë e shkaktuar nga Sars Cov 19. Në verë, gjatë një periudhe masash të zbutura kufizuese, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj kryen vizita në terren për të monitoruar situatën në të gjitha burgjet dhe institucionet ndëshkimore-korrektuese. Përveç sfidave të zakonshme me të cilat përballen këto institucione, ekipet

¹ Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave është një organ i ekspertëve të pavarur të KB-së që mbikëqyr zbatimin e Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave.

dokumentuan edhe situatën e kujdesit shëndetësor dhe të drejtat e personave të dënuar, të drejta të cilat duhet t'i gëzojnë edhe gjatë kohës së pandemisë.

Një seri masash kufizuese që përfshinë të gjithë popullsinë, përfshirë rekomandimet për vetë-izolim, kanë rritur seriozisht rrezikun e sjelljes së dhunshme në shtëpi. Këto parakushte për dhunën në familje pasohen nga stresi i shkaktuar nga ekzistenca e pasigurt dhe jeta e vështirë e përditshme e njerëzve. Shtëpia nuk është e sigurt për shumë gra, por edhe për shumë njerëz të komunitetit LGBTI të cilët u detyruan të jetojnë në një mjedis homofobik dhe të dhunshëm për shkak të kufizimit të lëvizjes. Nga problemet që i sjell shëndeti i rrezikuar mendor, e deri te masat e llojllojshme për të parandaluar virusin, ky ishte padyshim një vit i vështirë për komunitetin LGBTI.

Stresi nga ekzistenca e rrezikuar, mbyllja e kopshteve, shkollave dhe institucioneve dhe objekteve të tjera publike, e ardhmja e pasigurt, ndikoi fuqishëm në shëndetin fizik dhe mendor të qytetarëve dhe zhvendosi dinamikat kolektive në shoqëri. E gjithë kjo u pasqyrua edhe në komunikimin publik, me tone të intensifikuara negative, veçanërisht në rrjetet sociale. Në vitin 2020, ne regjistruam një rritje prej 130% të denoncimeve të gjuhës së urrejtjes krahasuar me vitin paraprak. Edhe më tej dominon urrejtja në baza etnike, e ndjekur nga përkatësia politike dhe orientimi seksual. Për fat të keq, kriza ka krijuar një bazë të re për gjuhën e urrejtjes - gjendjen shëndetësore. Lidhur me denoncimet tona të pranura të gjuhës së urrejtjes, përgjigja përkatëse nga institucionet kompetente, veçanërisht nga Prokuroria Publike, ende mungon. Një sjellje e tillë e papranueshme e organeve të akuzës u vu re në çështjen Dhoma Publike, e cila u zbulua në muajt e parë të vitit 2020, për të cilën çështje prokuroria nuk ndërmori asgjë deri në fund të vitit. Mosndëshkimi la të hapur mundësinë e përsëritjes së rasteve të tilla të abuzimit dhe ngacmimit seksual të grave dhe vajzave.

Ndarjet shoqërore të rrënjosura në shoqëri u manifestuan që nga fillimi i trajtimit të pandemisë. Jo vetëm ndarjet klasore, por edhe ato gjinore, seksuale, madje edhe ndarjet sipas moshës. Dhe evazioni i mekanizmave të solidaritetit ndërkombëtar në shpërndarjen e vaksinave, i cili u vu re në fund të vitit, paralajmëroi rrjedhën e paqartë të mëtejshme të luftës kundër rrezikut global dhe zgjerimin e hendekut midis të fuqishmit dhe të pafuqishmit edhe në rrafsh global. Viti 2021 do të jetë padyshim një vit i luftës së gjatë kundër koronavirusit. Ne vetëm mund të shpresojmë se kjo do të sjellë rimëkëmbjen e njerëzve dhe komuniteteve, por edhe një rimendim dhe riformësim të prioritetëve të njerëzimit.

NDIHMA JURIDIKE FALAS

Që nga themelimi i tij në vitin 1994, Komiteti i Helsinkit ka punuar për forcimin ligjor dhe mbështetjen juridike të qytetarëve. Komiteti është regjistruar që nga viti 2016 si një shoqatë e autorizuar për ofrimin e ndihmës juridike primare, në përputhje me Ligjin për Ndhmën Juridike Falas.

Që nga fillimi i pandemisë në vitin 2020, Komiteti i Helsinkit ka regjistruar një rritje të konsiderueshme të kërkesave për ndihmë juridike falas. Gjatë vitit, Komiteti ofroi ndihmë juridike për 742 qytetarë (340 burra dhe 402 gra) në fushën e marrëdhënieve të punës dhe qasjes në punësim, dhunës në familje dhe me bazë gjinore, marrëdhënieve familjare, mbrojtjes sociale, diskriminimit, gjuhës së urrejtjes dhe veprave nga urrejtja. Përveç këtyre, në shkallë të madhe u përfaqësuan edhe kërkesat për çështje të shkaktuara direkt ose indirekt nga pandemia - pyetje mbi masat dhe rekomandimet për parandalimin dhe mbrojtjen kundër koronavirusit, si dhe pyetje mbi shëndetin, pasojat ekonomike dhe sociale të pandemisë. Përqindja më e madhe, pra rreth 80 përqind e personave që kërkuan ndihmë, janë anëtarë të bashkësisë etnike maqedonase, pasuar nga anëtarët e komunitetit shqiptar me afërsisht 9 përqind të kërkesave dhe komuniteti rom me 4,5 përqind.²

Për më tepër, në vitin 2020 ne kemi parashtruar tri kërkesa për ndihmë juridike dytësore në Ministrinë e Drejtësisë, për kthimin në zotërim, ndarjen fizike dhe mbështetjen ligjore të një fëmije të mitur. Njëra nga kërkesat e parashtruara ishte aprovuar, njëra ishte refuzuar dhe apeluar para organit të shkallës së dytë, kurse për një kërkesë procedura është në zhvillim e sipër.

Në procesin e ofrimit të ndihmës juridike falas grupeve të marginalizuara dhe të prekura të qytetarëve, Komiteti është përballur me sfida të konsiderueshme. Sidoqoftë, zyra e ndihmës juridike falas mbeti e hapur për aplikantët e ndihmës juridike gjatë gjithë vitit, duke respektuar të gjitha masat dhe rekomandimet për parandalimin dhe mbrojtjen kundër koronavirusit. Më kritikë ishin muajt e parë pas shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme, kur puna duhej të riorganizohej dhe të përshtatej me rrethanat e reja të posakrijuara. Kjo nënkuptonte kufizimin e komunikimit personal, të drejtpërdrejtë me aplikantët. Takimet e drejtpërdrejta me palët realizoheshin vetëm me përgjashtime, veçanërisht në komunikime me njerëz të moshuar, njerëz që jetojnë në varfëri ekstreme, njerëz që vinin nga një vend tjetër, si dhe me njerëz nga kategori të tjera të prekshme.

Gjatë gjithë vitit, Komiteti ka publikuar raporte mujore për situatën me të drejtat e punëtorëve në kushte pandemie. Raportet përgatiteshin në bazë të të dhënave të mbledhura nga kërkuesit e ndihmës juridike dhe mangësive të identifikuara në sistem. Këto raporte monitorimi, të shpërndara në media dhe të botuara në faqen zyrtare të Komitetit, informojnë vendimmarrësit (dhe në veçanti Ministrinë e Drejtësisë, si institucioni kompetent) për rekomandimet tona për përmirësimin e sistemit të ndihmës juridike falas.

² Kocevski G. (2021). *Mbrojtja e të drejtave të njeriut përmes avancimit të ndihmës juridike falas*. Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. I disponueshëm në: <https://mhc.org.mk/publicationsanalyzes/zashitita-na-chovekovite-prava-preku-unapreduvanje-na-besplatnata-pravna-pomosh/>

TË DREJTAT E PUNËTORËVE

*Ми да знаеш, паметуваши
и ет да си на ум иташи –
работник си – и работник
ти ќе паѓаш и се диѓаш.*

*Луѓи ли ќе пушти дојдат
сонце ли ќе јасно грејне –
патимштата, патимштата
пред тебе се на борбата.*

Кого Раџин (1939)³



Kriza shëndetësore e shkaktuar nga koronavirusi i ri shënoi vitin 2020⁴, kurse punëtorët dhe gratë punëtore ishin të parët që u goditën për shkak të trajtimit joadekuat të pasojave të saj, duke i dhënë kësaj situatë karakterin e një krize të punës. Situata e krizës për punëtorët nënkuptonte një luftë për të ruajtur shëndetin e tyre dhe të të dashurve të tyre, por edhe një luftë për të shpëtuar mbijetesën e tyre. Menjëherë pas shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme, ne ishim dëshmitarë të shkeljeve të rënda të të drejtave të punëtorëve dhe një rritje për çdo ditë të numrit të rasteve të tilla.

Kjo është arsyeja pse, gjatë gjithë vitit, Komiteti i Helsinkit vazhdimisht ka ofruar ndihmë juridike falas për të gjithë punëtorët. Të dhënat e regjistruara për shkeljet e të drejtave të punëtorëve u prezantuan dhe u analizuan në raportet mujore,⁵ gjysmë-vjetore⁶ dhe periodike,⁷ në Raportin e veçantë për situatën e të drejtave të njeriut gjatë kohës së

³ Racin, K.S. (1939). Poezi: Elegji për ty. Nova Makedonija, Shkup, 1967- përkthyer nga Lutfi Rusi.

⁴ Sëmundja e shkaktuar nga koronavirusi i ri SARS-COV-2. World Health Organisation. (2020, December 14). *Timeline: WHO's COVID-19 response*. I disponueshëm në: <https://www.who.int/emergencies/diseases/novel-coronavirus-2019/interactive-timeline#> (qasja herën e fundit më 21.3.2021)

⁵ Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. (2020). *Raportet mujore*. I disponueshëm në: <https://mhc.org.mk/mesechni-izveshtai-za-sostojbata-so-chov/>.

⁶ Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. (30 prill 2020). *Situata me të drejtat e punëtorëve, raport gjysmëvjetor 1 nëntor 2019 – 30 prill 2020*. I disponueshëm në: <https://mhc.org.mk/reports/sostojbata-so-rabotnickite-prava-2020/>. Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. (8 dhjetor 2020). *Situata me të drejtat e punëtorëve, raport gjysmëvjetor 1 maj – 31 tetor 2020*. I disponueshëm në: <https://mhc.org.mk/reports/sosto%1%98bata-so-rabotnickite-prava-polugodishen-izveshta%1%98-1-maj-31-oktomvri-2020/>.


⁷ Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. (8 korrik 2020). *Të drejtat e punëtorëve në kohën e koronavirusit – të dhëna të përmbledhura*. I disponueshëm në: <https://mhc.org.mk/reports/rabotnickite-prava-vo-vreme-na-koronavirusot-sumirani-podatoczi-2/>. Për më tepër në *Raportet të veçanta*, I disponueshëm në <https://mhc.org.mk/specijalni-izveshtai/page/3/>.

KOVID-19,⁸ në rishikimin e masave qeveritare për parandalimin dhe mbrojtjen kundër koronavirusit,⁹ si dhe në analizën për punën e Inspektoratit Shtetëror të Punës gjatë kohës së gjendjes së krizës.¹⁰

I. Shkeljet më të zakonshme dhe bazat për veprim në vitin 2020

Gjatë vitit 2020, kemi regjistruar 395 raste të shkeljeve të të drejtave të punëtorëve, të cilët përfshinë të paktën 3368 punëtorë në vendin tonë. Ndihma juridike në rastet e dokumentuara konsistonte në këshillimin juridik, informimin e punonjësve për të drejtat e tyre, fillimin e procedurave administrative, udhëzimet për fillimin e kontesteve gjyqësore dhe monitorimin e proceseve gjyqësore.

Raste të regjistruara						Përfshirja e punëtorëve					
395						3368					
janar	shkurt	mars	pril	maj	qershor	korrik	gusht - shtator	tetor	nëntor	dhjetor	
30/45	16/16	65/1583	85/920	20/218	31/31	27/27	42/400	23/23	21/70	35/35	



MASHKULL 20%

80% FEMER




⁸ Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. (13 tetor 2020). *Raport i veçantë për situatën me të drejtat e njeriut në kohën e Covid-19*. I disponueshëm në: <https://mhc.org.mk/news/poseben-izveshta%20d1%98-za-sosto%20d1%98bata-so-chovekovite-prava-vo-vreme-na-kovid-19/>.

⁹ Petkovska, N. (30 nëntor 2020). *Pasqyrë e masave qeveritare për parandalimin dhe mbrojtjen nga koronavirusi dhe efektet e tij mbi të drejtat e punëtorëve*. Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. I disponueshëm në: <https://mhc.org.mk/reports/pregled-na-vladinite-merki-za-prevenca%20d1%98a-i-zashtita-od-korona-virusot-i-nivnoto-vli%20d1%98anie-vrz-rabotnichkite-prava/>.

¹⁰ Jadrovski, I. (3 janar 2021). *(Jo)efikasiteti i Inspektoratit Shtetëror të Punës në mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve*. Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. I disponueshëm në: <https://mhc.org.mk/reports/special-report/neefikasnost-na-drzhavniot-inspektorat-za-trud-vo-zashtitata-na-rabotnichkite-prava/>

Gjatë vitit, kemi regjistruar shkelje të të drejtave të punëtorëve në lidhje me:

- të drejtën e regresit për pushim vjetor;
- shkeljet në vendin e punës;
- fillimin e procedurave pranë Inspektoratit Shtetëror të Punës për mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve dhe/ose mbarëvajtjen e procesit gjyqësor për konteste nga fusha e marrëdhënieve të punës;
- procedurën për mbrojtje nga ngacmimi në vendin e punës dhe punën jashtë orarit.



Të dhënat e mbledhura për krizën e punës si rezultat i pandemisë tregojnë se shkeljet më karakteristike të të drejtave të punëtorëve ishin ndërprerja e kontratave të punës; ndërprerja e detyruar e marrëdhënies së punës; mos zgjatja e paligjshme e kontratave me afat të caktuar; ulja dhe/ose mospagimi i pagës dhe mosrespektimi i masave qeveritare për parandalimin dhe mbrojtjen kundër koronavirusit.

II. Efektet e krizës KOVID-19 mbi të drejtat e punëtorëve

Në muajin dhjetor të vitit 2019, një koronavirus i ri u shfaq në qytetin Vuhan, Provinca Hubei në Republikën Popullore të Kinës, i cili shpejt filloi të përhapet në pjesë të tjera të botës.¹¹ Rasti i parë pozitiv në Maqedoni u regjistrua më 26 shkurt 2020. Pas shfaqjes së disa rasteve të pacientëve të diagnostikuar me KOVID-19, Qeveria miratoi disa

¹¹ World Health Organisation. (2020, December 14). *Timeline: WHO's COVID-19 response*. I disponueshëm në: <https://www.who.int/emergencies/diseases/novel-coronavirus-2019/interactive-timeline#>.

masa dhe rekomandime për mbrojtjen dhe parandalimin e koronavirusit,¹² dhe më 11 mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë shpalli gjendjen e pandemisë.¹³

Më 10 mars, Qeveria miratoi një masë për ndërprerjen e procesit edukues-arsimor dhe mësimdhënien në të gjitha kopshtet dhe shkollat fillore.¹⁴ Në të njëjtën kohë, Qeveria vendosi se për zbatimin e kësaj mase, një nga prindërit, fëmijët e të cilëve deri në moshën dhjetë vjeç ndjekin mësimet në kopsht fëmijësh ose shkollë fillore, do të lirohen nga detyrimi për të kryer detyrat e punës.¹⁵ Menjëherë më pas, u përcaktuan edhe kategoritë e personave që duhet të lirohen nga detyrat dhe aktivitetet e punës për shkak të kushteve të caktuara shëndetësore.¹⁶ Më 14 mars, Qeveria u rekomandoi të gjithë punëdhënësve në vendin tonë, në varësi të llojit të punës dhe mundësive, të organizojnë punën dhe mënyrën e punës së të punësuarve përmes institutit "punë nga shtëpia".¹⁷ Më 18 mars 2020, Maqedonia shpalli gjendjen e jashtëzakonshme në territorin e gjithë vendit.¹⁸ Ndërsa rritej numri i rasteve me koronavirusin e ri, u rritën edhe shkeljet e të drejtave të punëtorëve. Menjëherë pas hyrjes në fuqi të masës së parë nga Qeveria, Komiteti i Helsinkit regjistroi parregullsitë e para të denoncuar nga numër i madh punëtorësh.

Pushimet/largimet nga puna

Pavarësisht nga nevoja për solidaritet dhe bashkim gjatë një krize të tillë, shumë punëdhënës menjëherë nuk qëndruan duarkryq dhe filluan me ndërprerjen e kontratave të punës, pa shqyrtuar ndonjë mundësi apo alternativë tjetër. Në gjysmën e parë të vitit, kemi regjistruar 44 raste të tilla, dhe ndihma jonë juridike në këtë pjesë mbuloi afërsisht 460 punëtorë. Më poshtë do t'i paraqesim dy rastet më tipike të largimeve masive për periudhën, të raportuara nga punonjësit që janë pushuar nga puna nga ana e punëdhënësve të zgjedhur.

Kompania për prodhimin dhe post-prodhimin e materialeve video dhe filmike FHZH DOO Shkup njoftoi se 20 punëtorëve do t'ju ndërprehen kontratat e tyre të punës për arsye afariste dhe se do të shfuqizonte plotësisht një njësi të tërë organizative. Sipas informacioneve që punëtorët ndanë me ne, punëdhënësi i kishte informuar se: *"...Nga analizat e kryera dhe nga të gjithë treguesit nuk shfaqet një mundësi ndryshimi të rëndësishëm të këtij trendi gjatë këtij dhe viteve në vijim. Duke pasur parasysh se për shkak të pandemisë globale të virusit KOVID-19, është pezulluar për kohë të pacaktuar edhe puna e studiove më të mëdha të Holivudit, dhe këto vështirësi reflektohen edhe në funksionimin e ndërmarrjes. Me një vëllim kaq të reduktuar të aktiviteteve të këtij lloji, ekzistenca e këtij departamenti brenda kornizës së përgjithshme organizative të Kompanisë është e paqëndrueshme dhe ndikon në racionalitetin e përgjithshëm, ekonominë dhe efikasitetin e punës."*

Qëndrimi jo korrekt i punëdhënësve ndaj punëtorëve të tyre dhe fuqia asimetrike mes tyre, edhe një herë u konfirmuan përmes shembullit të Kompanisë për tregti dhe shërbime KAST INVEST DOO Shkup. Atje, punëdhënësi "anuloi" në mënyrë të paligjshme kontratat e punës për arsye afariste të 120 punonjësve, të cilët ishin njoftuar se do të hapet një procedurë falimentimi për Kompaninë. Vendimi i largimit nga puna nuk përmbante ndonjë arsyetim për

¹² Të gjitha masat dhe konkluzionet nga seancat e Qeverisë në lidhje me parandalimin dhe mbrojtjen e koronavirusit janë në dispozicion në faqen zyrtare të Qeverisë: <https://vlada.mk/covid19>.

¹³ World Health Organization. (2020, March 18). *WHO Director-General's opening remarks at the media briefing on COVID-19 - 11 March 2020*. I disponueshëm në: <https://www.who.int/director-general/speeches/detail/who-director-general-s-opening-remarks-at-the-media-briefing-on-covid-19---11-march-2020>.

¹⁴ Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. (10 mars 2020). *Ekstrakt nga Procesverbali i Seancës së 15-të të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, e mbajtur më 10 mars 2020*. I disponueshëm në: https://vlada.mk/sites/default/files/zakluchoci_covid-19.pdf.

¹⁵ Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. (10 mars 2020).

¹⁶ Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. (10 mars 2020). *Ekstrakt nga Procesverbali i Seancës së 16-të të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, e mbajtur më 11 mars 2020*. I disponueshëm në: https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/izadok_od_16_sednica_na_vrsm.pdf.

¹⁷ Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. (10 mars 2020). *Ekstrakt nga Procesverbali i Seancës së 19-të të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, e mbajtur më 14 mars 2020*. I disponueshëm në: https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/zaklucok_19_sednica_vrsm.pdf.

¹⁸ Vendim për përcaktimin e ekzistencës së gjendjes së jashtëzakonshme i datës 18.3.2020 i Presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.68/2020).

shkaqet afariste mbi të cilat u ndërprejnë kontratat e tyre të punës. Punëdhënësi, në kundërshtim me Ligjin për Marrëdhëniet e Punës¹⁹, nuk kishte filluar një procedurë konsultimi me përfaqësuesit e punëtorëve, të paktën një muaj para fillimit të largimeve kolektive nga puna, dhe as nuk u kishte siguruar punëtorëve të gjitha informacionet përkatëse, me qëllim arritjen e një marrëveshje.²⁰ Punëdhënësi nuk kishte dorëzuar asnjë njoftim në shërbimin përgjegjës për ndërmjetësim gjatë punësimit në lidhje me largimet e planifikuara kolektive dhe konsultat me përfaqësuesit e punëtorëve.²¹ Si pasojë, punëtorët nuk kishin njohuri për mënyrën e zbatimit dhe rrjedhën e procedurës për përfundimin e kontratave të tyre të punës për arsye afariste, dhe për këtë arsye nuk kanë pasur mundësi të mbronin në mënyrë adekuate të drejtat e tyre të punës dhe interesat ligjore. Për më tepër, punëdhënësi nuk kishte specifikuar as afatin minimal të largimit nga puna, i cili zbatohet në rastet e largimeve kolektive nga puna.²² Disa nga punëtorët nuk morën fare vendim për pushim nga puna. Përveç ankesave, punëtorët ngritën edhe padi penale në Prokurorinë kompetente Publike për shkeljen e të drejtave nga marrëdhënia e punës, përmes një avokati të angazhuar nga Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. Në kohën e përpilimit të këtij raporti, nga Prokuroria Publike ende nuk ka asnjë përgjigje.

Për shkak të largimeve të shpeshta masovike nga puna të tërë grupeve të punëtorëve, që nga shfaqja e shkeljeve të para bëmë thirrje mbi domosdoshmërinë e një moratoriumi për të gjitha ndërprerjet e kontratave të punës nga ana e punëdhënësve (për arsye afariste) dhe për të gjitha uljet e pagave gjatë periudhës derisa zgjat gjendja e krizës.²³

Pas largimeve masovike nga puna, punëdhënësit anashkaluan presionin publik dhe shpërdoruan gjendjen e jashtëzakonshme duke detyruar që punëtorët të ndërpresin kontratat e tyre të punës. Në muajin prill, një numër rekord prej 265 punëtorëve denoncuan në Komitetin e Helsinkit se ata ishin detyruar të nënshkruanin marrëveshje për të përfunduar kontratat e tyre të punës. Në këtë mënyrë, atyre iu ishte mohuar çdo qasje në një mekanizëm mbrojtës dhe ata mbetën të luftonin për një ekzistencë "të zhveshur" në margjinat e shoqërisë. Një goditje tjetër për ta ishte pamundësia për të përfutur kompensime monetare në rast të papunësisë sepse kontratat e tyre të punës ishin ndërprerë me marrëveshje.²⁴ Në përgjigje të kësaj, dhe duke pasur parasysh që masat fillestare të qeverisë nuk arritën të mbronin punëtorët, Komiteti, së bashku me dhjetëra sindikata dhe organizata të tjera, i parashtruan një paketë kërkesash Qeverisë me propozime të duhura konkrete për zbatimin e secilës prej tyre. Në këtë mënyrë, u kërkua që të mundësohet e drejta për kompensim monetar për personat e papunë në kohën e krizës, që këtë të drejtë ta ushtrojnë edhe ata persona që kishin mbetur pa punë me vetëdeklarim, me marrëveshje ose për shkak të shkeljeve të pretenduara disiplinore.²⁵

Në muajin maj, Qeveria prezantoi masën "Kompensim monetar për të gjithë personat që kishin mbetur pa punë nga data 11 mars deri më 30 prill 2020" si një formë dakordi me kërkesat e sindikatave dhe organizatave të shoqërisë civile.²⁶ Kjo masë parashikonte që të gjithë personat që kishin humbër punën, duke përfshirë edhe ata që kishin ndërprerë marrëdhënien e punës përmes një deklarate me shkrim, me marrëveshje ose pushim nga punëdhënësi, do të merrnin një kompensim monetar nga Agjencia e Punësimit për një periudhë prej dy muajsh. Masa

¹⁹ Ligji për Marrëdhëniet e Punës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15, 27/16, 120/18 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr. 110/19).

²⁰ Neni 95 paragrafi 2 i Ligjit për Marrëdhëniet e Punës.

²¹ Neni 95 paragrafi 6 i Ligjit për Marrëdhëniet e Punës.

²² Neni 88 paragrafi 2 i Ligjit për Marrëdhëniet e Punës.

²³ Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. (21 mars 2020). *Urgjentisht të merren masa kundër largimeve nga puna derisa zgjat kriza*. I disponueshëm në: <https://mhc.org.mk/news/itno-da-se-prezemat-merki-protiv-otpushtanja-od-rabota-dodeka-trae-krizata/>.

²⁴ Drpljanin, V. (2 dhjetor 2020). *Largime pandemike nga puna dhe e drejta e kompensimit monetar në rast të papunësisë*. ResPublica. I disponueshëm në: <https://respublica.edu.mk/mk/blog/2020-12-02-10-19-23>.

²⁵ Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. (13 prill 2020). *Kërkesë Qeverisë për mbrojtjen e punëtorëve dhe të varfërve*. I disponueshëm në: <https://mhc.org.mk/news/baranja-do-vladata-za-zashita-na-rabotnicite-i-siromashnite/>.

²⁶ Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. (28 maj 2020). MPPS: *Ndihmë monetare për të gjithë të papunët që kanë pasur ndërprerje të marrëdhënies së punës në periudhën 11 mars - 30 prill*. I disponueshëm në: <https://vlada.mk/node/21537?ln=mk>.

përfshinte të paktën 8.000 punëtorë, mbijetesa e të cilëve u rrezikohej seriozisht sepse ata mbetën pa burimin e vetëm të të ardhurave.²⁷

Një grup tjetër i punëtorëve të cilët u mashtruan nga punëdhënësit e paskrupullt gjatë kohës së krizës janë punëtorët me kontrata në kohë të caktuar. Punëdhënësit vendosën që ata nuk kishin më nevojë për to, kështu që pas skadimit të periudhës së caktuar për të cilën ishin lidhur këto, ata nuk i zgjatën kontratat e tyre të punës. Kjo është veçanërisht shqetësuese duke pasur parasysh që në vitin 2018, 25.8 përqind e të punësuarve ishin angazhuar përmes kontratave me afat të caktuar, që do të thotë se çdo i katërti i punësuar në Maqedoni është i punësuar me këtë lloj kontrate.²⁸ Ligjërisht, kontratat e punës të lidhura për një periudhë të caktuar kohe mbarojnë me skadimin e afatit për të cilin janë lidhur dhe ndërprerja e marrëdhënies së punës në këtë mënyrë nuk përbën shkelje të legjislacionit të punës. Sidoqoftë, keqpërdorimi i pushtetit që kanë punëdhënësit mbi punëtorët, kontratat me afat të caktuar të të cilëve skadojnë gjatë një krize ekonomike të këtyre përmasave, paraqet një goditje të fuqishme për ekzistencën e një prej kategorive më të prekshme të punëtorëve.²⁹ Për shembull, kjo është veçanërisht e pranishme në industrinë e tekstilit, ku gratë punëtore shpesh punojnë në bazë të kontratave të punës me afat të caktuar për një periudhë prej një muaji. Kjo do të thotë që çdo muaj fati i punësimit të tyre është i pasigurt, kurse frika e humbjes së punës dhe mbijetesa e tyre cenon të drejtën e punonjësit për një punë dinjitoze.

Ulja dhe/ose mospagimi i pagave

Pas muajve të parë të krizës, filloi të bie numri i largimeve nga puna, por u rrit numri i ankesave nga punëtorët që nuk ishin paguar ose pagat e tyre ishin zvogëluar me 50 përqind, duke u thirrë në institutin e "forcës madhore". Ministria e Punës dhe Politikës Sociale i dha interpretimin e tij nenit 112 të Ligjit për Marrëdhëniet e Punës. Sipas Ministrisë, punonjësi ka të drejtën e kompensimit monetar për tërë periudhën e mungesës nga puna, kurse shumata e kompensimit është e ndryshme për situata të ndryshme. Gjegjësisht, Ministria theksoi se për të parandaluar largimin nga puna të punëtorëve, në rrethana të caktuara, punëtorët mund të përdorin institutin e "pushimit të detyruar" me një kompensim të pagës në vlerë prej 70 përqind. Për më tepër, Ministria interpreton institutin e "forcës madhore" si një situatë në të cilën për të parandaluar përhapjen e koronavirusit, puna e personave juridikë në aktivitete të caktuara u ndalua plotësisht - kështu që punëdhënësit mund të përdorin dispozitat e nenit 112 paragrafi 7 të Ligjit për Marrëdhëniet e Punës për periudhën derisa nuk ka kushte pune dhe për t'i paguar punëtorët me një kompensim në shumën prej 50 përqind të pagës.³⁰

Në këtë drejtim, është e domosdoshme të theksohet se Kushtetuta e Republikës së Maqedonisë së Veriut, si akti më i lartë juridik, parashikon që vetëm Kuvendi është kompetent për interpretimin autentik të dispozitave ligjore.³¹ Ky interpretim është veçanërisht shqetësues sepse qëllimi i një Ministrie për Punë dhe Politikë Sociale duhet të jetë të sigurojë dhe vendosë praktika dhe politika të sigurta, të drejta dhe të harmonizuara për punëtorët në vendin e punës, të cilat janë të një rëndësie thelbësore për mirëqenien sociale dhe ekonomike.³² Njoftimi për interpretimin e kësaj dispozite deri në kohën e përgatitjes së këtij raporti është hequr nga faqja e internetit e Ministrisë.³³

²⁷ Petkovska, N. (30 nëntor 2020). *Pasqyrë e masave qeveritare për parandalimin dhe mbrojtjen nga koronavirusi dhe efektet e tyre mbi të drejtat e punëtorëve*. Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. I disponueshëm në: <https://mhc.org.mk/reports/pregled-na-vladinite-merki-za-prevenczi%20i%20zashiti-od-korona-virusot-i-nivnoto-vli%20d1%20anie-vrz-rabotnichkite-prava/>.

²⁸ Saveski Z. (16 mars 2020). *Kontratat në kohë të caktuar – vegël për përfitim të bindjes*. Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. I disponueshëm në: <https://mhc.org.mk/kolumnii/dogovorite-na-opredeleno-vreme-alatka-za-iznuduvanje-pokornost/>.

²⁹ Saveski, Z. (16 mars 2020).

³⁰ Saveski Z. (16 mars 2020).

³¹ Neni 68 paragrafi 1 alinea 2 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

³² Drpljanin, V. (6 maj 2020). *Puna dhe djersa është e yna, paratë dhe kapitali janë i 900 njerëzve në vend*. ResPublica. I disponueshëm në: <https://respublica.edu.mk/mk/blog/900>.

³³ Pravdiko. (15 prill 2020). *MPPS: Kompensimi i pagave të punëtorëve, gjatë pushimit të detyruar dhe mungesës nga puna për shkak të forcës madhore*. I disponueshëm në: <https://www.pravdiko.mk/mtsp-nadomestok-na-plata-na-rabotnitsite-za-vreme-na-prinuden-odmor-i-otsustvo-od-rabota-poradi-visha-sila/>.

Lidhja e Sindikatave të Maqedonisë (LSM) reagoi se vendimet e Qeverisë që ndalojnë plotësisht punën e personave juridikë në veprimtari të caktuara, dhe për të parandaluar përhapjen e koronavirusit, nuk paraqesin një forcë madhore.³⁴ Prandaj, së bashku me LSM-në, ne i kërkuam Qeverisë të miratojë një dekret që do të rregullojë se pagat e punëtorëve nuk mund të ulen me më shumë se 20 përqind gjatë kësaj krize, siç është definuar me Marrëveshjen e Përgjithshme Kolektive (MPK) për sektorin privat në fushën e ekonomisë.³⁵ Në këtë rast, MPK-ja për sektorin privat përmban dispozita që parashikojnë të drejta më të favorshme për punëtorët sesa Ligji për Marrëdhëniet e Punës dhe ato duhet të zbatohen.³⁶

Që nga fillimi i krizës, më shumë se 700 punëtorë kanë denoncuar në Komitetin e Helsinkit se nuk ishin paguar ose u ishin ulur pagat gjatë vitit të kaluar. Për më tepër, me mospagimin e pagave dhe kontributeve, në një nga momentet më kritike për shëndetin e njerëzve, një numër i madh i punëtorëve dhe familjeve të tyre mbetën edhe pa sigurime shëndetësore.

Mosrespektimi masave për parandalimin dhe mbrojtjen nga koronavirusi

- Masa për lirimin nga puna e njërit prej prindërve të fëmijëve deri në dhjetë vjeç

Një nga masat e ndjeshme gjinore të Qeverisë për të trajtuar pandeminë Sars Cov 19 ishte lirimi nga puna i njërit prind që ka fëmijë deri në moshën dhjetë vjeç. Pasi Qeveria pezulloi procesin edukues-arsimor dhe mësimdhënien në të gjitha kopshtet dhe shkollat fillore në muajin mars të vitit 2020, për zbatimin e përpiktë të kësaj mase, Qeveria vendosi që një nga prindërit fëmijët e të cilëve vizitojnë kopshtet ose mësojnë në shkollë fillore deri në moshën dhjetë vjeç, të lirohen nga detyrimi për të kryer detyrat e punës. Të dhënat e marra përmes raporteve të shkeljeve të të drejtave të punës tregojnë se kjo masë është përdorur më së shumti nga nënat.³⁷ Punëtorët u përballën me situata kur punëdhënësit nuk i lironin ata nga detyrimet e punës ose kur i lironin ata ulnin pagat e tyre. Disa punëdhënës madje kanë kërcënuar gratë punëtore me largim nga puna dhe mos zgjatje të kontratave të punës me afat të caktuar. Këto ishin shkeljet më të zakonshme të të drejtave të punës të denoncuar te ne në muajin korrik të vitit 2020.

Të dhënat e tilla e nxjerrën edhe një herë në sipërfaqe pabarazinë gjinore në shoqërinë tonë, e cila është në fakt një rezultat i drejtpërdrejtë i përkushtimit dhe punës së pamjaftueshme në këtë fushë në periudhën para ardhjes së krizës.³⁸ Kjo dëshmohej nga të dhënat e Inspektoratit Shtetëror të Punës (ISHP), i cili në muajt e parë të krizës, më shpesh ka vepruar pikërisht për denoncimet për shkeljen e masës së lirit nga puna të njërit prej prindërve që kanë fëmijë deri në moshën dhjetë vjeç. Këto denoncime përfaqësojnë 28 përqind të numrit të përgjithshëm të denoncimeve për shkelje të të drejtave të punëtorëve.³⁹

Punëdhënësit u përpoqën të anashkallonin dispozitat ligjore për pagimin e pagave të plota dhe/ose pagave minimale për punëtorët e përjashtuar nga kjo masë dhe thirreshin gabimisht në institutin e "pushimit të detyruar". Në këtë rast, punonjësit i sigurohet një kompensim monetar në shumën prej 70 përqind të pagës, që do të thotë se

³⁴ Lidhja e Sindikatave të Maqedonisë. (2020). *Reagim i LSM-së në lidhje me interpretimin e Ligjit për Marrëdhëniet e Punës nga ana e MPPS-së për pagesën e shumës së kompensimit në pagë*. I disponueshëm në: <http://www.ssm.org.mk/mk/reakcija-na-ssm-na-tolkuvanjeta-na-zakonot-za-rabotnite-odnosi-od-strana-na-mtsp-za-isplata-na>.

³⁵ Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. (13 prill 2020). *Kërkesë Qeverisë për mbrojtjen e punëtorëve dhe të vaerfërve*. I disponueshëm në: <https://mhc.org.mk/news/baranja-do-vladata-za-zashtita-na-rabotnicite-i-siomashnite/>.

³⁶ Kontrata e punës, përkatësisht marrëveshja kolektive mund të përcaktojë të drejtat, të cilat janë më të favorshme për punëtorët, sesa përcaktohen me këtë ligj. – Neni 12 paragrafi 3 i Ligjit për Marrëdhëniet e Punës.

³⁷ Petkovska, N. (30 nëntor 2020). *Pasqyrë e masave qeveritare për parandalimin dhe mbrojtjen nga koronavirusi dhe efektet e tij mbi të drejtat e punëtorëve*. Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. I disponueshëm në: <https://mhc.org.mk/reports/pregled-na-vladinite-merki-za-prevenczi%20d1%98a-i-zashtita-od-korona-virusot-i-nivnoto-vli%20d1%98anie-vrz-rabotnichkite-prava/>.

³⁸ Bashevskaja, M. (2019). *Indeksi i barazisë gjinore në Maqedoninë e Veriut*. UNDP-UN Grate.

³⁹ Petkovska, N. (30 nëntor 2020). *Pasqyrë e masave qeveritare për parandalimin dhe mbrojtjen nga koronavirusi dhe efektet e tij mbi të drejtat e punëtorëve*. Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. I disponueshëm në: <https://mhc.org.mk/reports/pregled-na-vladinite-merki-za-prevenczi%20d1%98a-i-zashtita-od-korona-virusot-i-nivnoto-vli%20d1%98anie-vrz-rabotnichkite-prava/>.

punonjësi mund të marrë kompensim më të ulët se shuma e parashikuar ligjërisht e pagës minimale. Megjithatë, Inspektorati Shtetëror i Punës ishte i vendosur se punëtorëve që përdorin masat qeveritare për lirim nga puna u takon të marrin pagë të plotë.

Masa për lirimin e punëtorëve me sëmundje kronike

Më 11 mars, 2020, Qeveria miratoi masën për përcaktimin e kategorive të personave që duhet të lirohen nga puna dhe aktivitetet e punës, për shkak të kushteve të caktuara shëndetësore. Midis tyre ishin punëtorë me sëmundje kronike të frymëmarrjes dhe me sëmundje të rëndë kardiovaskulare, personat me diabet tip 1, personat me sëmundje malinje dhe ato me probleme të çrregullimit të imunitetit. Bazuar në këtë, Ministria e Shëndetësisë dhe Komisioni për Sëmundje Infektive përgatitën një listë të diagnozave në lidhje me kushtet e mësipërme shëndetësore.⁴⁰

Nga ana tjetër, gjendja e jashtëzakonshme ishte shpallur pesë herë me radhë,⁴¹ me përjashtim të periudhës nga 13 deri në 15 qershor. Në këto dy ditë, filluan të rrjedhin përsëri të gjitha afatet, siç janë afatet në procedurat nga marrëdhënia e punës. Për herë të fundit gjendja e jashtëzakonshme ishte shpallur në periudhën 15 - 22 qershor.⁴² Për shkak të pasigurisë që shfaqej midis punëtorëve pas përfundimit të gjendjes së jashtëzakonshme, Qeveria vendosi që edhe pas përfundimit të gjendjes së jashtëzakonshme, të mbeten në fuqi masat që, ndër të tjera, lirojnë punëtorët e sëmurë kronikë nga përgjegjësitë e tyre të punës.⁴³ Gjatë periudhës sa zgjati kjo masë, Komiteti regjistroi 17 raste kur punëtorët vazhduan të shkonin në punë me kërkesë të punëdhënësve të tyre, në kundërshtim me masat e miratuara. Shkeljet e tjera kishin të bënin me mospagimin e pagave dhe/ose uljen e pagave të punëtorëve të liruar bazuar në këtë masë.

Disa nga punëdhënësit shpërdoruan masën duke i detyruar punëtorët të përdorin pushim mjekësor dhe kështu u paguan atyre një pagë në shumën prej 70%. Pjesa tjetër e punëdhënësve uli direkt pagat e punëtorëve të liruar me sëmundje kronike. Një shembull i tillë është një grup prej 200 punëtorësh të sëmurë kronikë të cilët raportuan se punëdhënësi i tyre kishte ulur pagat e tyre me 30 përqind gjatë kohës që ishin të liruar nga obligimet e punës. Një ulje e tillë e pagave të punëtorëve të cilët objektivisht nuk janë në gjendje të kryejnë detyrat e tyre është e paligjshme, ndikon në jetesën e tyre dhe të familjeve të tyre dhe përbën një abuzim të gjendjes së jashtëzakonshme të shkaktuar nga pandemia. Ne e raportuam rastin në Inspektoratin Shtetëror të Punës, dhe pasi kreu një mbikëqyrje të jashtëzakonshme inspektuese, Inspektorati konstatoi shkeljen e të drejtave të punëtorëve nga ana e punëdhënësit. Punëdhënësi veprroi konform udhëzimeve të dhëna, hoqi parregullsitë dhe pagoi plotësisht punëtorët me sëmundje kronike.

Përfundimi i vlefshmërisë së masave për parandalimin dhe mbrojtjen kundër koronavirusit

⁴⁰ Ministria e Shëndetësisë. (11 mars 2020). *Lista e sëmundjeve kronike me diagnoza që lirohen nga detyrat e punës*. I disponueshëm në: <http://zdravstvo.gov.mk/wp-content/uploads/2020/03/LISTA-NA-HRONICHNI-BOLESTI-SO-DIJAGNOZI-KOI-SE-OSLOBODENI-OD-RABOTNI-OBVRSKI.pdf>.

⁴¹ Vendim për përcaktimin e ekzistencës së gjendjes së jashtëzakonshme i datës 18.3.2020 i Presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.68/2020), Vendim për përcaktimin e ekzistencës së gjendjes së jashtëzakonshme i datës 17.4.2020 i Presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.104/2020), Vendim për përcaktimin e ekzistencës së gjendjes së jashtëzakonshme i datës 17.5.2020 i Presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.127/2020), Vendim për përcaktimin e ekzistencës së gjendjes së jashtëzakonshme i datës 31.5.2020 i Presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.142/2020) dhe Vendimi për përcaktimin e ekzistencës së gjendjes së jashtëzakonshme i datës 15.5.2020 i Presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.159/2020).

⁴² Vendim për përcaktimin e ekzistencës së gjendjes së jashtëzakonshme i datës 15.6.2020 i Presidentit të Republikës së Maqedonisë së Veriut („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.159/2020).

⁴³ Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. (12 qershor 2020). *Nga seanca e 65-të e Qeverisë: Masat për lirimin e prindërve që kanë fëmijë deri në moshën 10 vjeç ose klasën e katërt aktive nga detyrimet e punës mbeten në fuqi; Qendrat tregtare do të punojnë deri në ora 22:00*. I disponueshëm në: <https://vlada.mk/node/21729>.

Në seancën e saj të katërt, Qeveria vendosi që nga 23 shtatori 2020, të pushojë vlefshmëria e masave për parandalimin dhe mbrojtjen kundër koronavirusit në lidhje me punëtorët e sëmurë kronikë, punonjësit që përdorën masën për zgjatjen e pushimit të lehonisë dhe prindërit e fëmijëve deri në moshën dhjetë vjeç. Kështu, punëtorët me sëmundje kronike që u liruan nga puna, duke filluar nga 23 shtatori, u kthyen në vendet e tyre të punës dhe në kryerjen e rregullt të detyrave të punës. Përrjashtimi i vetëm i parashikuar në këtë drejtim ishte për personat që kanë një sëmundje malinje dhe/ose të cilët sëmundja është në gjendje të përkeqësimit dhe të cilët mund ta provojnë atë me anë të një akti diagnostikimi të një mjeku specialist.⁴⁴

Pushoi të vlejë edhe masa për zgjatjen e pushimit të lehonisë, kështu që gratë punëtoresh që ishin liruar nga puna mbi këtë bazë, rifilluan t'i kryejnë detyrat e tyre të punës. Ky vendim u miratua në seancën e qeverisë, pavarësisht nga fakti se vetëm disa ditë më parë u njoftua se Komisioni për Sëmundjet Infektive i paraqiti Qeverisë një propozim që vlefshmëria e masës për zgjatjen e masës për pushim lehonie të vlejë deri në fund të vitit.⁴⁵ Në vendet e tyre të punës u kthyen edhe punonjësit që përdorën masën për të liruar një prind të një fëmije deri në moshën dhjetë vjeç, i cili vijon mësimet në çdo nivel të procesit arsimor, në kopshtin e fëmijëve ose shkollën fillore. Masa e lirimt nga puna vazhdoi të zbatohet vetëm për gratë punëtoresh shtatzënë.⁴⁶

Abuzimi i paketave ekonomike për trajtimin e krizës

Për t'i trajtuar pasojat e koronavirusit, Qeveria miratoi katër paketa të masave ekonomike që sigurojnë mbështetje të drejtpërdrejtë financiare për likuiditetin e ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme nga Banka e Zhvillimit. Në këtë mënyrë, masat gjithashtu i referoheshin mbështetjes për kompanitë në pjesën e pagimit të pagave duke subvencionuar kontributet për punonjësit në kompanitë e prekura. Masat synonin drejtpërdrejt për të ndihmuar kompanitë që arritën rezultate më të dobëta financiare në vitin 2020 për shkak të koronavirusit.⁴⁷

Sipas të dhënave të Drejtorisë së të Ardhurave Publike, 281 punëdhënës që në prill morën mbështetje financiare në vlerë prej 9,995,565 milion denarë (rreth 162,300 euro), nuk e përmbushën detyrimin për të paguar pagat e 722 të punësuarve. Në maj, 427 punëdhënës nuk i paguan pagat e 984 të punësuarve, megjithëse ata morën mbështetje financiare në vlerë prej 13,698,998 milion denarë (ose 222,430 euro). Kompanitë e tjera gjithashtu ulën pagën minimale të 52,465 punëtorëve dhe paguan 1.5 milion euro më pak në llogaritë e tyre.⁴⁸ Drejtoria e të Ardhurave Publike u lëshoi paralajmërime për paga të papaguara punëdhënësve që përdorën mbështetjen financiare, e të cilët nuk kishin paguar pagat. Gjithashtu, këtyre punëdhënësve iu shqiptuan kundërvajtje, kurse Drejtoria, në bashkëpunim me Inspektoratin Shtetëror të Punës, zbatuan procedura kundër punëdhënësve për kthimin e plotë të fondeve të marra.

Për shkak të të dhënave mbi abuzimin e masave ekonomike, së bashku me disa sindikata dhe shoqata të qytetarëve, Komiteti i Helsinkit reagoi se ndihma financiare në të ardhmen duhet t'u drejtohet drejtpërdrejt punëtorëve, për të shmangur mundësinë e keqpërdorimit të tyre.⁴⁹ Ne apelojmë që qëllimi i mbështetjes financiare të shtetit duhet

⁴⁴ Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. (14 shtator 2020). SEanca e 4-të e Qeverisë: *Punonjësit e liruar nga puna sipas listës së kronikëve, me përjashtim të atyre me vërtetim nga një specialist, të gjithë prindërit e fëmijëve të liruar deri më tani kthehen në punë nga 23 shtatori*. I disponueshëm në: <https://vlada.mk/node/22484>.

⁴⁵ A1on. (7 shtator 2020). *Komisioni për Sëmundje Infektive: Pushimi i lehonisë të vlejë deri në fund të vitit, nga puna lirohen gratë shtatzëna*. I disponueshëm në: <https://a1on.mk/macedonia/komisija-za-zarazni-bolesti-porodilnoto-otsustvo-prodolzheno-do-krajot-na-godinata-od-rabota-oslobodeni-i-bremenite-zheni/>.

⁴⁶ Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. (15 shtator 2020). *Gratë shtatzëna vazhdojnë të përdorin masat e miratuara nga Qeveria, nga 23 shtator punonjësit që përdorën masën për lejen e zgjatur të lehonisë do të kthehen në punë*. I disponueshëm në: <https://vlada.mk/node/22487?ln=mk>.

⁴⁷ Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. (2020). *Masat ekonomike të Qeverisë për trajtimin e krizës me COVID-19*. I disponueshëm në: <https://vlada.mk/ekonomski-merki-covid19>.

⁴⁸ Drejtoria e të Ardhurave Publike. (28 korrik 2020). *Analiza e shfrytëzimit të masës për mbështetje financiare për mbështetje të pagimit të pagave për muajt prill dhe maj 2020*. I disponueshëm në: <http://www.ujp.gov.mk/mk/javnost/soopstenija/pogledni/808>.

⁴⁹ Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. (29 korrik 2020). *Përgjegjësia penale për kompanitë që përdorën mbështetjen financiare të shtetit dhe nuk i paguan rrogat e punonjësve të tyre*. I disponueshëm në: <https://mhc.org.mk/news/krivichna-odgovornost-za-firmite-koi-koristele-drzhavna-finansiska-poddrshka-a-ne-im-isplatile-plati-na-svoite-vrabotenil>.

të jetë ruajtja e vendeve të punës të punëtorëve, dhe jo punëdhënësit të përfitojnë në mënyrë të paligjshme në kurriz të punëtorëve gjatë krizës më të madhe shëndetësore, sociale dhe financiare deri më sot.

Gjatë gushtit dhe shtatorit, qeveria njoftoi se po mbante takime të rregullta me dhomat e tregtisë, organizatat e punëdhënësve, sindikatat, profesorët universitarë dhe praktikantët, në mënyrë që të miratojnë paketën e katërt të masave ekonomike.⁵⁰ Përfaqësuesit e dhomave të tregtisë ishin të kënaqur që edhe këtë herë ata ishin të përfshirë në krijimin e masave dhe se Qeveria pranoi një numër të madh të propozimeve të tyre.⁵¹ Për dallim nga to, nevojat e punëtorëve që u pasqyruan në kërkesat e sindikatave dhe organizatave të shoqërisë civile nuk u morën parasysh në këtë paketë masash. Masat financiare që synonin gjoja për të ndihmuar dhe mbështetur punëtorët përsëri nuk u janë paguar drejtpërdrejt atyre, me çrast mbeti rreziku real i përsëritjes së abuzimit.

Leksionet e pamësuara nga gabimet u kushtojnë shumë punëtorëve dhe rrezikojnë edhe më shumë vetë ekzistencën e tyre. Në dhjetor, Drejtoria e të Ardhurave Publike publikoi një Analizë të mbështetjes financiare të punëdhënësve për pagesën e pagave të punonjësve për muajin tetor 2020.⁵² Gjithsej 179 punëdhënës të cilët morën mbështetje financiare në vlerë prej 5,271,771 denarë, nuk e përmbushën detyrimin për të paguar pagën e 338 të punësuarve për muajin tetor. Punëdhënësit që kanë marrë mbështetje financiare të shtetit por nuk kanë paguar pagat e punëtorëve të tyre do t'i nënshtrohen kontrolleve të hollësishme nga Drejtoria dhe Inspektorati Shtetëror i Punës. Kontrollat pritej të pasoheshin nga inspektimet e kompanive që kanë paguar një pagë më të ulët se shumica minimale e përcaktuar ligjërisht. Lista e kompanive që abuzuan me mbështetjen shtetërore u dorëzua në Sekretariatit e Përgjithshëm të Qeverisë, për ekspozimin publik dhe transparent të personave që nuk paguan, dhe e njëjta nuk mund të ndryshohej, pavarësisht nëse pas ekspozimit ndonjë tatimpagues kishte paguar në ndërkohë pagat e punonjësve të tij.⁵³

Në fund të dhjetorit 2020, u shpall paketa e pestë e masave ekonomike, kësaj radhe duke synuar kompanitë. Problemet dhe mangësitë që ishin shpërfillur gjatë zbatimit të masave ekonomike, do të thotë që punëtorët përsëri do t'i vuajnë pasojat e një sistemi të korruptuar.⁵⁴

⁵⁰ MIA. (10 shtator 2020). *Zaev: Paketa e katërt e masave mbulon më të varfërit, një masë nxitje është kthimi i punëtorëve të pushuar nga puna*. I disponueshëm në: <https://mia.mk/zaev-so-chetvrtiot-paket-merki-opfateni-na-siromashnite-stimulativna-merka-e-i-vra-a-e-na-otpushteni-rabotnici/>.

⁵¹ Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. (25 shtator 2020). *Dhomat e tregtisë të kënaqur me masat e parashikuara në paketën e katërt për të mbështetur kompanitë dhe qytetarët dhe se shumë nga sugjerimet dhe propozimet e tyre janë pranuar*. I disponueshëm në: <https://vlada.mk/node/22624>.

⁵² Drejtoria e të Ardhurave Publike. (14 dhjetor 2020). *Analizë e mbështetjes financiare të punëdhënësve për pagesën e pagave për punonjësit për muajin tetor*. I disponueshëm në: <http://www.ujp.gov.mk/mk/javnost/soopstenija/pogledni/831>.

⁵³ Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. (15 dhjetor 2020). *Analizë e azhurnuar e ndihmës shtetërore të papaguar për muajin tetor për pagën minimale nga punëdhënësit përfitues të kësaj ndihme (15.12.2020)*. I disponueshëm në: <https://vlada.mk/node/23553>.

⁵⁴ TV21. (24 dhjetor 2020). *Kryeministri Zaev: Paketa e pestë e masave është menduar për më të prekurit, shteti është këtu për të ndihmuar të gjithë qytetarët*. I disponueshëm në: https://mk.tv21.tv/premierot-zaev-pettiot-paket-merki-e-namenet-za-najpogodenite-drzhavata-e-tuka-da-im-pomaga-na-site-gragani/?fbclid=IwAR20bl7IPFZPmp5QUqTftu4ZwAkU-1EGHGZHe_Q1-X2UzbfQaFcfekoB39g.

Aksion në terren për
rritjen e ndërgjegjësimit
për të drejtat e
punëtorëve
Kërçovë, 2020



III. Ligji i ri për Marrëdhëniet e Punës

Përkundër faktit se Ligji i ri për Marrëdhëniet e Punës filloi të hartohet në gjysmën e parë të vitit 2018, deri në fund të vitit 2020 ende nuk kishte hyrë në procedurë parlamentare. Pas një periudhe të gjatë, më 23 shtator 2020, u mbajt një takim koordinues i grupit të punës për hartimin e këtij ligji. Grupi i punës për hartimin e ligjit ra dakord të veprojë përmes takimeve javore të punës me praninë fizike të përfaqësuesve të aktorëve përkatës. Ministria e Punës dhe Politikës Sociale propozoi që të ketë një përfaqësues nga secila palë e interesit në grup, duke parë sindikatat përfaqësuese si palë të veçanta, kurse organizatat e shoqërisë civile si një palë, që do të thotë se organizatat e shoqërisë civile do të vepronë bashkërisht, pas takimeve paraprake koordinuese. Komiteti i Helsinkit merr pjesë si përfaqësues i të gjithë sektorit të shoqërisë civile.

Në takimin koordinues, u diskutua përpjekja për të arritur një kompromis mbi disa nene të diskutueshme të ligjit të ri, mbi të cilin përfaqësuesit e punëtorëve dhe Organizata e Punëdhënësve kanë pikëpamje të kundërta. Në takim gjithashtu u diskutua nevoja për shqyrtim më të hollësishëm të pjesëve të ligjit që do të rregullojnë orët fleksibile të punës dhe institutin "puna nga shtëpia" - një nevojë e imponuar nga situata specifike në të cilën u gjetën punëtorët, e shkaktuar nga përhapja e koronavirusit.

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale ndau pritjet e saj se ligji i ri do të hyjë në procedurën parlamentare në shkurt të vitit të ardhshëm dhe do të miratohet në tremujorin e parë të vitit. Në gjysmën e dytë të vitit 2020, puna për ligjin e ri u intensifikua dhe u mbajtën takime të rregullta të aktorëve aktivë në procesin e përgatitjes së tij.

Disa nga risitë që do të prezantohen nga Ligji i ri për Marrëdhëniet e Punës:

- ✓ Zgjerimi i definicionit të punëtorit: „**punëtor është çdo person fizik që është pjesë e një marrëdhënie pune dhe/ose ka një kontratë pune me një punëdhënës**“.⁵⁵ Në këtë mënyrë, mbrojtja ligjore do të mbulojë punëtorët që nuk kanë kontratë pune, por që janë realisht në marrëdhënie pune. Përkufizimi i zgjeruar do të mbrojë qytetarët nga kategoritë e prekshme të cilët nuk janë të njohur me llojet e ndryshme të kontratave dhe pasojat që ato sjellin. Për më tepër, në këtë mënyrë legjislacioni ynë i punës do të harmonizohet me legjislacionin Evropian⁵⁶ dhe Rekomandimin numër 198 të ONP-së për marrëdhëniet e punës⁵⁷
- ✓ Mundësia për të **punuar në distancë**, dmth punonjësi të kryejë punën **jashtë vendit të punës së punëdhënësit**. Në këtë mënyrë, punonjësi do të përcaktojë orët e punës dhe periudhat e pushimit, dhe puna në distancë do të thotë që punonjësi do të ketë pushim ditor dhe javor. Ky lloj i ri i punësimit siguron një **fleksibilitet më të madh në punë** dhe ka një rëndësi të veçantë për të rinjtë, studentët, prindërit e që kujdesen për fëmijët dhe punëtorët në profesione të caktuara siç është industria e teknologjisë informatike.
- ✓ **Punësimi me afat të caktuar** mund të themelohet për një **maksimum prej tre vjetësh** në vend të, si më parë, pesë vjet dhe në këtë mënyrë nuk mund të punësohen **më shumë se 20 përqind të numrit të përgjithshëm të punësuarve të punëdhënësi**.
- ✓ **Rritja e afatit për ankesë** ndaj vendimeve me të cilat punonjësi konsideron se është shkelur një e drejtë, nga tetë në **pesëmbëdhjetë ditë**. Këto risi do të kontribuojnë në **qasjen efektive të punëtorëve në drejtësi**, duke mbrojtur të drejtat e tyre të punës.
- ✓ Futja e **lejes/mungesës prindërore**, e cila mund të **transferohet midis nënës dhe babait** dhe të përdoret sipas **marrëveshjes së tyre të ndërsjellë**, për një periudhë prej nëntë muajsh, dmth pesëmbëdhjetë muaj pandërprerë. Kjo do të ndikojë drejtpërdrejt në **shpërndarjen më të drejtë të përgjegjësive shtëpiake, kontributin e barabartë në kujdesin ndaj fëmijëve dhe praninë e të dy prindërve në tregun e punës**, dhe është i një rëndësie të veçantë për **barazinë gjinore midis punëtorëve**.
- ✓ **Të gjithë sindikatat do të kenë cilësinë e subjektit juridik**. Për shembull, nëse në një kompani punëtorët vendosin të formojnë një sindikatë, ajo do të fitojë statusin e një personi juridik në momentin e regjistrimit në Regjistrin Qendror.
- ✓ Rregullimi i saktë dhe interpretimi më i gjerë i institutit **pagë e barabartë për punë me vlerë të barabartë**, në vend të pagës së barabartë për punë të barabartë. Ky institut do të zbatohet gjithashtu për rastet kur **burrat dhe gratë punojnë punë të ndryshme me vlerë të barabartë**.
- ✓ **Rritja e afatit të parashkrimit të pretendimeve monetare** nga punësimi, nga tre në pesë vjet, llogaritur nga dita e ndodhjes së detyrimit

⁵⁵ Drpljanin, V. (26 tetor 2020). *Punëtorë të padukshëm*. ResPublica. I disponueshëm në: <https://respublica.edu.mk/mk/blog/2020-10-26-11-16-26>.

⁵⁶ Parlamenti dhe Këshilli Evropian. (5 korrik 2006). *Traktati për funksionimin e Bashkimit Evropian C-326/49 dhe Direktiva 2006/54/EC*.

⁵⁷ Organizata Ndërkombëtare e Punës. (2019). *Rekomandimi numër 2, pika 3 e Memorandumit Teknik të ONP-së*.

IV. Mbrojtje institucionale e të drejtave të punëtorëve

Bazuar në të dhënat e mbledhura përmes komunikimit të përditshëm me punëtorët, ne monitorojmë dhe analizojmë punën e Inspektoratit Shtetëror të Punës (ISHP), si mbrojtja kryesore institucionale e të drejtave nga marrëdhënia e punës. **Gjatë vitit 2020, Komiteti i Helsinkit dorëzoi 90 kërkesa në Inspektoratin Shtetëror të Punës.**⁵⁸ Në 32 raste nga numri i përgjithshëm i kërkesave të parashtruara, ishte konstatuar ndonjë shkelje e të drejtave të punëtorëve, për 27 raste përgjigja e ISHP-së ishte negative, kurse për 31 kërkesa Inspektorati nuk na ka dorëzuar përgjigje. Vetëm në një rast Inspektorati na informoi se kishte ngritur padi penale kundër punëdhënësit, në një rast të dëmtimit në vendin e punës me pasoja fatale.⁵⁹

Pandemia e shkaktuar nga KOVID-19 dhe kriza e punës si pasojë e saj e menjëhershme provuan funksionalitetin dhe efektivitetin e ISHP-së. Sipas raportit për punën e ISHP-së për periudhën janar - qershor 2020, Inspektorati në këtë periudhë kishte 105 inspektorë për fushat e marrëdhënieve të punës dhe sigurisë dhe shëndetit në punë, të shpërndarë në 30 rajone. Gjatë kësaj periudhe, ISHP-ja ka kryer gjithsej 16.892 mbikëqyrje inspektuese, respektivisht një inspektor ka kryer mesatarisht 1 inspektim në ditë.⁶⁰ Megjithëse gjatë gjendjes së jashtëzakonshme ISHP-ja tregoi një tendencë pozitive të reagimit të shpejtë, të azhurnuar dhe efikas, përfundimi i përgjithshëm është se ai nuk ka burime të mjaftueshme njerëzore dhe materiale për të vepruar në mënyrë të shpejtë dhe efikase ndaj kërkesave të parashtruara për mbikëqyrje të jashtëzakonshme inspektuese. Numri aktual i të punësuarve në ISHP nuk është adekuat për të trajtuar vëllimin e punës, një vëllim i rritur, sidomos gjatë kohës së krizës.⁶¹

Një problem tjetër institucional është se ISHP-ja rrallë përdor mundësinë ligjore *ex officio* për iniciimin e mbikëqyrjeve të jashtëzakonshme inspektuese.⁶² Kjo praktikë u përmirësua gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, veçanërisht të punëdhënësit të cilët kanë punuar gjatë kohës së orës policore.⁶³

Gjatë vitit 2020, Komiteti regjistroi disa raste kur inspektorët e punës shkelnin parimet e punës gjatë kryerjes së mbikëqyrjeve inspektuese.⁶⁴ Gjegjësisht, inspektorët janë përgjegjës nëse nuk kryejnë detyrime ose nuk marrin masa, të cilat sipas ligjit ata janë të detyruar t'i kryejnë, respektivisht të ndërmarrin masa, në procedurën e mbikëqyrjes.⁶⁵ Prandaj, ne i kërkuam Drejtorit të Inspektoratit Shtetëror të Punës që të fillojë procedura disiplinore kundër inspektorëve që kanë vepruar në këto dy raste, nëse ato nuk i heqin parregullsitë e kryera. Në një nga këto raste, ne u informuam se ishte filluar një procedurë disiplinore kundër inspektorit të punës i cili kishte vepruar ndaj një kërkesë për mbikëqyrje të jashtëzakonshme inspektuese.

⁵⁸ Kërkesa për mbikëqyrje të jashtëzakonshme inspektuese dhe kërkesa për informacion për rastet e regjistruara të shkeljes së të drejtave të punëtorëve.

⁵⁹ Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. (19 dhjetor 2020). *Mungesa e një kulture parandaluese për sigurinë dhe shëndetin në punë u merr jetën punëtorëve*. I disponueshëm në: <https://mhc.org.mk/news/nedostigot-na-preventivna-kultura-na-bezbednost-i-zdravje-pri-rabota-odzema-rabotnichki-zhivoti/>.

⁶⁰ Jadrovski, I. (3 janar 2021). *(Jo)efikasiteti i Inspektoratit Shtetëror të Punës në mbrojtjen e të drejtave të punëtorëve*. Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. I disponueshëm në: <https://mhc.org.mk/reports/special-report/neefikasnost-na-drzhavniot-inspektorat-za-trud-vozashitata-na-rabotnichkite-prava/>.

⁶¹ Jadrovski, I. (3 janar 2021).

⁶² Drpljanin, V. (11 mars 2020). *„Gjithçka është në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet“*. ResPublica. I disponueshëm në: <https://respublica.edu.mk/mk/blog/e-1-3>.

⁶³ Jadrovski, I. (3 janari 2021).

⁶⁴ Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. (22 janar 2021). *Raport mujor për të drejtat e njeriut në Republikën e Maqedonisë së Veriut – dhjetor 2020*. I disponueshëm në: <https://mhc.org.mk/reports/mesechen-izveshta%20d1%98-za-chovekovite-prava-vo-republika-severna-makedoni%20d1%98a-dekemvri-2020/>.

⁶⁵ Neni 9 i Ligjit për Inspektimin e Punës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 35/97, 29/02, 36/11, 164/13, 44/14, 33/15, 147/15 dhe 21/18).

GRATË PUNËTORE NË INDUSTRIJË E TEKSTILIT

Organizata Ndërkombëtare e Punës (ONP) ka publikuar një hulumtim të katër sektorëve që janë ndikuar më së shumti nga kriza e virusit: akomodimi dhe industria ushqimore; sektori i pasurive të patundshme, afarizmi dhe sektori administrativ; industria e përpunimit - industria e tekstilit; dhe tregtia. Në vitin 2020, 527 milion gra (ose 41 përqind e numrit të përgjithshëm të grave punëtore) ishin të punësuar në këta sektorë, krahasuar me 35 përqind të numrit të përgjithshëm të punëtorëve meshkuj. Kjo tregon që kriza do të godasë fuqinë punëtore të grave shumë më tepër, dhe në vendet e varfëra ekziston rreziku që shumë vende pune të zhduken, sidomos në industrinë e përpunimit.⁶⁶ Gratë në vendin tonë përfaqësohen kryesisht në fuqinë punëtore të angazhuar në industrinë e tekstilit,⁶⁷ e cila është industria më pak e paguar, dhe gratë punëtore në këtë industri shpesh marrin një pagë jo më të lartë se paga minimale. Kështu, fuqia punëtore femërore në këtë sektor është ndër ato që janë goditur më së shumti nga kriza ekonomike e shkaktuar nga masat për trajtimin e pandemisë.

Në vitin 2020, Komiteti i Helsinkit ofroi ndihmë ligjore dhe para-ligjore në 691 raste të grave punëtore në industrinë e tekstilit, të drejtat e të cilave u ishin shkelur, gjithsej në 16 qytete të vendit. Për të mbrojtur të drejtat e punëtorëve, ne iniciuam 32 procedura për kryerjen e mbikëqyrjeve të jashtëzakonshme inspektuese, dhe në 12 prej tyre u konstatuan shkelje nga ana e inspektorateve rajonale. Ndihma para-juridike kryesisht mbuloi rajonin lindor: Dellçevë (90), Koçanë (61) dhe Shtip (56). Këshillat juridike dhe/ose informimi ishin më të zakonshmet në lidhje me shkeljet e të drejtave të grave punëtore në industrinë e tekstilit në Shtip, respektivisht përfshinë 187 nga numri i përgjithshëm i rasteve. Fakti që gratë punëtore në industrinë e tekstilit ishin një nga më të prekurat gjatë kësaj periudhe dëshmohej edhe nga numri ndjeshëm në rritje i denoncimeve për shkelje krahasuar me tre vitet e fundit. Në vitin 2017, 2018 dhe 2019, numri i përgjithshëm i rasteve të dokumentuara të shkeljeve të të drejtave të grave punëtore në industrinë e tekstilit ishte 474.⁶⁸ **Krahasuar me vitin 2019, numri i denoncimeve në vitin 2020 ishte rritur për 329 përqind.**

2017	2018	2019	2020
134	179	161	691

Gratë mbajnë barrën më të madhe të shtëpisë dhe kujdesit për fëmijët, dhe në qytete ku industria e tekstilit mbizotëron si një burim kryesor i të ardhurave, ato janë gjithashtu burimet kryesore të të ardhurave të familjeve/amvisërive (*breadwinners*). Abuzimet e legjislacionit të punës dhe pagesat e paligjshme të pagave më të ulëta për shkak të referimit të padrejtë në institutin e "pushimit të detyruar"⁶⁹, do të thoshte se në industrinë e tekstilit gratë punëtore me fëmijë deri në moshën dhjetë vjeç, të liruar nga puna, në disa raste, morën një pagë në shumë


⁶⁶ International Labour Organization. (maj 2020). *The COVID-19 response: Getting gender equality right for a better future for women at work*. I disponueshëm në: https://www.ilo.org/wcmsp5/groups/public/---dgreports/---gender/documents/publication/wcms_744374.pdf.

⁶⁷ Madje 90 përqind e numrit të përgjithshëm të të punësuarve në fabrikat e tekstilit në Shtip janë gra. Center for Research and Policy Making. (2006). *Macedonian Clothes for Europe*. I disponueshëm në: <http://www.crpm.org.mk/wp-content/uploads/2012/03/MACEDONIAN-CLOTHES-FOR-EUROPE1.pdf>.

⁶⁸ Në vitin 2017 numri i denoncimeve ishte 134, në 2018 – 179 dhe në 2019 – 161. Jadrovski, I. (24 janar 2020). *Analizë për ndihmën e siguruar juridike dhe para-juridike për gratë punëtore në industrinë e tekstilit në periudhën 2017 - 2019*. Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. I disponueshëm në: <https://mhc.org.mk/publicationsanalizes/analiza-za-obezbedena-pravna-i-parapravna-pomosh-na-tekstilniterabotnichki-vo-periodot-2017-2019/>.

⁶⁹ Në këtë rast, punonjësit i sigurohet një kompensim i pagës në shumën prej 70 përqind të pagës, që do të thotë se punonjësi mund të marrë kompensim më të ulët se shumta e parashikuar ligjërisht e pagës minimale. Më shumë në fq. 7-8.

prej rreth 7500 denarë.⁷⁰ Prandaj, kjo ulje e paligjshme e pagave, për gratë punëtore nënkuptonte që ata merrnin një shumë që nuk arrin të plotësojë nevojat themelore për ekzistencën e një familje.⁷¹ Në një rast të tillë, një punëtore tekstili - nënë e një fëmije deri në moshën dhjetë vjeç e cila u lirua nga përgjegjësitë e saj të punës - u pagua nga punëdhënësi i saj në shumë 50 përqind nga shuma totale e pagës për muajt prill dhe maj. Me iniciativën tonë, Inspektorati Shtetëror i Punës zhvilloi një mbikëqyrje të jashtëzakonshme inspektuese dhe konstatoi shkelje të të drejtave të punës së kësaj punëtore. Punëdhënësi veprroi konform udhëzimeve të dhëna nga Inspektorati, hoqi parregullsitë dhe punonjësës i pagoi diferencën e pagave për këto muaj.⁷²



Dëshmitë pandemike të grave punëtore në industrinë e tekstit nga Meduza, autore Agnes Saraçini ⁷³

“ Edhe kjo kohë e pakohë, me këtë virusin që na kapi, unë shkoj në punë me shumë frikë, për shkak të parave për ekzistencë, e të mos flasim për ilaçet e burrit tim të sëmurë... Aq shumë dua të qaj, madje të bërtas me zë, por shtrëngoj dhëmbët dhe heshtem. ”

“ Sa herë në mengjes kur shkoj në punë më kujtohen DITËT e Racinit dhe me një copë shpirti pyes veten a ka mundësi që të mos venitet me kalimin e viteve, por përkundrazi e rrëfejmë gjithnjë e më shumë si në filllore, por tani si një realitet i hidhur për jetën tonë. ”

“ Unë shkoj me një çantë në shpatull, dhe ndjej sikur këmbët duan të kthehen mbrapa, por më dhemb shpirti, si do ta kaloj ditën kur mendjen do ta kem në shtëpi, sepse brenga që kam është shumë e madhe dhe e dhimbshme për mua , por kur është patjetër, duhet!!! ”

“ Ne ngjitemi në autobus, të radhitur pranë njëri-tjetrit, çfarë distance, çfarë muhabeti, çfarë masash përkujdesi, megjithëse me maska, por marrim frymë shumë pranë njëri-tjetrit. Justifikimi i pronarëve është se nuk kanë autobusë, nga e nesërmja ata do të sjellin autobusë të rinj dhe do të keni distancë të mjaftueshme nga njëri-tjetri.... ”

⁷⁰ Petkovska, N. (30 nëntor 2020). *Përmbledhje e masave qeveritare për parandalimin dhe mbrojtjen kundër koronavirusit dhe ndikimi i tyre në të drejtat e punëtorëve*. Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. I disponueshëm në: <https://mhc.org.mk/reports/pregled-na-vladinite-merki-za-prevenca-i-zashtita-od-korona-virusot-i-nivnoto-vli-d1%98anie-vrz-rabotnichkite-prava/>.

⁷¹ Petkovska, N. (30 nëntor 2020).

⁷² Petkovska, N. (30 nëntor 2020).

⁷³ Lufta për mbijetesë e grave punëtore në industrinë e tekstit, i disponueshëm në: <https://meduza.mk/fem-101/borbata-za-egzistentsi%D1%98a-na-tekstilnite-rabotnicki/> (qasja herën e fundit më 12.1.2021)

“Brenda reparteve pastrohet në mënyrë që të kemi hapësirë mes nesh, dy-tre maskat e dhëna, i lajmë dhe i përdorim sepse nuk ka të tjera, kurse dorezat filluam t'i blinin vetë, dhe pëshpërisim me njëra-tjetrën dhe me frikën e transferimit të një menaxhere, shefe dhe pastaj te pronari. Punon me kokën ulur dhe dëgjon zë: u thoni grave që janë në shtëpi me fëmijë të vegjël që të vijnë në punë, le t'i menaxhojnë punët si më parë, dhe ato me fëmijë më të mëdhenj nuk kanë pse të rrinë në shtëpi, fëmijët mund të kujdesen vetë, janë të rritur dhe tregoni atyre se nuk dihet se si do të paguhen.”

Masa për mbrojtjen e shëndetit të grave punëtore në industrinë e tekstit

Asnjë punëtor nuk është i harxhueshëm. Të gjithë punëtorët janë të rëndësishëm thelbësorë, pa marrë parasysh se çfarë kategorie aplikohet ndaj tyre nga ana e shtetit dhe bizneseve. Çdo punëtor ka të drejtë të mbrohet nga ekspozimi ndaj rreziqeve në vendin e punës, përfshirë edhe koronavirusin.⁷⁴

Neglizhenca e dispozitave të punës për mbrojtjen dhe sigurinë në punë ka rezultuar katastrofike për gratë punëtore në industrinë e tekstit. Menjëherë pas shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme në gjysmën e parë të vitit, mosrespektimi i vrazhdë dhe i hapur i masave dhe rekomandimeve të Qeverisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë për parandalimin dhe mbrojtjen ndaj koronavirusit i ekspozoi gratë punëtore në një rrezik serioz për shëndetin dhe jetën e tyre.

Pasojat nga mosrespektimi i masave nga ana e punëdhënësve u ndien në disa fabrika tekstili në Shtip. Më 1 qershor, atje u mbyllën 5 fabrika, pasi që u mbyll fillimisht një fabrikë në qytet në fund të majit për shkak të rasteve të punëtorëve pozitivë me COVID-19. Shtabi i krizës pranë Komunës së Shtipit propozoi të mbyllen fabrikat në të njëjtën ditë kur në komunë ishin regjistruar 27 persona pozitivë - numri më i madh i rasteve deri në atë kohë. Ky vendim u pranua nga Komisioni për Sëmundje Infektive dhe Shtabi i Krizave të Qeverisë. Konkretisht, në pesë fabrikat e tekstit, ku punojnë përafërsisht 500 punëtorë, u paraqitën disa raste të infektuarish me koronavirus.

Punëdhënësit organizuan transportin e punëtorëve nga shtëpia në punë dhe anasjelltas, në të njëjtët autobusë, së bashku me punëtorët e sëmurë nga një fabrikë tjetër dhe kështu kontribuan në përhapjen e infeksionit. Për më tepër, punëdhënësit dhe transportuesit nuk kishin respektuar as Dekretin me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për Transportin Rrugor gjatë gjendjes së jashtëzakonshme,⁷⁵ i cili parashikonte që gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, gjatë kryerjes së transportit publik të udhëtarëve, transportuesi në automjet është i detyruar të organizojë transportin me mbajtjen e detyrueshme të maskave nga pasagjerët dhe ekuipazhi, dezinfektimin e rregullt të automjeteve dhe mbajtjen e një distancë prej të paktën dy metra ndërmjet pasagjerëve. Dekreti parashikonte që automjeti i transportit publik mund të kishte maksimum 50 për qind të numrit të përgjithshëm të ulëseve, pa llogaritur vendin e shoferit.

Kryetari i Komunës së Shtipit, Bllagoj Boçvarski, deklaroi se në fabrikën e parë, e cila numëron 110 punëtorë, te gjysma e numrit të punëtorëve (55 persona) u zbulua se kishte prani të koronavirusit.⁷⁶ Për shkak të kësaj, Inspektorati Shtetëror i Punës në koordinim me policinë, bëri kontrole të intensifikuara në zonën e Komunës së Shtipit ku Shtabi kryesor për koordinimin e krizës të koordinimit ndaloi punën e fabrikave të tekstit dhe lëkurës, gjatë periudhës kur ishte në fuqi ndalesa. Nga mbikëqyrjet u konstatua se punëdhënësit në këto dy veprimtari në Shtip e respektuan plotësisht ndalimin.⁷⁷

⁷⁴ The Office of the United Nations High Commissioner for Human Rights. (2020, May 18). *Every worker is essential and must be protected from COVID-19, no matter what*. I disponueshëm në:

<https://www.ohchr.org/en/NewsEvents/Pages/DisplayNews.aspx?NewsID=25892&LangID=E>.

⁷⁵ Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. (29 maj 2020). *Dekreti me fuqi ligjore për ndryshimin e Dekretit me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për Transportin Rrugor gjatë gjendjes së jashtëzakonshme*. Gazeta Zyrtare e RMV-së nr.140.

⁷⁶ Dua të them. (1 qershor 2020). *5 konfeksione u mbyllën në Shtip pasi sot u regjistruan 27 raste të reja të COVID-19*. I disponueshëm në: <https://sdk.mk/index.php/dopisna-mrezha/zatvoreni-5-konfeksii-vo-shtip-otkako-denes-se-registrirani-novi-27-sluchai-na-kovid-19/>.

⁷⁷ Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut. (5 qershor 2020). *Nga seanca e 61-të e Qeverisë: Program i miratuar për financimin e aktiviteteve programore të shoqatave dhe fondacioneve për masat e trajtimit të krizës me COVID-19*. I disponueshëm në: <https://vlada.mk/node/21647>.

Megjithatë, mediat transmetuan dëshmi të grave punëtore të këtyre fabrikave për presionin që ishte ushtruar ndaj tyre nga ana e punëdhënësve të tyre gjatë kësaj periudhe: *"Ai më thotë - të infektuar, të pa infektuar, ju do të uleni këtu, kush mbijeton, mbijeton. Vendosa të mos shkoja në punë, por nuk e di kush do t'i ushqejë fëmijët sepse ata gjithsesi e humbën babanë e tyre."* dhe *"Ju nuk mund ta bindni atë se sa jemi të frikësuara. Ne udhëtojmë me autobusin, me të njëjtin që kishin udhëtuar pesë gra që janë tashmë të sëmura. Kam frikë nëse ai zbulon se ne po ankohe mi, do të mbetem pa para, kam dy fëmijë."* Punëdhënësit nuk u siguruan punëtorëve maska mbrojtëse, dezinfektues ose mundësi për distancën e kërkuar prej dy metrash, duke marrë parasysh faktin ato ishin të detyruara të udhëtonin me disa autobusë.⁷⁸ Nuk ka asnjë informacion nëse Inspektorati Shtetëror i Punës ka ngritur padi përkatëse penale për këtë shkelje të rëndë të të drejtave të punëtorëve, e cila arrin nivelin e trajtimit mizor, çnjerëzor dhe poshtëruës.

Punëdhënësit tanë injoruan thirrjet për të ndërmarrë masa parandaluese dhe masa kujdesi dhe vazhduan të anashkalojnë detyrimet ligjore për të ofruar sigurinë dhe shëndetin në punë për të punësuarit në çdo aspekt që lidhet me punën. Ky detyrim theksohet më shumë në kushtet e një pandemie, e cila përbën një kërcënim për jetën e punëtorëve. Sidoqoftë, gjatë vitit 2020, punëdhënësit nuk u thirrën në përgjegjësi për shpërdorimin e rëndë të detyrimeve të tyre dhe kundër tyre nuk ishte ngritur asnjë procedurë penale.

Shkeljet e të drejtave të punëtorëve janë gjithashtu një shkelje e të drejtave të grave, e cila konfirmon në mënyrë shtesë natyrën shumëdimensionale dhe ndërsektoriale të kësaj krize, prandaj çdo zgjidhje që nuk merr parasysh klasën dhe gjininë si elementë të ndërthurur dhe ndërsektorial, është e papërshtatshme për t'u marrë me trajtimin dhe parandalimin e pasojave. Gratë shtypen në mënyrë strukturore nga fakti që ato mbizotërojnë si një forcë punëtore në industrinë që është ndër më pak të paguarat. Për më tepër, në një kohë krize të kësaj përmase, ato janë më të lehtë për t'u goditur, sepse sistemi është krijuar për t'i lejuar dhe vendosur ato në një pozitë kaq të nënshtruar dhe të shtypur, pra nuk ofron mekanizma për t'i mbrojtur ato.⁷⁹



⁷⁸ A1on. (4 qershor 2020). *Pronarët ndaj grave punëtore në Shtip: të infektuar, të painfektuar, do të qëndroni këtu, kush do të mbijetojë, mbijeton*. I disponueshëm në: <https://a1on.mk/macedonia/gazdite-kon-rabotnichkite-vo-shtip-zarazeni-nezarazeni-kje-sedite-tuka-koj-prezhivee-prezhivee/?fbclid=IwAR2bZKi0qVc5Am4oMGjwtklsA3qeXLrsehgxecvWfi41VVEqLdeIWrdHU>.

⁷⁹ Petkovska, N. (30 nëntor 2020).

DISKRIMINIMI

Gjatë vitit 2020, kemi marrë 38 denoncime për trajtim të pabarabartë. 30 prej denoncimeve kishin të bënin me diskriminimin e kryer bazuar në një lloj diskriminimi: 18 në bazë të seksit, pesë në bazë të gjinisë, katër në bazë të aftësisë së kufizuar dhe një në bazë të gjendjes shëndetësore, arsimit dhe fesë. Tetë denoncime shtesë kishin të bënin me diskriminimin e shumëfishtë ose ndërsektorial: gjashtë denoncime bazuar në përkatësinë etnike dhe ngjyrën e lëkurës, një denoncim në bazë të gjinisë dhe një denoncim në bazë të seksit, orientimit seksual, origjinës sociale, statusit familjar dhe martesor.

Procesi i mundimshëm i legjislacionit kundër diskriminimit

Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi më në fund u miratua më 27 tetor 2020 dhe hyri në fuqi pas botimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut më 30 tetor të vitit 2020. Rregullimi ligjor i mbrojtjes nga diskriminimi ka kaluar nëpër një proces të mundimshëm, pasojat e të cilit kanë prekur më së shumti ata që kanë nevojë të mbrohen nga ligjet.

Shfuqizimi i Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi i vitit 2019

Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi u dorëzua Kuvend në maj të vitit 2018, u miratua më 16 maj 2019 dhe hyri në fuqi më 23 maj të po këtij viti. Një vit më vonë, Gjykata Kushtetuese shfuqizoi Ligjin, në seancën e saj të 14-të, mbajtur më 14 maj 2020.⁸⁰ Vendimi për shfuqizimin e Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi u miratua nga Gjykata Kushtetuese gjatë gjendjes së shpallur të jashtëzakonshme në territorin e gjithë vendit, si rezultat i pandemisë së koronavirusit, në një kohë kur vendi drejtohej nga një qeveri teknike, kurse Kuvendi ishte i shpërndarë. E gjithë kjo do të thoshte që grupet më të marginalizuara të njerëzve në vendin tonë mbetën pa asnjë mbrojtje.

Gjykata Kushtetuese filloi një procedurë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, pas një iniciative të paraqitur nga Komisionin për Mbrojtjen nga Diskriminimi në janar të vitit 2020, për të shqyrtuar pajtueshmërinë e tij me nenin 75 paragrafi 3 të Kushtetutës së Maqedonisë së Veriut. Neni 75 parashikon procedurën e shpalljes së ligjeve me dekret. Paragrafi 3 i këtij neni përcakton që Kuvendi rishikon ligjin dhe nëse ai miratohet me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të deputetëve, Presidenti i Republikës është i detyruar të nënshkruajë dekretin.⁸¹ Si rezultat i këtij vendimi të Gjykatës Kushtetuese, së bashku me Grupin Blueprint për reformën në drejtësi, ishte përgatitur një vështrim i tërë i procedurës para Gjykatës Kushtetuese, nga aspekti i lëshimeve/mangësive procedurale dhe thelbësore.

Lëshime procedurale

Gjykata bëri një lëshim procedural duke mos verifikuar prezumimet procedurale për mbarëvajtjen e procedurave. Për momentin, Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi nuk kishte asnjë subjektivitet juridik, respektivisht ai nuk ekzistonte si subjekt në qarkullimin juridik, dhe për këtë arsye nuk kishte të drejtë të parashtronte iniciativa në Gjykatën Kushtetuese. Ligji nga viti 2019 parashikonte që në ditën e hyrjes në fuqi të tij, përfundon mandati i anëtarëve të Komisionit për Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe ata vazhdojnë të punojnë deri në zgjedhjen e anëtarëve

⁸⁰ Gjykata Kushtetuese e Republikës së Maqedonisë së Veriut. (14 maj 2020). *Vendimi U.nr.115/2019-1*. Vendimi i plotë është i disponueshëm në: <http://ustavensud.mk/?p=19246>.

⁸¹ Neni 75 Paragrafi 3 i Kushtetutës së Republikës së Maqedonisë së Veriut.

të rinj, por jo më shumë se tre muaj.⁸² Komisioni, i cili ishte parashtruesi i iniciativës, ndaloi punën pas skadimit të tre muajve pasi Ligji hyri në fuqi, më 21 gusht 2019. Në atë moment, prezumimi procedural për ekzistencën e subjektivitetit juridik të paraqitësit të iniciativës pushoi së ekzistuari, kurse Gjykata Kushtetuese ishte e detyruar të ndërpriste procedurën, në përputhje me Rregulloren e saj.⁸³

Lëshime materiale

Për Gjykatën Kushtetuese, ligji i kontestuar ishte qartë dhe pa dyshim në kundërshtim me nenin 75 paragrafi 3 të Kushtetutës. Shpjegimi i këtij qëndrimi u bazua në faktin se ishte çështje miratimi, dmth miratimi i një ligji i cili rishikohet nga Kuvendi, dhe i cili ishte kthyer sepse Dekreti i ligjit nuk ishte nënshkruar nga Presidenti i Republikës. Gjykata konstatoi se në një rast të tillë, sipas Nenit 75 paragrafi 3 i Kushtetutës, është e nevojshme që ligji të miratohet me shumicë absolute, respektivisht me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të deputetëve, që do të thotë se të paktën 61 deputetë duhet të votojnë që ligji të miratohet.

Gjykata Kushtetuese shpjegoi se nëse Presidenti i Republikës vendos të mos nënshkruajë ligjin, siç u bë në këtë rast, ligji i kthehet Kuvendit për rishqyrtim dhe nëse miratohet me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të deputetëve (shumica absolute), atëherë Presidenti i Republikës është i detyruar të nënshkruajë dekretin. Prandaj, sipas Gjykatës, është e qartë se kushti themelor për miratimin e ligjit të kthyer është arritja e një shumice absolute, gjegjësisht është e nevojshme që ai të marrë të paktën 61 vota që një ligj i tillë të miratohet dhe të jetë i plotëfuqishëm. Për më tepër, Gjykata shprehet se Presidenti i Republikës nuk ka të drejtë të vërë veton mbi ligjet të cilat, sipas Kushtetutës, miratohen me shumicën e dy të tretave të numrit të përgjithshëm të deputetëve të Kuvendit (shumicë e cilësuar).

Në rastin konkret, Presidenti i Republikës më 18 mars 2019 kishte njoftuar Kuvendin se kishte vendosur të mos nënshkruante Dekretin për shpalljen e Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi i miratuar në një seancë të Kuvendit më 11 mars 2019. Ligji u vendos përsëri në rendin e ditës për votim në seancën e nëntëdhjetë e katërt të Kuvendit, të mbajtur më 16 maj 2019. Në seancë, për Ligjin kishin votuar 55 deputetë, abstenime dhe kundër nuk kishte. Duke marrë parasysh faktin që për Ligjin kanë votuar 55 deputetë, e jo 61 (shumica absolute), Gjykata Kushtetuese vendosi që Ligji është në kundërshtim me Kushtetutën e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Gjegjësisht, neni 75 i Kushtetutës nuk përcakton një ndalim ose pengesë për Presidentin për të nënshkruar një dekret. Kjo dispozitë nuk rregullon çështjen e shumicës së kërkuar për miratimin e një ligji, por adreson vetëm çështjen e shpalljes së ligjeve.⁸⁴ Për më tepër, sipas Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese, gjuha e përdorur nga dispozita duhet të merret parasysh, respektivisht shprehja e përdorur "i miratuar", në vend të shprehjes "i sjellë", e cila përdoret nga Kushtetuta për shumicën e nevojshme për të miratuar ligje, të cilat sipas tij përbënin një dallim thelbësor.⁸⁵ Në fakt, Kushtetuta nuk parashikon një shumicë të veçantë për miratimin e këtij ligji, kështu që nëse Presidenti vendos ta nënshkruajë atë, nuk ka asnjë pengesë sa i përket nenit 75. Paragrafi 3 i këtij neni nuk përcakton që një ligj i miratuar nga një shumicë e thjeshtë duhet të miratohet nga një shumicë absolute kur miratohet për herë të dytë, nëse Presidenti i Republikës më parë ka refuzuar të nënshkruajë dekretin. Kjo dispozitë shpjegon obligimin dhe detyrimin e Presidentit për të nënshkruar dekretin për shpalljen e një ligji i cili gjatë rishikimit është miratuar me shumicë absolute. Kjo do të

⁸² Neni 48 paragrafi 1 i Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut nr.101/2019“ i datës 22.05.2019).

⁸³ Gjykata Kushtetuese do të ndalojë procedurën nëse gjatë procedurës pushojnë parakushtet procedurale për sjelljen e saj të mëtejshme. - Neni 47 paragrafi 1 alinea 5 e Rregullores së Gjykatës Kushtetuese („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr.70/1992“).

⁸⁴ Në këtë drejtim është Opinioni i Posaçëm për çështjen U.nr.115 / 2019 të Kryetarit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Maqedonisë së Veriut - Sali Murati, i datës 14 maj 2019. Opinioni i plotë i disponueshëm në: <http://ustavensud.mk/?p=19247>.

⁸⁵ Ibid.

thotë që shumica absolute parashihet ekskluzivisht si obligim i presidentit për të nënshkruar një dekret të një ligji të caktuar që është miratuar me shumicën e parashikuar.⁸⁶

Mbi Ligjin e ri për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi i vitit 2020

Si rezultat i situatës së krijuar, në të cilën Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi u shfuqizua ndërsa Kuvendi u shpërnda, kishte një nevojë urgjente dhe të shpejtë për të miratuar një ligj të ri menjëherë pas zgjedhjeve parlamentare më 15 korrik 2020. Duke pasur parasysh rrethanat në vend para zgjedhjeve, organizatat e shoqërisë civile u bënë thirrje partive politike që marrin pjesë në zgjedhjet parlamentare të mbështesin Deklaratën për miratimin me përparësi të Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi nga përbërja e ardhshme parlamentare.⁸⁷ Qëllimi i Deklaratës ishte që të detyrojë partitë politike të miratojnë ligjin menjëherë pas themelimit të Kuvendit të Republikës së Maqedonisë së Veriut, pa vonesa shtesë dhe që pastaj, në përputhje me afatin ligjor, ata do të zgjedhin përbërjen e re të Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi. Kjo Deklaratë për miratimin me përparësi të Ligjit u nënshkrua nga 17 parti politike.⁸⁸

Komiteti i Helsinkit, së bashku me organizatat e tjera të shoqërisë civile, kontribuan në vetë procesin e miratimit të Ligjit në procedurën parlamentare. Të kujdeshëm nga përvoja e mëparshme, kur zgjedhja e anëtarëve të Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi u shoqërua me një sërë lëshimesh (të tilla si mosrespektimi i afateve ligjore për shpalljen e konkursit dhe zgjedhjen e anëtarëve, shpalljen jo konsistente të konkurseve, praktika e mos shpalljes së biografive të kandidatëve dhe mos publikimi i dosjeve nga verifikimi fillestar i kandidaturave) në mbështetëm parashtrimin e një ndryshimi në Ligj në lidhje me procedurën për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit. Saktësisht, më 21 tetor 2020, në seancën e Komisionit për Çështjet Evropiane dhe Komisionit Legjislativ-Ligjor të Kuvendit, u mbajt leximi i dytë i Ligjit, ku edhe u shqyrtuan edhe ndryshimet e parashtruara. Asnjë nga ndryshimet e parashtruara nuk u miratua. Një prej tyre ishte ndryshimi i nenit 18, parashtruar nga deputetët Maja Moraçanin dhe Miroslav Bogdanovski, përfaqësuar nga Rrjeti për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Neni 18 i Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi rregullon procedurën për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit. Qëllimi i amendamentit të paraqitur ishte të garantojë pavarësinë e Komisionit, të garantojë një procedurë transparente dhe gjithëpërfshirëse të përzgjedhjes që është në përputhje me të gjitha standardet dhe rekomandimet ndërkombëtare, si dhe me mendimin e Komisionit të Venecias⁸⁹.

Ndryshimi i propozuar në nenin 18 së pari u pranua dhe propozua nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, por Qeveria refuzoi dhe paraqiti Projektligjin me të njëjtin tekst që ishte miratuar në vitin 2019, pa dhënë ndonjë

⁸⁶ Grupi Bluprint për reforma në sistemin gjyqësor. (12 qershor 2020). *Kur gardianët e zbatimit të ligjit dështojnë, qytetarët mbajnë barrën*. I disponueshëm në: <https://mhc.org.mk/news/odluka-za-ukinuvanje-na-zakonot-za-sprechuvanje-i-zashtita-od-diskriminacija/>.

⁸⁷ Rrjeti për Mbrojtje nga Diskriminimi dhe të tjerë (1 korrik 2020). *Thirrje për partitë politike për nënshkrimin e Deklaratës për miratimin me përparësi të Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut*. I disponueshëm në: <https://mhc.org.mk/news/povik-do-politichkite-partii-za-potpishuvanje-na-deklaracija-za-prioritetno-donesuvanje-na-zakonot-za-sprechuvanje-i-zashtita-od-diskriminacija-od-strana-na-sobranieto-na-republika-severna-makedonija/>.

⁸⁸ Partitë politike që kanë nënshkruar këtë Deklaratë janë (sipas rendit alfabetik): Aleanca për Shqiptarët, VMRO-DPMNE, Zëri për Maqedoninë, DEMOKRATËT, Lidhja Demokratike (LD), Partia e Gjellbër Rimëkëmbja Demokratike e Maqedonisë (DOM), Partia Liberlademokrate (PLD), Partia e Re Socialdemokrate (PRSD), Partia e Bashkuar për Barazi të Romëve (PBBR), Partia e Lëvizjes së Turqve (PLT), Partia për Prosperitet Demokratik të Romëve (PPDR), Partia për Ndryshime Ekonomike 21 (PNE21), Partia e Pensionistëve (PP), Partia për Emancipim të Plotë të Romëve (PEPR), Lidhja e Romëve të Maqedonisë, Lidhja Socialdemokrate e Maqedonisë (LSDM) dhe Partia Yte. – Rrjeti për Mbrojtje nga Diskriminimi. (17 korrik 2020). *17 parti politike nënshkruan deklaratën për miratimin me përparësi të Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi*. I disponueshëm në: <https://mhc.org.mk/news/17-politichki-partii-ja-potpishaa-deklaracijata-za-prioritetno-donesuvanje-na-zakonot-za-sprechuvanje-i-zashtita-od-diskriminacija/>.

⁸⁹ European Commission for Democracy through Law (Venice Commission). (2018, march 18). Opinion no. 915 / 2018 on the Draft Law on Prevention and Protection against Discrimination. I disponueshëm në: [https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=cdl-ad\(2018\)001-e](https://www.venice.coe.int/webforms/documents/default.aspx?pdffile=cdl-ad(2018)001-e).

shpjegim për këtë veprim.⁹⁰ Sidoqoftë, shumë kohë pas përfundimit të zgjedhjeve parlamentare, Kuvendi, më 27 tetor 2020 miratoi Ligjin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe i njëjti hyri në fuqi më 30 tetor 2020.

Ndryshimet e parashikuara në Ligjin e ri

Disa nga ndryshimet e parashikuara nga Ligji i ri i referoheshin zgjerimit të listës së arsyeve diskriminuese, duke futur orientimin seksual dhe identitetin gjinor në këtë listë; rritja e afateve brenda të cilave mund të paraqitet një ankesë në Komisionin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi; futja e segregacionit si një lloj i ri diskriminimi; prezantimi i konceptit të diskriminimit ndër-sektorial; zvogëlimi i kohëzgjatjes së procedurës pas një ankese të paraqitur, etj.



Во законот од 2020 година нов вид на дискриминација е **сегрегацијата**, која значи физичко одделување на лице или група лица врз дискриминаторска основа без легитимна или објективно оправдана цел. Воведена е и **интерсекциската дискриминација**, која претставува дискриминација врз две или повеќе дискриминаторски основи што се истовремено и неразделно поврзани.



Законот од 2020 година во таксативно наборените основи за дискриминација ги **содржи и** **сексуалната ориентација и родовиот идентитет, потеклото, националната припадност и политичко уверување.**



Претставка може да се поднесе **најдоцна во рок од шест месеци од денот** кога била сторена повредата или **најдоцна една година од дознавањето за актот на дискриминација.**

Комисијата дава мислење за наводната дискриминација во рок од **60 дена од денот на поднесувањето на претставката.**

Лицето на кое препораката е упатена, е должно да постапи по препораката и да ја **отстрани повредата на правото во рок од 30 дена од денот на приемот на препораката** или во подолг рок доколку постојат причини за тоа, но не подолго од шест месеци. Во спротивно Комисијата има законска обврска да поднесе барање за поведување на прекршочна постапка пред надлежен суд за прекршоци.⁹¹



Комисијата согласно законот од 2020 година има 26 таксативно наброени надлежности и овластувања кои се однесуваат на:

- засилување на превентивната функција,
- зголемено учество при изготвување на закони и политики од областа на недискриминацијата,
- проширени надлежности за постапување по службена должност во случаи на дискриминација,
- активно учество и иницирање судски постапки за заштита од дискриминација.

⁹⁰ Rrjeti për Mbrojtje nga Diskriminimi. (28 tetor 2020). *Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi mbetet të zgjidhet me marrëveshje partie?! I disponueshëm në: <https://mhc.org.mk/news/komisijata-za-sprechuvanje-i-zashtita-od-diskriminacija-ostanuva-da-se-izbira-po-pat-na-partiski-dogovor/>.*

Për Komisionin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi

Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, si një mekanizëm mbrojtës, ishte i paarritshëm për qytetarët nga gushti i vitit 2019 dhe gjatë gjithë vitit 2020, gjë që uli mbrojtjen efektive nga diskriminimi. Ligji i ri për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, me hyrjen e tij në fuqi, imponoi nevojën për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, si një organ i parashikuar nga vetë Ligji. Më saktë, Ligji përcakton që konkursi publik për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit do të publikohet nga Kuvendi brenda 15 ditëve nga dita e hyrjes në fuqi të tij.⁹¹ Më 24 nëntor 2020, Kuvendi miratoi një Vendim për shpalljen e një konkursi publik për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili zgjati 30 ditë nga dita e shpalljes së tij.⁹²

Për tërë periudhën që nga miratimi i Ligjit të ri, së bashku me organizatat e tjera të shoqërisë civile, Komiteti i Helsinkit monitoroi në mënyrë aktive procesin e zgjedhjes së anëtarëve të Komisionit.⁹³ Duke pasur parasysh zgjedhjen jotransparente të kuadrove partiake dhe joprofesionale për anëtarët në dy mandatet e kaluara të Komisionit, Rrjeti për Mbrojtjen nga Diskriminimi i kërkoi Kuvendit të zhvillojë një procedurë transparente, të përgjegjshme dhe të drejtë për zgjedhjen e anëtarëve të kualifikuar, të marrin parasysh cilësinë dhe përvojën e tyre në këtë fushë. Për më tepër, u kërkua informacion në kohë dhe i vazhdueshëm i qytetarëve, organizatave të shoqërisë civile dhe mediave sa i përket rrjedhës së procedurës. Një nga kërkesat tona ishte të zhvillonim një debat publik në të cilin do të prezantohen kandidatët për anëtarë, ndërsa shoqatat, media dhe palët e tjera të interesit do të kenë mundësinë t'u bëjnë pyetje kandidatëve dhe të diskutojnë në lidhje me kandidaturën e tyre. Për këtë qëllim, ishte e nevojshme që Kuvendi të publikonte biografite të kandidatëve të regjistruar në faqen e tij të internetit para mbajtjes së debatit publik. Për një përfundim plotësisht transparent të procedurës, një kërkesë i referohej një transmetimi të drejtpërdrejtë të debatit publik, dmth dëgjimit/intervistimit të kandidatëve të paraqitur në konkurs, në kanal televiziv të Kuvendit. Duke iu referuar nenit 16 paragrafi 5 të Ligjit i cili përcakton që anëtarët e Komisionit duhet të pasqyrojnë përbërjen e shoqërisë si një e tërë, Rrjeti për Mbrojtjen nga Diskriminimi kërkoi që Kuvendi t'i kushtojë vëmendje parimeve të përfaqësimit adekuat dhe të drejtë të të gjitha grupeve dhe komuniteteve shoqërore, si dhe pjesëmarrje dhe zgjedhje të baraspeshuar gjinore të personave të cilët në asnjë mënyrë nuk janë të lidhur me partitë politike.⁹⁴

Në kohën e përgatitjes së këtij raporti - shkurt 2021, u formua Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi. Gjegjësisht, me 61 vota pro, pa vota kundër dhe abstenime, Kuvendi më 25 janar 2021 miratoi vendimin për zgjedhjen e shtatë anëtarëve të Komisionit.

⁹¹ Neni 45 paragrafi 1 i Ligjit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi. („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.258/2020 i datës 30.10.2020).

⁹² Vendim për shpalljen e konkursit publik për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi. („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.279/2020).

⁹³ Rrjeti për Mbrojtje nga Diskriminimi. (19 shtator 2020). *Rrjeti për Mbrojtjen nga Diskriminimi kërkon një përzgjedhje transparente të anëtarëve të KPMD-së*. I disponueshëm në: <https://mhc.org.mk/news/mrezhata-za-zashtita-od-diskriminacija-bara-transparenten-izbor-na-chlenovi-na-kszd/>. Rrjeti për Mbrojtje nga Diskriminimi. (28 tetor 2020). *Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi mbetet të zgjidhet me marrëveshje partie?! I disponueshëm në: <https://mhc.org.mk/news/komisijata-za-sprechuvanje-i-zashtita-od-diskriminacija-ostanuva-da-se-izbira-po-pat-na-partiski-dogovor/>.*

Rrjeti për Mbrojtje nga Diskriminimi. (1 nëntor 2020). *Kuvendi menjëherë të fillojë procedurat për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi dhe një Avokat të ri Populli*. I disponueshëm në: <https://mhc.org.mk/news/sobranieto-itno-da-gi-zapochne-postapkite-za-izbor-na-chlenovi-na-komisijata-za-sprechuvanje-i-zashtita-od-diskriminacija-i-nov-naroden-pravobranitel/>.

⁹⁴ Rrjeti për Mbrojtje nga Diskriminimi. (23 dhjetor 2020). *Ne i kërkojmë Kuvendit që në një procedurë transparente të zgjedhë anëtarë profesionistë dhe të pavarur të Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi*. I disponueshëm në:

<https://mhc.org.mk/news/barame-sobranieto-vo-transparentna-postapka-da-izbere-profesionalni-i-nezavisni-chlenovi-na-komisi%20d1%98ata-za-sprechuva%20d1%9ae-i-zashtita-od-diskriminaczi%20d1%98a/>.

VAZHDON DISKRIMINIMI SISTEMIK I ROMËVE

Romët janë ndër grupet më të prekshme në një gjendje pandemike duke pasur parasysh se shumë prej tyre nuk kanë qasje në ujë të pijshëm, të pastër dhe të sigurt dhe në materiale higjienike, gjë që parandalon zbatimin efektiv të masave të rekomanduara të higjienës si çelësi për mbrojtjen nga koronavirusi.⁹⁵ Duke pasur parasysh që grupet e cënueshme dhe të marginalizuara të qytetarëve nuk kanë mundësi të barabarta për të praktikuar masa parandaluese për t'u mbrojtur kundër virusit, të tilla si ruajtja e higjienës, distanca fizike dhe vetë-izolimi, organizatat e shoqërisë civile paraqitën një seri kërkesash për masa që duhen adaptuar, të cilat do të korrespondojnë me nevojat e këtyre qytetarëve.⁹⁶ Një pjesë e kërkesave të parashtruara janë:

- Kërkesë për përmirësimin e mbrojtjes së popullatës në komunën e Shuto Orizarit nga përhapja e epidemisë me COVID-19 duke shtuar një pikë për testim, dezinfektim dhe informim;
- Kërkesë për marrjen e masave parandaluese për të parandaluar përhapjen e epidemisë COVID-19 në komunën e Shuto Orizarit;
- Kërkesë për marrjen e masave parandaluese për të parandaluar përhapjen e epidemisë COVID-19 në vendbanimet substandarde dhe në lagjet substandarde në Republikën e Maqedonisë së Veriut.⁹⁷

Brutaliteti policor dhe profilizimi racor i romëve.

Që nga fillimi i pandemisë, publiku u trazua nga rasti i një grupi muzikantësh - romë, të cilët në mënyrë të organizuar po ktheheshin në vend nga Italia. Ata u dërguan në karantinë në Pepelishte dhe pas reagimeve ndaj kushteve të këqija të akomodimit, ata u zhvendosën në ambiente të tjera në Demir Kapi. Nga ana tjetër, të gjithë pasagjerët e tjerë (rreth 200), të cilët hynë në vend atë ditë, u drejtuan të vetizoloheshin në shtëpitë e tyre. Përveç profilizimit të dukshëm racor, gjatë vitit të kaluar u shënuan incidente serioze, të cilat flasin për paragjykitime raciste midis oficerëve të policisë që çojnë në sjellje dhe veprime arbitrare, joprofesionale dhe të paligjshme.

Brutaliteti policor ndaj njerëzve të pastrehë

Më 10 qershor 2020, disa media botuan një artikull në të cilin qytetarët deklaruan se ishin viktime të dhunës nga oficerët e policisë. Bëhej fjalë për njerëz të pastrehë, anëtarë të bashkësisë etnike rome, të cilët jetonin pranë ndërtesës së Fondit pensional të në Shkup. Ngjarja ndodhi gjatë kohës së orës policore, kur, sipas deklaratave të të dëmtuarve, rreth njëzet anëtarë të policisë për ndërhyrje të shpejtë përdorën forcë fizike ndaj personave që ishin në vendin e caktuar, përfshirë gratë, fëmijët dhe të moshuarit, të cilët nuk ishin fare të përfshirë në këtë rast. Suzana Demir, e cila kishte të nxira në duar nga rrahja, i tha CIVIL Media se "[oficerët e policisë] nuk dallonin nëse godisnin burra, gra, të moshuar apo fëmijë."⁹⁸ Ministria e Punëve të Brendshme dërgoi informacion në media se oficerët e policisë nga Stacioni Policor Aerodrom morën masa dhe aktivitete për konstatimin e shkeljeve të orës policore nga një grup qytetarësh të cilët ishin mbledhur në një vend publik dhe prishnin rendin dhe qetësinë publike duke lëshuar muzikë me zë të lartë.⁹⁹ Sipas deklaratës së Ministrisë së Punëve të Brendshme, pesë persona sulmuan fizikisht oficerët e policisë dhe ata persona u identifikuan, u privuan nga liria dhe kundër tyre u inicua procedurë për konstatimin e kundërvajtjes, përkatësisht përgjegjësisë penale. Prandaj, ekzistojnë dyshime se me përdorimin e tepuar dhe të pabazuar të forcës ndaj personave që në asnjë mënyrë nuk ishin të përfshirë në ngjarje, oficerët e policisë kryen veprën penale "Torturë në kryerjen e detyrës zyrtare". Në këtë mënyrë, oficerët e policisë shkelën dinjitetin dhe integritetin fizik të romëve të pranishëm dhe nëse kjo është motivuar nga paragjykitime raciste, një veprim i tillë është diskriminues. Përmes Rrjetit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Sektorit për kontroll të brendshëm, hetime kriminale dhe standarde

⁹⁵ Council of Europe Commissioner for Human Rights. (2020, April 7). *Governments must ensure equal protection and care for Roma and Travellers during the COVID-19 crisis*. I disponueshëm në: <https://www.coe.int/en/web/commissioner/-/governments-must-ensure-equal-protection-and-care-for-roma-and-travellers-during-the-covid-19-crisis>.

⁹⁶ Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe të tjerë. (5 maj 2020). *(Pa)përgjegjësia e institucioneve për qytetarët më të prekshëm në kohë krize*. I disponueshëm në: <https://mhc.org.mk/news/neodgovornosta-na-instituciite-za-najranlivite-gragani-vo-uslovi-na-kriza/>.

⁹⁷ Të gjitha kërkesat dhe përgjigjet nga institucionet janë në dispozicion në: <https://fosh.mk/baranja-i-itni-preporaki-ispratene-do-nadlezhnite-institucii/>.

⁹⁸ CIVIL Media „Brutaliteti policor ndaj të pastrehëve, nga MPB-ja thonë - ata kishin lëshuar muzikë me zë të lartë dhe ishin të dhunshëm!“ <https://civilmedia.mk/politsiska-brutalnost-vrz-bezdomnitsi-od-mvr-velat-pushtaa-glasna-muzika-i-bea-nasilni/>.

⁹⁹ Ibid.

profesionale pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme iu kërkua të fillojë një procedurë për të hetuar rastin dhe të përcaktojë përgjegjësinë personale të secilit polic që ka tejkaluar autorizimin e tij zyrtar, si dhe nga të gjithë personat që kanë lëshuar një urdhër të tillë. Kështu, nëse konstatohet një abuzim i kompetencave të oficerëve të policisë, duhet të fillohet një procedurë penale dhe të shqiptohet sanksioni më i ashpër ndaj tyre.

Brutalitet policor ndaj romëve në Manastir

Në muajin shtator, një video u postua në mediat sociale që tregonte qartë oficerë policie duke përdorur forcë serioze fizike kundër disa anëtarëve të komunitetit rom në Manastir. Incidenti ndodhi më 22 shtator 2020, kur tre romë patën një aksident automobilistik dhe goditën një mur prej betoni. Menjëherë aty afër ndodheshin anëtarë të policisë rrugore, të cilët pa ndonjë arsye i nxorën njerëzit nga makina dhe filluan t'i rrahin brutalisht. Për më tepër, personat u mbajtën në stacionin e policisë deri në orën pesë të mëngjesit, ku u fyen dhe u ngacmuan. Ata donin të raportnin rastin në Departamentin e kontrollit të brendshëm, hetimit penal dhe standardeve profesionale, por nuk u lejuan ta bëjnë këtë. Për shkak të motiveve të dukshme raciste dhe diskriminuese, ne i kërkuan Ministrisë së Punëve të Brendshme të punojë intensivisht në zbardhjen e rastit dhe përcaktimin e përgjegjësisë penale të oficerëve të policisë në përputhje me nenin 142 "Torturë dhe trajtime ose dënime të tjera mizore, çnjerëzore ose degraduese" dhe nenin 143 "Torturë gjatë kryerjes së detyrës zyrtare". Publiku duhet të informohet në kohën e duhur për të gjithë procesin e hetimit dhe veprimet e ndërmarra kundër oficerëve të policisë. Duke marrë parasysh që praktika e mosndëshkimit të oficerëve të policisë që shkelin ligjin dhe tejkalojnë autoritetin e tyre është një nga arsyet e kësaj sjelljeje brutale, Komiteti i Helsinkit kërkoi nga Ministria e Punëve të Brendshme që menjëherë të hapte një proces gjithëpërfshirës të ndryshimeve në Ligjin për Policinë dhe Rregulloren për kryerjen e punëve policore, si dhe të miratojë akte nënligjore që do të adresonin problemin strukturor të veprimeve raciste të policëve.

Pas hetimit të kryer, Departamenti i kontrollit të brendshëm informoi Komitetin më 25 shtator 2020 se kundër oficerit të policisë G.P. është ngritur kallëzim penal nën dyshimin e kryerjes së veprës penale të "Torturës gjatë kryerjes së detyrës zyrtare". Siç thuhej në shkresën e Ministrisë, oficeri i policisë ishte sulmuar fizikisht, për të cilin u parashtrua një kallëzim përkatës në Prokurorinë Publike në Manastir. Sidoqoftë, oficeri i policisë në ndërmarrjen e veprimeve zyrtare, pasi pushuan arsyet e përdorimit të mëtejshëm të forcës fizike, tejkaloi kufijtë e autoritetit të tij zyrtar dhe vazhdoi të përdorë forcën fizike ndaj palës së dëmtuar ndërsa ai ishte shtrirë në tokë (derisa ka dhënë rezistencë fizike) dhe në këtë mënyrë ka degraduar dinjitetin dhe personalitetin e tij njerëzor. Kontrolli i brendshëm gjithashtu kishte sugjeruar edhe pezullimin e oficerit nga puna. Në lidhje me oficerin e policisë, i cili monitoroi pasivisht çështjen dhe nuk ndërmori veprime për ta parandaluar atë, Kontrolli i brendshëm propozoi një procedurë për përgjegjësi disiplinore për shkelje më serioze të rendit dhe disiplinës së punës dhe fillimin e një procedure për pezullimin nga puna. Për oficerët e tjerë të policisë në vendngjarje, drejtuesit të drejtpërdrejt të njësisë organizative ku ata punojnë, iu sugjerua të qortojë sjelljen e tyre të papërshtatshme dhe kryerjen e detyrave të punës, por edhe mundësinë e përgjegjësisë disiplinore, nëse ata nuk tregojnë përmirësim gjatë kryerjes së punës së tyre.¹⁰⁰

Brutalitet policor ndaj një nëne dhe djalit të saj në Manastir

Pas rastit të regjistruar në Manastir në muajin shtator, në opinion u shpërnda një informacion në lidhje me një rast të ri në këtë qytet me indikacione të dhunës ndaj romëve nga oficerët e policisë. Sipas organizatës AVAJA, kësaj here policia përdori forcë të tepruar ndaj një gruaje të moshuar rome dhe djalit të saj. Ata u ndaluan sepse djali nuk kishte një kartë identiteti në kohën kur oficerët e policisë i kishin kërkuar të identifikoheshin. Ata i futën në një furgon policie, ku dyshohet se u rrahën dhunshëm nga oficerët e policisë dhe u fyen për shkak të përkatësisë së tyre etnike. Komiteti i Helsinkit, së bashku me Shoqatën Maqedonase të Juristëve të Rinj, ofruan ndihmë juridike për viktimat e brutalitetit policor dhe angazhoi një avokat që i përfaqësoi ata përpara autoriteteve kompetente. Gruaja dhe djali i saj nuk u ndaluan në paraburgim, por policia refuzonte të pranonte një denoncim, madje edhe pas disa përpjekjeve nga ana e

¹⁰⁰ Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. (22 tetor 2020). *Kallëzim penal dhe pezullim nga puna për policin që rrahu romët në Manastir*. I disponueshëm në: <https://mh.org.mk/news/krivichna-prijava-i-suspenzija-za-policaecot-koj-tepashe-romi-vo-bitola/>.

avokatit. Përveç hetimit të këtij rasti të veçantë të sjelljes brutale të oficerëve të policisë të motivuar nga motive raciste dhe diskriminuese, ne i bëjmë apel Ministrisë së Punëve të Brendshme të marrë të gjitha masat preventive për të parandaluar praktikën e vjetër të trajtimit joprofesional, profilizimit racor, krimin e urrejtjes, arbitraritet dhe brutalitet policor në marrëdhëniet me romët dhe kategoritë e tjera të qytetarëve të varfër dhe të marginalizuar.

Duke pasur parasysh se reagimi i shpejtë i Ministrisë në rastin e mëparshëm të brutalitetit policor ndaj romëve në Manastir është një përjashtim, jo një rregull, u kërkua që të sanksionohen të gjitha rastet e tilla kur oficerët e policisë shkelin ligjin dhe tejkalojnë autoritetin e tyre.

Rekomandimi i përgjithshëm numër 36 i Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit Racor

Në seancën e tij të 102-të, të mbajtur nga 16 deri më 22 nëntor 2020, Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit Racor miratoi Rekomandimin e tij të përgjithshëm nr. 36 për parandalimin dhe luftimin e profilizimit racor nga ana e oficerëve të policisë.¹⁰¹

Në këtë Rekomandim, Komiteti e identifikoi praktikën e profilizimit racor në polici si një shkelje të vlerave themelore dhe të drejtave të njeriut bazuar në 1) mosdiskriminimin për shkak të racës, ngjyrës, origjinës, përkatësisë kombëtare ose etnike (dhe të tjera bazat ndërsektoriale) dhe 2) barazinë para ligjeve. Profilizimi racor shkel të drejtat procedurale dhe të drejtën për një gjykim të ndershëm dhe të drejtë. Komiteti thekson më tej detyrimin e shteteve nga Konventa për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit Racor, të mos marrin pjesë në aktivitete dhe praktika të profilizimit racor kundër individëve ose grupeve të njerëzve. Rekomandimi parashikon detyrimin që shtetet të ndryshojnë vazhdimisht politikën, ligjet dhe rregulloret e tjera në mënyrë që të parandalojnë shfaqjen e profilizimit racor. Shtetet janë të detyruara të sigurojnë masa mbrojtëse të përshtatshme dhe efektive kundër profilizimit racor në rendin e brendshëm ligjor dhe të sigurojnë mekanizma për kompensimin e dëmit të shkaktuar nga kjo praktikë (në nivel individual ose kolektiv).¹⁰²

Profilizimi racor ka efekte negative dhe kumulative në mirëqenien e individëve dhe komuniteteve, duke pasur parasysh që një person mund t'i nënshtrohet profilizimit racor në baza ditore në jetën e tij ose të saj. Viktimat e profilizimit racor shpesh e përvetësojnë ndikimin e tij në mes të mungesës së ilaçeve dhe mjeteve juridike efektive. Në të njëjtën kohë, kjo krijon një mosbesim të madh midis viktimave të profilizimit racor në institucionet kompetente të zbatimit të ligjit. Ato krijojnë një ndjenjë padrejtesie, poshtërimi dhe frike nga përsëritja, dhe ata gjithashtu bëhen viktime të mundshme të viktimizimit të sërishëm.¹⁰³

Ndër të tjera, profilizimi racor mund të çojë në kriminalizim të tepruar të kategorive të caktuara të personave; forcim të shoqërive stereotipike midis krimin dhe përkatësisë etnike të kryerësit; nivele joproportionale të burgosjes në kategoritë e mbrojtura nga Konventa; rritje e ndjeshmërisë së personave që i përkasin grupeve të mbrojtura nga Konventa; mosraportim i akteve të diskriminimit racor dhe krimeve të urrejtjes; dhe shqiptim të ndëshkimeve më të ashpra nga gjykatat kundër anëtarëve të komuniteteve të synuara.¹⁰⁴

¹⁰¹ Committee on the Elimination of Racial Discrimination. (2020, November 24). *General recommendation No. 36 (2020) on preventing and combating racial profiling by law enforcement officials*. I disponueshëm në:

https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolno=CERD/C/GC/36&Lang=en.

¹⁰² Ibid.

¹⁰³ Ibid.

¹⁰⁴ Ibid.

PERSONAT ME AFTËSI TË KUFIZUARA

Personat me aftësi të kufizuara dhe pandemia¹⁰⁵

Personat me aftësi të kufizuara janë ende një nga grupet më të marginalizuara në shoqëri, i cili është prekur në mënyrë disproporcionale nga efektet e pandemisë, si në vendin tonë ashtu edhe në gjithë botën. Megjithatë aftësia e kufizuar nuk do të thotë në vetvete që një person rrezikon më shumë të preket nga virusi, shumë njerëz me aftësi të kufizuara kanë një gjendje shëndetësore më të ndjeshme, gjë që i vë ata në rrezik më të madh nga sëmundja. Mosqasja e informacioneve në lidhje me virusin, mbyllja e qendrave të kujdesit ditore, mësimi në distancë i papërshtatur, si dhe pamundësia e distancës sociale për njerëzit e varur nga mbështetja në kryerjen e funksioneve ditore, janë vetëm disa nga sfidat me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara.

Me fillimin e pandemisë, Organizata Botërore e Shëndetësisë paralajmëroi për një rrezik në rritje për njerëzit me aftësi të kufizuara nga kontraktimi i virusit, kryesisht për shkak të pengesave ekzistuese ndaj masave themelore të higjienës, vështirësive në praktikimin e distancës sociale për shkak të nevojës për mbështetje shtesë ose jetesës në një institucion, nevojave për të prekur si një mënyrë e marrjes së informacionit nga mjedisi, problemet e mëparshme shëndetësore, etj.¹⁰⁶ Veçanërisht e palakmueshme është situata e personave me aftësi të kufizuara të cilët kanë një status shëndetësor të mëparshëm dhe/ose jetojnë në një institucion, i cili është një tregues i dobësive të sistemit të shërbimit publik dhe qasjes së pabarabartë në të për kategori të caktuara të ndjeshme.¹⁰⁷

Nëse marrim parasysh që edhe në kushte "normale" personat me aftësi të kufizuara kanë qasje të vështirë në shërbime shëndetësore, arsim, punësim, media, etj., në kushtet e krizës shëndetësore mundësia e qasjes në disa të drejta për këta njerëz mund të pamundësohet në mënyrë të konsiderueshme.

Te personat me aftësi të kufizuara, veçanërisht te personat me aftësi të kufizuara intelektuale dhe te personat me çrregullime të spektrit autik, një segment shumë i rëndësishëm i funksionimit është edhe rutina e përditshme. Në kushtet kur lëvizja është e kufizuar me orar, por edhe fizikisht, ka një ndryshim në rutinë, e cila te shumë njerëz me aftësi të kufizuara mund të shkaktojë ankth. Për këtë arsye, ata çersona që kujdesen për fëmijët dhe personat me aftësi të kufizuara janë përballur me sfidën për të gjetur mënyra alternative të funksionimit në baza ditore dhe për të krijuar rutina të reja. Mbyllja e qendrave ditore përbënte një sfidë shtesë për personat me aftësi të kufizuara që rregullisht frekuentonin qendrat ditore si pjesë e funksionimit të tyre të përditshëm, por edhe për kujdestarët, duke pasur parasysh që ata duhet të qëndrojnë në shtëpi, që shpesh nënkupton edhe humbjen e vendit të punës.

Duke pasur parasysh se për një pjesë të madhe të personave me aftësi të kufizuara lëvizja është një aktivitet terapeutik dhe pjesë e një shprehje të vendosur, Qeveria e RMV-së miratoi një dekret përmes të cilit vendosi një regjim të veçantë të lëvizjes për personat me aftësi të kufizuara për sa kohë do të zgjasë ora policore.¹⁰⁸ Personat me aftësi të kufizuara mund të dilnin me një shoqërues në kushte të caktuara të lëvizjes, dhe për këtë qëllim ata nuk ishin të

¹⁰⁵ Të dhënat për situatën e të drejtave të personave me aftësi të kufizuara gjatë gjendjes së jashtëzakonshme janë të disponueshme në *Raportin e veçantë për situatën e të drejtave të njeriut në kohën e Covid-19*, të cilin e publikoi Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në muajin tetor 2020. I disponueshëm në: https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2020/10/izvestaj-mk_compressed.pdf

¹⁰⁶ OBSH. (26 mars 2020). *Disability considerations during the COVID-19 outbreak*. I disponueshëm në: <https://www.who.int/publications-detail/disability-considerations-during-the-covid-19-outbreak>

¹⁰⁷ OKB. (23 prill 2020). *COVID-19 and Human Rights- We are all in this together*. I disponueshëm në: https://www.un.org/development/desa/disabilities/wp-content/uploads/sites/15/2020/04/un_policy_brief_on_human_rights_and_covid_23_april_2020.pdf

¹⁰⁸ I disponueshëm në: <https://vlada.mk/node/20925>

detyruar të marrin një leje të veçantë për lëvizje, por vetëm të kishin me vete një akt diagnoze ose vendim që vërteton aftësinë e kufizuar.¹⁰⁹

Masat kufizuese, të cilat kryesisht konsistojnë në rekomandime për vetëizolim dhe distancim shoqëror, ishin jashtëzakonisht të vështira për t'u zbatuar nga shumë njerëz me aftësi të kufizuara, veçanërisht duke pasur parasysh që një pjesë e konsiderueshme e tyre varej nga mbështetja e të tjerëve, ndonjëherë në kryerjen e nevojave themelore fiziologjike. Lidhur me masat për mbështetjen e personave me aftësi të kufizuara, vetëm 27 komuna në vend ishin përfshirë nga masa e Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale për ofrimin e mbështetjes në shtëpi.¹¹⁰ Kjo masë kishte për qëllim të lehtësonte funksionimin e përditshëm të personave me aftësi të kufizuara, përfshirë ndihmën për zbatimin e procedurave urgjente administrative, furnizimet dhe mbështetjet tjera në përputhje me nevojat e personit.

Një rrethanë lehtësuese ishte vendimi i Qeverisë për të zvogëluar procedurat administrative, të cilat i referohen përdorimit të të drejtave të caktuara nga mbrojtja sociale, ku përfituesit nuk ishin të detyruar të rinovojnë dokumentacionin e nevojshëm nëse duan të vazhdojnë të përdorin përfitime të caktuara, kurse për shfrytëzimin e shërbimeve të caktuara dokumentacionin mund ta paraqisnin në mënyrë elektronike.

Lidhur me procesin arsimor, Kombet e Bashkuara kanë paralajmëruar që kriza aktuale do të ndikojë seriozisht në rritjen e përjashtimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në procesin arsimor. Sipas këtyre vlerësimeve, fëmijët me aftësi të kufizuara do të përfitojnë më pak nga aplikimi i zgjidhjeve alternative të mësimin në distancë, gjë që shoqërohet edhe nga mungesa e mbështetjes në shtëpi, paarritshmëria në internet, mungesa e qasjes në programe dhe materiale mësimore.¹¹¹ Duke pasur parasysh të gjitha këto pengesa, ekziston një rrezik i lartë i ndërprerjes së plotë të arsimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara në këtë periudhë, gjë që do të komplikonte më tej kthimin në procesin arsimor pas përfundimit të krizës. Në planin afatgjatë, ky hendek në procesin arsimor do të kontribuojë më tej në thellimin e hendekut për pjesëmarrje në tregun e punës, i cili tashmë është dukshëm më i madh për personat me aftësi të kufizuara.

Në vendin tonë, fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, dhe veçanërisht fëmijët me aftësi të kufizuara, u përballën me sfida të shumta me fillimin e pandemisë. Platformat online të mësimin në distancë, të cilat zëvendësuan arsimin e rregullt, përjashtuan shumicën e fëmijëve me aftësi të kufizuara që nga fillimi i izolimit. Shkollimi i tyre gjatë kësaj periudhe u është lënë plotësisht në dorë prindërve të tyre dhe vullnetit të disa prej asistentëve arsimorë. Më shumë se një muaj pas mbylljes së shkollave, vetëm në fund të prillit 2020 u promovua platforma online për mësim dhe zhvillim të fëmijëve me aftësi të kufizuara, e cila duhet të sigurojë mbështetje shtesë, akses të individualizuar dhe klasa të modifikuara për fëmijët që të jenë në gjendje të vazhdojnë procesin arsimor dhe në kushte shtëpiake.

Ligji Gjithëpërfshirës për Arsimin Fillor u miratua në gusht të vitit 2019 dhe filloi të zbatohet në fillim të vitit shkollor 2019/2020. Sipas ligjit, arsimit fillor ishte i organizuar institucionalisht, me kuadro dhe përmbajtje, në mënyrë që të mundësojë përfshirjen e të gjithë fëmijëve në procesin e rregullt arsimor. Megjithatë, edhe në fillim të vitit të ri shkollor, ende nuk ishin miratuar aktet nënligjore që supozohej të siguronin zbatimin e duhur të Ligjit dhe përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në procesin arsimor nga të gjitha aspektet, dhe veçanërisht për të eliminuar mangësitë e shumta, për të cilat Komiteti i Helsinkit ka alarmuar disa herë që nga fillimi i zbatimit të tij.

¹⁰⁹ I disponueshëm në: http://www.mtsp.gov.mk/pocetna-ns_article-licata-so-poprecenost-ne-treba-da-vadat-dozvola-za-dvizenje-so-sebe-danosat-naod.nsp

¹¹⁰ I disponueshëm në: http://mtsp.gov.mk/pocetna-ns_article-licata-so-poprecenost-i-starite-lica-vo-27-opstini-kje-dobijat-asistencija-za-polesno-spravuvanje-s.nsp

¹¹¹ OKB. (maj 2020). *Policy Brief: A Disability-Inclusive Response to COVID-19*. I disponueshëm në: https://www.un.org/sites/un2.un.org/files/sg_policy_brief_on_persons_with_disabilities_final.pdf

MBËSHTETJA NË KOMUNITET

Përkundër faktit se në vend ekzistojnë zgjidhje ligjore relativisht të mira që përshkruajnë të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, si dhe standardet për sigurimin e aksesit në të mirat dhe shërbimet publike, zbatimi i tyre është akoma në një nivel shumë të ulët. Nga aksesit fizik në vetë infrastrukturën, deri te përdorimi i shërbimeve publike, ekzistojnë pengesa serioze për funksionimin e përditshëm shoqëror të personave me aftësi të kufizuara, por edhe të personave që kujdesen për ta. Puna afatgjatë e Komitetit të Helsinkit në këtë fushë tregon se personat me aftësi të kufizuara dhe familjet e tyre përballen me diskriminim çdo ditë, si dhe çështje të tjera ligjore në sfera të ndryshme, për të cilat ata nuk janë gjithmonë të informuar se ku mund të adresojnë, të paktën për mekanizmat mbrojtës që i kanë në dispozicion.

Në raportin për zbatimin e projektit "Fuqizimi juridik në komunitet në procesin e deinstitutionalizimit"¹¹², i cili u zbatua në periudhën nga gushti 2019 deri në gusht 2020, paraqet disa nga pengesat që hasen më shpesh nga kujdestarët dhe/ose personat me aftësi të kufizuara në ushtrimin e të drejtave të tyre, veçanërisht në lidhje me shkallën e njohjes së diskriminimit, përkatësisht shkeljes së një të drejte të tyre. Në kuadër të projektit, përdoruesit e gjashtë qendrave ditore të kujdesit ditor për fëmijë dhe persona me aftësi të kufizuara (nga gjithsej 32 në vend), respektivisht personat që kujdesen për personat me aftësi të kufizuara që përdorin shërbimet e qendrave ditore, ndanë përvojat e tyre në lidhje me problemet më të zakonshme me të cilat përballen gjatë ushtrimit të të drejtave të tyre, si dhe mënyrat në të cilat përballen me to.

Në kontakt të drejtpërdrejtë, prindërit dhe kujdestarët e fëmijëve dhe personave me aftësi të kufizuara flasin relativisht lirshëm për problemet e tyre. Shumica e tyre treguan një nivel relativisht të lartë të vetëdijës dhe aftësisë për të njohur rastet e diskriminimit dhe shkeljet e të drejtave të tyre, madje edhe në rastet e diskriminimit indirekt ose diskriminimit përmes asociacionit. Megjithatë, vetëm një numër i vogël i tyre i kanë denoncuar rastet në institucionet përkatëse. Gjegjësisht, 55.6% deklaruan se përballen me një situatë ku ata ishin diskriminuar dhe/ose të drejtat e tyre ishin shkelur, nga të cilat vetëm 36% kishin raportuar rastin, dhe vetëm 37.5% thanë se ishin të kënaqur me procedurën. Kur bëhet fjalë për arsyet e mos raportimit të diskriminimit, 29.8% thanë se nuk besonin se ndonjë gjë do të ndryshonte po të raportonin rastin, dhe pak më pak (21.3%) nuk kishin raportuar për shkak të mosbesimit në institucione. 17% nuk kishin raportuar për shkak të frikës nga pasojat e mëtejshme të dëmshme dhe 14.9% nuk kanë pasur njohuri se ku duhej të raportonin rastin. Numri më i madh i personave që aplikojnë për ndihmë juridike falas në Komitetin e Helsinkit fillimisht duket se janë të inkurajuar të ndërmarrin veprime të mëtejshme ligjore, por përsëri shumica e tyre, pas kontaktit fillestar heqin dorë pikërisht për shkak të mosbesimit në institucione.

Për sa i përket sferave, këta persona më shpesh përballen me diskriminim në arsimin parashkollor (42.5%) dhe mbrojtjen sociale (38.3%), shëndetësinë (34%), arsimin fillor (31.9%) dhe transportin publik (29.8%). Krahasuar me fushat e tjera, gati 40% tregojnë diskriminim në një prej niveleve të procesit arsimor.

Një nga problemet më të zakonshme është ende mungesa e infrastrukturës, duke filluar nga vetë institucionet, te rrugët, trotualet, parkingjet dhe ndërtesat publike. Mungesa në qasje është një problem serioz, madje edhe kur personi lëviz me një shoqërues. Në disa nga deklaratat u theksua se ka ende mosrespektim të ligjeve në lidhje me ndërtimin dhe planifikimin urban me rastin e ndërtimit të ndërtesave dhe objekteve të tjera banesore.

Shumica e personave thanë se nuk mund të gëzonin të drejtat e tyre në vendin e punës, megjithëse ishin të vetëdijshëm për ato të drejta. Lidhur me të drejtën për një pagë për orar të shkurtuar të punës, pavarësisht se ishin të informuar, disa pjesëmarrës kishin paqartësi rreth mënyrës se si paguhej paga, dhe shumica thanë se ata ende kishin frikë se mos humbin vendin e tyre të punës (veçanërisht nëse ishin të punësuar në kompani private). Disa prej tyre

¹¹² Jovanovska, B. (2020). *Fuqizimi juridik në komunitet në procesin e deinstitutionalizimit: Raport*. Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut. I disponueshëm në: <https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2020/10/finalen-izveshta%D1%98-uniczef-mk.pdf>

nuk kanë kërkuar kurrë të ushtrojnë disa nga të drejtat e tyre, edhe pse disa tashmë kanë një dokument që u lejon atyre të punojnë me orar të shkurtuar të punës.

Problemet më të zakonshme me të cilat përballen njerëzit që kujdesen për fëmijët me aftësi të kufizuara janë të identifikuar në procesin arsimor. Një nga problemet që ata tregojnë është rezistenca ndaj pranimit të fëmijëve të tyre në kopshte dhe shkolla të caktuara, si dhe transferimi i tyre i vazhdueshëm nga një institucion arsimor në një tjetër, si dhe nevoja për ekipe profesionale në të gjitha kopshtet dhe shkollat. Mungesa e qasjes është ende një problem i madh edhe në institucionet edukativo-arsimore.

Një numër i konsiderueshëm i njerëzve që kujdesen për personat me aftësi të kufizuara besojnë se ata nuk janë mjaft të informuar për të drejtat e tyre, as për proceset e miratimit të masave dhe ligjeve të reja, duke shprehur pakënaqësi me përfshirjen e tyre të pamjaftueshme dhe shpërfilljen e nevojave dhe kërkesave të tyre në procesin e miratimit të tyre. Prandaj, shkalla e lartë e rezistencës dhe skepticizmit të këtyre njerëzve kur bëhet fjalë për futjen e ndryshimeve, respektivisht ligjeve të reja, masave, standardeve dhe të ngjashme, pavarësisht nëse është një risi që synon të lehtësojë funksionimin e tyre të përditshëm. Duke pasur parasysh dekurajimin dhe mosbesimin e përgjithshëm për të kërkuar të drejtat e tyre para institucioneve përkatëse, është e nevojshme të punohet në forcimin e besimit në institucione të personave me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre, si dhe përfshirjen e tyre aktive në proceset e vendimmarrjes që janë të një rëndësie thelbësore për ushtrimin e të drejtave të tyre, por edhe për plotësimin e nevojave specifike.



Fushatë për ndihmë juridike falas për personat me aftësi të kufizuara

PËRFAQËSIMI NDËRKOMBËTAR

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në vitin 2015, në emër të të personit të mitur L.R., një person me paaftësi të kombinuar, parashtroi një kërkesë në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut për mbrojtjen e të drejtave për shkak të trajtimit çnjerëzor dhe degradues të kryer nga stafi i Institutit të Rehabilitimit "Banja Bansko". Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut miratoi një aktgjykim më 23 janar 2020, me të cilin konstatoi unanimisht shkelje të nenit 3 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut - Ndalimi i trajtimit çnjerëzor ose degradues. Ky aktgjykim është një precedent i llojit të vet në lidhje me pranimin e kërkesës në emër të një të mituri me aftësi të kufizuara, pa pasur mundësi që ai të japë pëlqimin e tij për t'u përfaqësuar para Gjykatës Evropiane.

Rasti ka të bëjë me një fëmijë tetë vjeç, i cili gjatë një vizite nga Avokati i Popullit në vitin 2013 u gjet i lidhur në shtratin e tij në Institutin e Rehabilitimit "Banja Bansko". Rasti u bë publik në vitin 2014, dhe menjëherë më pas personi L.R. vizitohet nga përfaqësuesit e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, i cili filloi një procedurë para Prokurorisë Publike.

Personi L.R. ishte braktisur nga prindërit (persona me aftësi të kufizuara intelektuale) pas lindjes së tij në vitin 2004 dhe për kujdestar të tij ishte emëruar Qendra për Punë Sociale, e cila u kujdes për të në disa institucione shtetërore për mbrojtje sociale. Në moshën një vjeç, ai u diagnostikua me pengesa në zhvillim, dhe kur L.R. mbushi tre vjet e gjysmë, një ekip mjekësh e kishin diagnostikuar atë me paaftësi intelektuale dhe fizike (paralizë cerebrale) dhe pengesa në të folur. Bazuar në këtë diagnozë, në vitin 2012 fëmija u vendos në Institucionin e Rehabilitimit, një institucion i tipit të hapur, i themeluar për persona me aftësi të kufizuara fizike, një institucion joadekuat për të përmbushur nevojat e të miturit L.R.. Enti, si para akomodimit të L.R., por edhe gjatë qëndrimit të tij atje, në mënyrë të përsëritur kishte reaguar te autoritetet kompetente se nuk mund të akomodojë persona me aftësi të kufizuara intelektuale, sepse ata nuk kanë staf të mjaftueshëm dhe se ai ekzistues nuk është i kualifikuar për të komunikuar me L.R., i cili është i shurdhër dhe nuk mund të flasë.

Duke vepruar në lidhje me rastin, Prokuroria Publike filloi një hetim në bazë të të cilit u vërtetua se akomodimi i L.R. në këtë institucion ishte gjithashtu i papërshtatshëm që ai ishte lidhur herë pas here në shtratin e tij me një litar për "arsye sigurie", domethënë për të parandaluar atë që të ikte dhe duke e vendosur kështu veten në rrezik. Sidoqoftë, përkundër parregullive të identifikuara, Prokuroria Publike nuk gjeti arsye për kallëzime penale, duke shpjeguar se nuk kishte asnjë qëllim nga ana e punonjësve për ta ekspozuar fëmijën në trajtim çnjerëzor dhe degradues. Ky vendim u apelua nga Komiteti i Helsinkit pa një rezultat pozitiv, por ky vendim u konfirmua më pas nga Prokuroria e Lartë Publike.

Gjykata Evropiane vendosi që në rastin e L.R. kundër Maqedonisë së Veriut, shteti nuk arriti të kryejë një hetim të duhur për rastin dhe sistematikisht dështoi dhe veprroi në kundërshtim me dispozitat për parandalimin e trajtimit çnjerëzor dhe degradues. Për më tepër, Gjykata Evropiane vendosi që Maqedonia e Veriut duhet t'i paguajë 18.000 EUR aplikantit për dëmin e shkaktuar jo-material dhe 1.650 në emër të shpenzimeve. Për të qenë në gjendje të flasim për ekzekutimin e këtij aktgjykimi, është me rëndësi të veçantë në periudhën e ardhshme që shteti t'i sigurojë atij rehabilitimin e duhur dhe të sigurojë që fondet do të përdoren për mbrojtjen e tij. L.R. ndërkohë është akomoduar në një shtëpi me grupe të vogla nën juridiksionin e Entit Special Demir Kapi, ku në fillim të vitit u vizitua nga përfaqësuesit e Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut.

BARAZIA GJINORE

NDRYSHIMET E DISPOZITAVE LIGJORE

Në vitin 2020, filloi punën grupi i punës për hartimin e **Ligjit të ri për Barazinë Gjinore** (më parë Ligji për Mundësitë e Barabarta për Gratë dhe Burrat), në të cilin Komiteti i Helsinkit merr pjesë me përfaqësuesin e tij. Nevoja për një ligj të ri lindi nga efektiviteti i kufizuar i atij të mëparshëm, veçanërisht në nivelin lokal. Sipas rekomandimeve të raportit të Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave pranë Kombeve të Bashkuara (Komiteti CEDAW¹¹³) nga viti 2018, është e nevojshme të përcaktohet një komizë kohore dhe përparësitë tematike në lidhje me ndryshimet në Ligj, në përputhje me parimet e barazisë dhe mosdiskriminimit në të gjitha fushat e mbuluara me Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave (CEDAW), në bashkëpunim me të gjithë aktorët relevantë, përfshirë edhe organizatat e shoqërisë civile.¹¹⁴ Rekomandimet tregojnë nevojën për të hartuar një plan për zbatimin e synuar të Ligjit, duke u përqëndruar te gratë në zonat rurale, gratë rome, migrantët, azilkërkuarit dhe refugjatët, punëtorët e seksit dhe gratë me aftësi të kufizuara.

Gjatë vitit 2020, nuk u arrit asnjë progres i rëndësishëm në drejtim të përmbushjes së qëllimeve dhe aktiviteteve të përcaktuara të Planit Kombëtar të Veprimit për zbatimin e Konventës së Stambollit 2018-2023 (PKV). Për shembull, një nga ligjet kryesore të parashikuara nga NAP - **Ligji për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna kundër Grave dhe Dhuna në Familje**, i cili u përgatit nga përfaqësuesit e Komitetit të Helsinkit dhe i cili ishte parashikuar të miratohej në fund të vitit 2019, për shkak të shpalljes së zgjedhjeve të parakohshme parlamentare në 12 prill, 2020, nuk u vu në votim në Kuvend. Për më tepër, me krizën e shkaktuar nga pandemia e virusit Covid-19, miratimi i këtij ligji u shty përsëri, dhe pas formimit të qeverisë së re në gusht të vitit 2020, ligji u tërhoq nga Ministria e Punës dhe Politikës Sociale pa njoftuar organizatat të cilat ishin pjesë e grupit të punës. Si arsye për tërheqjen e Ligjit, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale deklaroi parregullsitë e identifikuar, si dhe nevojën për të bërë ndryshime të caktuara në mënyrë që të përmirësohet teksti i Ligjit. Pas reagimeve të zëshme nga organizatat e shoqërisë civile, grupi i punës u thirr përsëri dhe teksti i ligjit u vendos në tavolinë. Në dhjetor 2020, teksti i ri i Ligjit hyri sërish në procedurë parlamentare, por nuk u miratua deri në fund të vitit.

Qëllimi i miratimit të këtij ligji është kapërcimi i pengesave dhe mangësive që kemi me Ligjin ekzistues për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Dhuna në Familje duke siguruar barazi, eliminimin e stereotipeve për rolet gjinore, parandalimin e të gjitha formave të dhunës me bazë gjinore ndaj grave, dhuna në familje dhe vendosja e masave dhe aktiviteteve për mbrojtjen e viktimave të këtij lloji të dhunës. Ky ligj rregullon veprimet e institucioneve dhe bashkërendimin e tyre me organizatat dhe për herë të parë përcakton se ata duhet të veprojnë me kujdes të konsideruar. Teksti i ligjit të ri mbulon forma të reja të dhunës të prezantuara nga Konventa e Stambollit dhe përcakton shprehimisht termat dhunë ndaj grave dhe dhunë me bazë gjinore, ndërsa gjithashtu ofron mbështetje për të gjitha kategoritë e grave në nevojë, të tilla si gratë transgjinore, përdoruesit e drogës, gratë shtatzënë, gratë, gratë rome, etj.

Me ratifikimin e Konventës së Stambollit, Republika e Maqedonisë së Veriut mori përsipër detyrimin për të ndryshuar dhe plotësuar Kodin Penal, si dhe ligjet e tjera dhe aktet nënligjore, i cili është i një rëndësie të veçantë që të përfundohet gjatë periudhës në vijim, respektivisht para procedurës së planifikuar të vlerësimit nga ana e grupit të

¹¹³ CEDAW – Convention on Elimination on all Forms of Discrimination against Women

¹¹⁴ CEDAW. (14 nëntor 2018). *Concluding observations on the sixth periodic report of the former Yugoslav Republic of Macedonia*. I disponueshëm në: https://tbinternet.ohchr.org/_layouts/15/treatybodyexternal/Download.aspx?symbolNo=CEDAW/C/MKD/CO/6&Lang=En

ekspertëve për veprim kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (GREVIO)¹¹⁵ për vendin tonë, i cili ndërkohë, si rezultat i pandemisë, u shty për në vitin 2022.

PËRFAQËSIMI NDËRKOMBËTAR

Si pjesë e projektit "Gratë kanë të drejta!", i cili u zbatua gjatë vitit 2018 dhe 2019, Komiteti i Helsinkit më 25 maj 2019 parashtrij një ankesë në Komitetin CEDAW. Rasti, i cili u identifikua si i përshtatshëm për përfaqësim para Komitetit, që do të thotë se ai rast përmbush kriteret e pranueshmërisë, (*admissibility criteria*), respektivisht kushtet për fillimin e procedurave para Komitetit, paraprakisht kishte kaluar nëpër instancat e gjykatave vendore dhe ishte mbështetur financiarisht nga Shoqata për Edukim Shëndetësor dhe Hulumtim HERA.

Rasti kishte të bënte me dy gra rome të cilave iu mohua e drejta për kujdes shëndetësor, dmth iu ishte kufizuar qasja në shërbimet gjinekologjike. Në shtator të vitit 2016, S.B. dhe M.B. ngritën padi në Gjykatën Themelore në Shkup kundër një ordinance gjinekologjike private në Shkup, pasi paraprakisht në vitin 2015 ishin refuzuar të zgjedhnin një gjinekolog/e amë dhe të ushtronin të drejtën e tyre për kujdes shëndetësor, me një shpjegim nga motra medicinale se ordianca nuk pranon më paciente të reja. Të dy gratë i kërkuan Gjykatës të përcaktojë se ato ishin diskriminuar për shkak të përkatësisë etnike dhe se u ishte shkelur e drejta e tyre për trajtim të barabartë për mbrojtjen e shëndetit riprodhues. Gjatë së njëjtës periudhë, gratë nga bashkësia etnike maqedonase gjithashtu aplikuan për zgjedhjen e një gjinekologu/e amë, të cilat ishin pranuar dhe kontrolluar menjëherë.

Gjykata Themelore Shkup e refuzoi padinë për diskriminim të S.B. dhe M.B. si të pabazuar. Vendimi u apelua në Gjykatën e Apelit, e cila la në fuqi vendimin e shkallës së parë, se nuk kishte diskriminim në rastin konkret. Pas shterimit të mjeteve juridike kombëtare, në vitin 2019 Iniciativa e Grave nga Shuto Orizari, me mbështetjen e HERA dhe Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, parashtrij një ankesë individuale për diskriminim ndaj dy grave rome në Komitetin CEDAW.

Më 2 dhjetor 2020, Komiteti konstatoi një shkelje të së drejtës për trajtim të barabartë dhe diskriminim të dy grave nga Shuto Orizari, të cilat ishin pamundësuar të merrnin shërbime gjinekologjike. Pas një beteje 5-vjeçare, Komiteti konstatoi padrejtësinë dhe i bëri një sërë rekomandimesh shtetit për ndryshime strukturore dhe çrënjësosjen e praktikave të dëmshme në aksesin e shërbimeve gjinekologjike për gratë rome. Ky vendim i Komitetit është vendimi i parë i tillë kundër vendit tonë, i cili është veçanërisht i rëndësishëm sepse njeh qartë diskriminimin ndaj grave rome dhe nevojën për kujdes shëndetësor në dispozicion në lidhje me shëndetin e tyre seksual dhe riprodhues. Komiteti gjithashtu thekson dështimin e shtetit për të marrë masa specifike, nevojën për të rritur ndërgjegjësimin e gjyqtarëve për diskriminimin, si dhe aspektet ligjore mbi barrën e provës.

Komiteti konstatoi shkelje të të drejtave të dy grave rome të garantuara sipas neneve 1, 2 dhe 12 të Konventës, dmth një shkelje të të drejtave dhe diskriminimit në qasjen në shërbimet e shëndetit seksual dhe riprodhues. Në veçanti, Komiteti konstatoi se shteti nuk kishte siguruar a) realizimin praktik të parimit të mos-diskriminimit në aksesin në shërbimet e shëndetit riprodhues, b) mbrojtjen efektive kundër diskriminimit ndaj grave brenda sistemit gjyqësor dhe c) masat e duhura për të diskriminimi ndaj këtyre grave të kryera nga personat e përfshirë, pra nga ordianca gjinekologjike private. Disa nga rekomandimet e Komitetit për vendin anëtar përfshijnë sigurimin e dëmshpërblimit të duhur për viktimat, duke përfshirë edhe pranimin e dëmit material dhe moral që kanë pësuar si rezultat i qasjes së tyre joadekuate në shërbimet e shëndetit seksual dhe riprodhues, veçanërisht në shërbimet e rregullta gjinekologjike.

Për më tepër, Iniciativa e Grave nga Shuto Orizari, me mbështetjen e HERA dhe Komitetit të Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, do të kërkojë një rigjykim në nivel kombëtar, në mënyrë që të mbrojë dinjitetin dhe nderin e grave rome. Në periudhën e ardhshme, Komiteti i Helsinkit do të vazhdojë të monitorojë procesin e zbatimit të

¹¹⁵ Group of Experts on Action against Violence against Women and Domestic Violence

rekomandimeve të Komitetit nga institucionet kompetente dhe ndërmarrjen e masave sistematike për avancimin e të drejtave riprodhuese të grave rome.

DHUNA ME BAZË GJINORE GJATË KOHËS SË PANDEMISË¹¹⁶

Situata me dhunën me bazë gjinore gjatë vitit të kaluar është ndikuar në masë të madhe nga llojet e ndryshme të masave që janë miratuar si rezultat i pandemisë. Nëse marrim parasysh se shtëpia është vendi më i pasigurt për gratë dhe në kushtet kur nuk ka krizë në shkallë globale, siç tregohet nga statistikat në vendin tonë,¹¹⁷ rreziku i grave në shtëpi gjatë pandemisë është prishëm në rritje.

Paralajmërimi për rrezikun e rritjes së rasteve të dhunës në familje në kohë krize filloi në muajin mars. Megjithatë nuk kishte të dhëna të mjaftueshme zyrtare për këtë periudhë relativisht të shkurtër, statistikat fillestare nga vendet ku virusi ishte përhapur në mënyrë të konsiderueshme treguan një rritje të ndjeshme të dhunës në familje. Ky ishte padyshim një nga efektet anësore që rezultoi nga aplikimi i masave kufizuese për parandalimin dhe mbrojtjen kundër virusit. Fakti që fokusi i shteteve është përqendruar plotësisht në mbrojtjen nga përhapja e virusit, ka kontribuar në mënyrë të pashmangshme në neglizhimin e sfidave me të cilat përballen një numër i madh i qytetarëve të cilët tashmë janë në një situatë të prekshme, si dhe në vështirësinë për qasje në shërbime të caktuara. Në të njëjtën kohë, devijimi i një numri të madh fondesh në favor të sistemit shëndetësor ishte në kurriz të aksesit në të drejta dhe shërbime të caktuara që prekin një numër të madh të grupeve të marginalizuara të qytetarëve.

Masat kufizuese që janë miratuar çdo ditë nga Qeveria e RMV-së që nga fillimi i pandemisë, përfshirë rekomandimet për vetëizolim si një nga mënyrat më efektive të parandalimit, janë një faktor serioz në rritjen e rrezikut të sjelljes së dhunshme në shtëpi. Për më tepër, stresi i shkaktuar nga humbja e vendeve të punës, mbyllja e kopshteve dhe shkollave, gjendja e pasigurt financiare, problemet ekzistuese shëndetësore, ishin dhe janë katalizatorë për një rritje të dhunës në familje, e cila nuk do të thotë domosdoshmërisht një rritje e numrit të rasteve, por një rrezik për intensifikimin e dhunës ekzistuese. Në vendet e Bashkimit Evropian, një në pesë gra është viktimë e dhunës në familje dhe rreziku është edhe më i lartë për gratë që jetojnë në familje që kanë probleme në plotësimin e nevojave themelore të jetesës.¹¹⁸

Që nga fillimi i pandemisë, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut u bëri thirrje institucioneve të veprojnë në mënyrën e duhur dhe në kohën e duhur mbi raportet e dhunës në familje dhe me bazë gjinore, në mënyrë që të parandalojnë përshkallëzimin e tyre dhe pasojat fatale. Ajo që ishte veçanërisht e rëndësishme gjatë kësaj periudhe ishte ofrimi i mbështetjes dhe inkurajimit të viktimave për të raportuar dhunën, pasi përvoja në terren tregon se një nga problemet më serioze është mosraportimi i dhunës. Shkalla e raportimit të rasteve të dhunës është rreth 14% në Evropë,¹¹⁹ ndërsa në vendin tonë vetëm 2% e grave që kanë përjetuar dhunë nga një partner, e që e kanë raportuar atë në polici,¹²⁰ e cila është rezultat i mosbesimit në institucione, mosndëshkimit të autorëve të krimeve, por gjithashtu frikës dhe turp, madje edhe mosidentifikimit të dhunës nga ana e vetë viktimave.

¹¹⁶ Të dhënat për gjendjen e dhunës me bazë gjinore gjatë gjendjes së jashtëzakonshme janë në dispozicion në *Raportin e veçantë për situatën e të drejtave të njeriut në kohën e Covid-19*, që e publikoi Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në tetor të vitit 2020. I disponueshëm në: https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2020/10/izvestaj-mk_compressed.pdf

¹¹⁷ Dimushevska, E. (2018). *Analiza e rasteve të femicideve – vrasje të grave në Republikën e Maqedonisë së Veriut*. Rrjeti Kombëtar Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje - Zëri kundër dhunës. I disponueshëm në: http://www.glasprotivnasilstvo.org.mk/wp-content/uploads/2013/11/Femicidi-mk.final_.pdf

¹¹⁸ European Institute for Gender Equality. (29 prill 2020). *EU rights and equality agency heads: Let's step up our efforts to end domestic violence*. I disponueshëm në: <https://eige.europa.eu/news/eu-rights-and-equality-agency-heads-lets-step-our-efforts-end-domestic-violence>

¹¹⁹ UNDP. (22 maj 2020). *Justice for Women Amidst COVID-19*. I disponueshëm në:

<https://www.undp.org/content/undp/en/home/librarypage/womens-empowerment/justice-for-women-amidst-covid-19.html>

¹²⁰ OSBE. (2019). *Hulumtim i kryer nga OSBE mbi dhunën ndaj grave në Maqedoninë e Veriut – Mirëqenia dhe siguria e grave*. I disponueshëm në: <https://www.osce.org/mk/secretariat/424409?download=true>

Për sa i përket shërbimeve të raportimit të dhunës në familje, gjatë periudhës së izolimit, viktimat ishin në gjendje të raportonin në Linjën celulare kombëtare falas SOS për viktimat e dhunës në familje, e cila siguron informacion konfidencial 24-orësh për mbrojtjen e viktimave, shërbimet e disponueshme dhe këshillimin telefonik për viktimat, si dhe në stacionin më të afërt të policisë ose Qendrën kompetente për punë sociale. Shërbimi falas i ndihmës juridike i Komitetit të Helsinkit ishte gjithashtu në dispozicion të viktimave.

Më 9 prill 2020, Rrjeti Kombëtar kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje, anëtar i të cilit është Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, parashtroi një kërkesë Qeverisë së RMV-së për ndryshim të vendimit për ndalimin e lëvizjes së qytetarëve në të gjithë territorin e vendit¹²¹ në mënyrë që të merren masa që do të bëjnë një përjashtim sa i përket sanksionimit të grave viktime të dhunës dhe fëmijëve të tyre që largohen nga shtëpia për shkak të kërcënimit dhe rrezikut të drejtpërdrejtë nga dhuna. Menjëherë pas dorëzimit të kërkesës, Ministria e Punëve të Brendshme lëshoi një komunikatë,¹²² duke informuar se viktimat e dhunës gjatë orës policore do të mund të lëvizin lirshëm deri në stacionin më të afërt të policisë ose, nëse kanë nevojë për ndihmë mjekësore, në institucionin më të afërt shëndetësor, respektivisht nuk do të kenë nevojë për një leje të veçantë lëvizjeje për këto nevoja.

Më 13 prill 2020, Rrjeti paraqiti një Kërkesë zyrtare Qeverisë¹²³ për vendosjen e masave urgjente për mbrojtjen e grave dhe fëmijëve viktime të dhunës në familje gjatë gjendjes së jashtëzakonshme, me propozim-masa, miratimi i të cilave do të mundësonte mbrojtjen e duhur të viktimave të dhunës në përputhje me kushtet e reja. Kërkesa në veçanti vuri në dukje rreziqet që janë specifike për dhunën në familje dhe përmbante një propozim për masa urgjente për t'u marrë me dhunën, si dhe përgatitjen e një sistemi mbrojtës për trajtimin e rasteve të dhunës në familje pas përfundimit të pandemisë.

Gjatë gjendjes së jashtëzakonshme në vend, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut regjistroi gjithsej pesë denoncime të dhunës në familje, gjë që nuk tregon një tendencë rritjeje të rasteve. Sipas statistikave të Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Punës dhe Politikës Sociale në vendin tonë nuk ka rritje të numrit të rasteve të dhunës në familje krahasuar me të njëjtën periudhë nga viti i kaluar. Në baza javore, rritja e vetme u regjistrua vetëm në javën e parë të prillit, ndërsa gjatë javëve të tjera rastet e dhunës në familje ishin në ngecje.¹²⁴ Krahasuar me shumë vende në Evropë, por edhe globalisht, ku rritja e dhunës në familje që nga fillimi i izolimit ka arritur mbi 25%,¹²⁵ kemi arsye të besojmë se të dhënat konfirmojnë problemin e lashtë të mosraportimit nga viktimat, por edhe mënyra e papërshtatshme e regjistrimit të veprave penale dhe mbajtjes së statistikave të ndara sipas gjinisë. Një arsye tjetër për këtë numër është mënyra joadekuate e kualifikimit të rasteve të dhunës në familje, të cilat shpesh trajtohen si kundërvajtje kundër rendit publik, në vend se të trajtohen si vepra penale. Në këtë drejtim flet informacioni nga Ministria e Punëve të Brendshme, sipas të cilit disa nga viktimat që paraqitën një denoncim në polici më vonë e tërhoqën atë, dhe për këtë arsye është regjistruar një ulje e numrit të veprave penale dhe kundërvajtjeve për dhunën në familje në këtë periudhë.¹²⁶

Në periudhën prej 1 janarit deri më 31 dhjetor 2020, Komiteti i Helsinkit regjistroi gjithsej 32 raste të dhunës në familje dhe me bazë gjinore, për të cilat u dha ndihmë juridike falas. Krahasuar me vitet e mëparshme, shifrat nuk tregojnë një tendencë rritjeje të numrit të denoncimeve, gjë që ngre në mënyrë të pashmangshme dyshimin për shkallën ende të ulët të besimit të viktimave në institucionet kompetente.

¹²¹ I disponueshëm në: <https://mhc.org.mk/news/baranje-do-vlada-na-rsm-za-dopolnuvanje-na-odlukata-za-zabrana-za-dvizhenje-na-graganite-vo-celata-teritorija-na-drzhavata/>

¹²² I disponueshëm në: https://mvr.gov.mk/vest/11716?fbclid=IwAR22dRPTvDTbXfoYH_G93_i2vY21o4tz0qHkt-1I3qy7-U8A14EZgBFnWK0

¹²³ I disponueshëm në: <http://www.glasprotivnasilstvo.org.mk/wp-content/uploads/2020/04/Itni-merki-za-zashtita-na-zhenite-i-detsata-zhrtvi-na-semejno-nasilstvo-vo-kriza.pdf>

¹²⁴ Bilazhevska, K. (30 prill 2020). *Çfarë historish fshihet pas shifrave të MPB-së?* DW. I disponueshëm në: <https://www.dw.com/mk/%D0>

¹²⁵ OKB. (9 prill 2020). *Policy Brief: The Impact of COVID-19 on Women*. I disponueshëm në: <https://www.unwomen.org/-/media/headquarters/attachments/sections/library/publications/2020/policy-brief-the-impact-of-covid-19-on-women-en.pdf?la=en&vs=1406>

¹²⁶ Dimovska, M. (29 prill 2020). *Masat kufizuese rritën edhe numrin e dhunës në familje në Maqedoni*. Kanal 5. I disponueshëm në: <https://kanal5.com.mk/-restriktivnite-merki-gi-zgolemija-i-brojot-na-semejno-nasilstvo-vo-makedonija/a419964>

Ministria e Punës dhe Politikës Sociale në fillim të periudhës së izolimit paralajmëroi për rrezikun e rritjes së dhunës në familje duke ndarë kontakte nga shërbimet për denoncimin dhe mbështetjen e viktimave, dhe në muajin maj filloi një fushatë për të denoncuar dhunën në familje gjatë kohës së gjendjes së jashtëzakonshme.¹²⁷ Megjithatë, përkundër masave të parashtruara, përveç masës për denoncim të pandërprerë për sa kohë zgjatit ora policore, shteti nuk arriti të zbatojë ndonjë zgjidhje kreative për parandalimin e dhunës, madje as për të lehtësuar denoncimin.

Në rastet kur dhuna në familje nuk raportohet ose institucionet përkatëse nuk i sigurojnë mbrojtje adekuate viktimës, gjasat që dhuna të përshkallëzohet në femicide rritet. Edhe këtë vit nuk munguan rastet e femicidit në vendin tonë, respektivisht vrasja e një gruaje vetëm pse ajo është grua Sipas hulumtimeve në vendin tonë,¹²⁸ në më shumë se 80% të rasteve të vrasjes kanë ndodhur në shtëpinë e përbashkët ose nëse është hapur një proces divorci, në shtëpinë e prindërve të viktimës, kurse në numrin më të madh të rasteve të vrasjeve, ato janë kryer nga ana e ish-partnerit ose partnerit aktual. Në vitin 2020 u regjistruan 4 vrasje gjatë kohës së pandemisë (Prilep, Shkup, Haraçinë dhe Gostivar) dhe 1 vrasje në tentativë (Veles). Rasti i fundit i femicidit në Gostivar konfirmon se një nga arsytet më të zakonshme pse dhuna fizike rezulton në vrasje është qasja joserioze e institucioneve ndaj dhunës me bazë gjinore, dmth reagimi joadekuat ndaj denoncimeve që edhe më shumë zvogëlon besimin e viktimave në institucionet kompetente. Në këtë rast të veçantë, u konfirmua dyshimi se arsyeja pse dhuna u përshkallëzua në vrasje ishte mosveprimi i policisë pas një denoncimi të mëparshëm të dhunës. Femicidi ende nuk njihet nga legjislacioni ynë si një krim i veçantë për të cilin do të mbahen statistika të veçanta, pavarësisht nga fakti se është forma më e rëndë e dhunës ndaj grave.

Gjatë kësaj periudhe, ishte me rëndësi të veçantë gjetja e zgjidhjeve të reja dhe krijuese për të mbështetur dhe mbrojtur viktimat e dhunës, në mënyrë që të parandalohet dhuna dhe pasojat e saj fatale. Duke pasur parasysh mundësitë e kufizuara për të raportuar dhunën në familje në një situatë ku pjesën më të madhe të kohës partneri është në shtëpi dhe lëvizja jashtë shtëpisë zvogëlohet në minimum, shumë vende kanë prezantuar mënyra alternative të raportimit të dhunës në familje, duke përdorur mjetet ekzistuese, të tilla si media sociale, SMS, Whatsup, por edhe zhvillimi i aplikacioneve të reja falas, dërgimi i mesazheve për lokalizimin e viktimave përmes GPS, si dhe përdorimi i kodeve sekrete kur vizitoni barnatore dhe dyqane.¹²⁹ Përkundër vonesës së gjatë, në dhjetor të vitit 2020, UNDP-ja dhe Ministria e Punës dhe Politikës Sociale, së bashku me institucionet e tjera përkatëse dhe organizatat e shoqërisë civile që punojnë në këtë problematikë, përfshi edhe Komitetin e Helsinkit, filluan promovimin e aplikacionit "Ji e Sigurt".¹³⁰ Ky digjitalizim i raportimit të dhunës pritet të kontribuojë në reagimin më të shpejtë të të gjithë institucioneve përkatëse, si dhe në përmirësimin e bashkëpunimit ndër-sektorial. Aplikacioni është në dispozicion në tri gjuhë: maqedonase, shqipe dhe rome. Përveç raportimit të dhunës, përmes aplikacionit, viktimat mund të informohen për të gjitha shërbimet në dispozicion të tyre dhe mënyrën se si mund t'i përdorin ato, dhe gjithashtu përmban këshilla, protokolle dhe dëshmi personale të viktimave të dhunës.

DHOMA PUBLIKE

Në janar të vitit 2020, doli në dritë një skandal i quajtur "Dhoma Publike", i cili aktualisht përkufizohet si një rast i dhunës me bazë gjinore me numrin më të lartë të viktimave, dhe ku sipas informacioneve publike të deritanishme, të gjitha viktimat janë gra. Informacioni në lidhje me ekzistencën e grupit të mbyllur (privat) në rrjetin e komunikimit Telegram të titulluar "Dhoma Publike", ku anëtarët ndanin dhe komentonin foto dhe video të qarta të vajzave dhe grave nga vendi, së pari u shpërnda nga një profesoreshë e shkollës së mesme nga Shkupi, e cila kishte siguruar

¹²⁷ I disponueshëm në: http://www.mtsp.gov.mk/pocetna-ns_article-kako-da-se-zashtitime-od-semejno-nasilstvo-kade-da-pobaramë-pomosh.nsp

¹²⁸ Dimushevska, E. (2018). *Analiza e rasteve të femicideve – vrasje të grave në Republikën e Maqedonisë së Veriut*. Rrjeti Kombëtar Kundër Dhunës ndaj Grave dhe Dhunës në Familje - Zëri kundër dhunës. I disponueshëm në: http://www.glasprotivnasilstvo.org.mk/wp-content/uploads/2013/11/Femicidi-mk.final_.pdf

¹²⁹ UNDP. (22 maj 2020). *Justice for Women Amidst COVID-19*. I disponueshëm në:

<https://www.undp.org/content/undp/en/home/librarypage/womens-empowerment/justice-for-women-amidst-covid-19.html>

¹³⁰ Aplikacioni Ji e Sigurt. I disponueshëm në: <https://play.google.com/store/apps/details?id=budi.sigurna.mk&hl=mk&gl=US>

informacionin nga një nxënëse e saj. Disa nga fotografitë ishin marrë nga profile të hapura të vajzave në mediat sociale, por shumë prej tyre janë dërguar privatisht, ndoshta te partnerët intimë dhe më pas janë gjetur të shpërndara në një grup, ku anëtarë ishin burra të rritur.

Rasti mori një vëmendje të madhe brenda një kohe të shkurtër, si në media ashtu edhe në mënyrë institucionale. Byroja e Sigurimit Publik tha se ka filluar menjëherë një hetim për motivet dhe qëllimet e formimit të këtij grupi, kurse kundër shkelësve të ligjit do të ngriten kallëzime përkatëse. Zëvendësministrja plotësuese e Punës dhe Politikës Sociale, Sanela Shkrijelj, u bëri thirrje fëmijëve dhe prindërve të cilët kanë nevojë për ndihmë, atëta kërkojnë nga qendrat për punë sociale. Sidoqoftë, megjithëse institucionet fillimisht reagues relativisht shpejt, përgjigja, duke pasur parasysh seriozitetin dhe natyrën e problemit, ishte larg nga e mjaftueshme.

Grupi "Dhoma Publike" menjëherë filloi të humbasë anëtarët pasi informacioni u bë publik. Grupi i parë u mbyll me sukses, por ndërkohë u hapën grupe të reja me të njëjtin qëllim dhe të njëjtin parim funksionimi. Organizatat që punojnë në terren menjëherë lajmëruan se "Dhoma Publike" dhe çdo grup tjetër i këtij lloji duhet të trajtohet si një vepër penale, kurse administratorët dhe anëtarët që shkelën ligjin duhet të përballen me përgjegjësi penale.

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut më 27 janar 2020 denoncoi grupin në Sektorin për krim kibernetik dhe forensikë digjitale, sipas Nenit 149 të Kodit Penal për "Abuzim me të dhënat personale", si dhe Nenit 193 paragrafi 3 për "Prodhim dhe distribuim të pornografisë së fëmijëve". Pas shkresës, menjëherë arriti përgjigja se rasti është në Prokurorinë Themelore Publike në Shkup, nga ku një vit pas denoncimit, ende nuk kishte asnjë aktakuzë, respektivisht aktgjykim.

Gjatë vitit, në publik u shfaqën informacione rreth grupeve të tjera të këtij lloji, të tilla si GevgelijaHub. Disa nga viktimat nga Gjevgjelija, të dhënat personale të të cilave ishin keqpërdorur, ngritën kallëzime penale në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe identifikuan persona specifikë që i posedonin këto materiale, respektivisht fotot e tyre intime, dhe mund të ishin iniciatorë, por i ngjashëm si me rastin "Dhoma Publike", institucionet dështuan dhe nuk morën masat e duhura ndaj autorëve.

Heshtja dhe mosveprimi i institucioneve, veçanërisht Ministria e Punëve të Brendshme dhe Prokuroria Publike, përshkallëzuar nga viktimizimi i dyfishtë i publikut që viktimat "e kishin kërkuar vetë", dekurajuan më tej vajzat dhe gratë për të denoncuar këtë lloj dhune të bazuar në gjini. Institucionet në adresimet e tyre nuk i dhanë kontekstin e duhur gjinor dhe nuk u përqëndruan në rastet, megjithëse ishim përballë një shembulli klasik të dhunës dhe ngacmimit me bazë gjinore, i cili vazhdon të lulëzojë në hapësirën fizike dhe kibernetike. Për eliminimin e këtij lloji të dhunës, duhen zgjidhje gjithëpërfshirëse dhe në themel.

SISTEMI GJYQËSOR

Komiteti i Helsinkit monitoron reformat dhe punën e gjyqësorit si një anëtar aktiv i Grupit Blueprint. Organizatat në këtë grup monitorojnë procesin e zbatimit të Strategjisë për reformën e sektorit gjyqësor dhe forcimin e pavarësisë dhe paanshmërisë së gjyqësorit. Grupi Blueprint në vitin 2020 ka publikuar një analizë të veçantë rreth zbatimit të kësaj strategjie. Më poshtë janë konkluzionet dhe rekomandimet e dalta nga kjo analizë, e cila gjithashtu përfshin rishikime të punës së Gjykatës Kushtetuese, Këshillit Gjyqësor dhe Këshillit të Prokurorëve Publikë.¹³¹



Figura 1. Kopertina e analizës, dizajni nga Relativ

¹³¹ Grupi Blueprint për Reformën në Gjyqësor (2019), "Analiza e zbatimit të strategjisë për reformën e sektorit gjyqësor (2017 - 2022) për periudhën 2018/2019", i disponueshëm në: <https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2019/06/Analiza-na-sproveduvanjet-na-Strategjijata-za-reforma-na-pravosudniot-sektor-2017-2022-za-periodot-2019-2019.pdf>.

Në shumicën e ligjeve nga Strategjia për reformën e sektorit gjyqësor (2017-2022) që u miratuan dhe hynë në fuqi në periudhën e kaluar, zbatimi i zgjidhjeve ligjore në praktikë vlerësohet si korrekt dhe me kohë. Në një periudhë relativisht të shkurtër kohe, u arrit harmonizimi i dispozitave për shqiptimin e gjobave nga Ligji i ri për Kundërvajtje me ligjet e tjera materiale në fushat e mjedisit jetësor, kulturës, arsimit, shkencës dhe veprimtarisë së turizmit, ndërsa Ministria e Drejtësisë miratonte vazhdimisht rregullore dhe akte të tjera nënligjore që rrjedhin nga Ligji për Ekzekutimin e Sanksioneve. Për më tepër, Ministria e Drejtësisë ndërmori aktivitete të rëndësishme me qëllim të promovimit të Ligjit për Ndhmë Juridike Falas dhe për të rritur ndërgjegjësimin e qytetarëve për mënyrën se si ata mund të marrin ndihmë juridike primare dhe sekondare. Sidoqoftë, jo të gjitha ligjet në kuadër të Strategjisë kanë marrë të njëjtin trajtim sa i përket zbatimit të tyre në praktikë. Në mënyrë të veçantë, vërejtje në procesin e zbatimit të zgjidhjeve ligjore u vunë re në Ligjin për Prokurorinë Publike, Ligjin për Kontestet Administrative, Ligjin për Këshillin Gjyqësor të RMV-së, si dhe në pjesë të Ligjit për Ndhmën Juridike Falas:

- Ligji i ri për Këshillin Gjyqësor të RMV-së ndryshoi ndjeshëm kushtet dhe procedurën për zgjedhjen e gjyqtarëve në gjykatat themelore dhe ato më të larta, kriteret cilësore dhe kuantitative për vlerësimin e punës së gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave në rast të ngritjes në detyrë, si dhe bazat dhe procedurat për konstatimin e përgjegjësisë disiplinore të gjyqtarëve dhe shkarkimin e tyre.

- Ekzistojnë disa kontradikta në dispozitat e Ligjit për Prokurorinë Publike në lidhje me materialet dhe transkriptimet e materialeve të përgjuara në mënyrë të paligjshme. Parashikohet që ato mund të përdoren vetëm si të dhëna dhe në bazë të tyre nuk mund të ngrihen kallëzime, gjë që bie ndesh me dispozitat e Ligjit për Procedurën Penale. Prandaj, vetëm gjykatat vendase dhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut kanë juridiksion për të vlerësuar se cilat prova mund të merren parasysht gjatë një procedure penale.

- Pothuajse një vit pas hyrjes në fuqi të Ligjit të ri për Kontestet Administrative, Gjykatës Administrative ende nuk iu është dorëzuar për përdorim një ndërtesë e re, e cila do të mundësojë përmbushjen e detyrimeve që rrjedhin nga ligji i ri në mënyrë që të të mbajë rregullisht dëgjime të detyrueshme publike.

- Ligji i ri për Ndhmën Juridike Falas paraqet një përmirësim të dukshëm të kornizës ligjore krahasuar me ligjin e mëparshëm. Megjithatë, disa nga zgjidhjet janë kufizuese sa i përket qasjes në drejtësi për qytetarët më të varfër. Çështjet ligjore për të cilat mund të jepet ndihma juridike dytësore duhet të korrespondojnë me problemet juridike me të cilat përballen qytetarët me të ardhura të ulëta.

- Një sfidë serioze mbetet krijimi i një sistemi funksional për sigurimin e ndihmës juridike falas për fëmijët në rrezik dhe për fëmijët autorë të veprave që nuk janë në gjendje të shlyejnë shpenzimet e avokatëve. Një zgjidhje ligjore pa buxhet të mjaftueshëm është e pamjaftueshme për të adresuar këtë çështje që ka një ndikim serioz në të drejtën për një gjykim të drejtë.

Lidhur me procedurat e përgjithshme për miratimin e zgjidhjeve të reja ligjore, procesi i miratimit të disa prej ligjeve u vlerësua si transparent dhe gjithëpërfshirës, i cili kontribuon në rritjen e besimit të qytetarëve në institucionet gjyqësore, si dhe miratimin e zgjidhjeve ligjore cilësore. Sidoqoftë, në disa prej ligjeve, procedura dhe procesi i miratimit të zgjidhjeve të reja ligjore nuk u vlerësuan si të implementuara në një mënyrë transparente dhe gjithëpërfshirëse. Qasja e pabarabartë ndaj miratimit të ligjeve që dalin nga Strategjia për reformën e sektorit gjyqësor hap shteg për dyshime sa i përket cilësisë së zgjidhjeve ligjore. Kjo mënyrë e punës rrezikon ngecje, në vend që të promovojë shtetin e së drejtës, kurse shteti po largohet një hap mbrapa nga rikthimi i besimit të qytetarëve në sistemin e drejtësisë dhe promovimin e mbrojtjes së të drejtave të njeriut. Rekomandimet e përgjithshme për përmirësimin e situatës në sistemin gjyqësor dhe për zbatimin e përpiktë të masave dhe qëllimeve të Strategjisë konstatojnë si në vijim:

- Përkundër përmirësimit të kornizës ligjore për kompetencat e Këshillit Gjyqësor të RMV-së, zbatimi adekuat dhe i qëndrueshëm praktik i dispozitave ligjore nga ana e Këshillit Gjyqësor të RMV-së, azhurnimi i vazhdueshëm i

Këshillit dhe monitorimi i mëtejshëm i punës së Këshillit nga ana e organizatave të shoqërisë civile janë të një rëndësie të madhe për ata që punojnë në këtë fushë.

- Është e nevojshme të dorëzohet ndërtesa për përdorim Gjykatës Administrative të RMV-së sa më shpejt të jetë e mundur, e cila do të plotësojë plotësisht kushtet hapësinore të nevojshme për mbarëvajtjen e dëgjimeve të rregullta publike.

- Periudha e hyrjes në fuqi e Ligjit për Prokurorinë Publike në asnjë rast nuk duhet të ketë lidhje me rrjedhën e procedurave penale dhe të ardhmen e çështjeve tashmë të iniciuara, si dhe provat në dispozicion të Prokurorisë Publike. Lidhur me zhvillimin e procedurave penale, lex specialis janë ligjet procedurale, përkatësisht Ligji për Procedurën Penale në bazë të të cilave zhvillohen procedurat.

- Bazuar në të dhënat e vitit 2020, është e nevojshme të bëhet një analizë e plotë e zbatimit të Ligjit për Ndhimën Juridike Falas për të identifikuar nevojën e përmirësimit të tekstit ligjor bazuar në praktikën më të mira nga vendet e BE-së.

- Është e domosdoshme të vazhdohet procedura për miratimin e Ligjit për Procedurën Kontestimore dhe të lihet hapësira adekuate (vacation legis) për shkak të rëndësisë së këtij ligji për funksionimin e sistemit gjyqësor në përgjithësi.

- Duke vendosur një obligim për trajnim fillestar dhe të përhershëm të detyrueshëm për avokatët në nivel ligji, është e domosdoshme të parashikohet miratimi i akteve të AKRSM-së të cilat do të rregullojnë saktësisht mënyrën dhe programin në bazë të të cilit do të zbatohet trajnimi.

- Pandemia e virusit KOVID-19 dhe gjendja e jashtëzakonshme tre-mujore që u shpall për herë të parë në RMV-së ishin gjithashtu një tregues i gatishmërisë së gjyqësorit për të punuar në kushte të jashtëzakonshme. Duke pasur parasysh që organizimi i gjykatave dhe administrata gjyqësore gjatë një gjendje të jashtëzakonshme ose lufte nuk është e rregulluar ose e parashikuar në ndonjë ligj apo akt juridik, propozohet të definohet organizimi dhe funksionimi i gjykatave në gjendje të jashtëzakonshme në Rregulloren e Gjykatave ose Ligjit për Gjendjen e Jashtëzakonshme.

- Në disa prej ligjeve (Ligji për Ekspertizën, Ligji për Pronën dhe të drejtat e tjera të prekshme), proceset për miratimin e ndryshimeve ligjore u ndaluan 2 vjet më parë pa shpallur një plan ose aktivitete për të finalizuar procesin. Grupi i punës për Ligjin për Trashëgiminë nuk është formuar ende, dhe as që ka filluar me punë.

INSTITUCIONET E MBYLLURA

Institucioni ndëshkimore-korrektuese në vitin 2020 u përballën me një sfidë të madhe në lidhje me mënyrën e mundësimit të të dënuarve për të shijuar të drejtat dhe privilegjet e tyre ndërsa merrnin masa për të parandaluar përhapjen e virusit Kovid-19 nëpër burgje. Burgjet paraqesin ambiente me një rrezik të lartë të përhapjes së koronavirusit për shkak të hapësirave të mbyllura, grupimit të të dënuarve, kushteve të këqija materiale dhe higjienike dhe të ngjashme. Me shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme dhe hyrjen në fuqi të masave të veçanta për mbrojtjen dhe parandalimin e Kovid-19, institucionet ndëshkimore-korrektuese morën masa kufizuese, respektivisht ndalimin e vizitave dhe privilegjeve të personave të privuar nga liria.

Më 15 mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSH) publikoi dokumentin e saj të titulluar "Përgatitja, parandalimi dhe kontrolli i KOVID-19 në burgje dhe institucione të tjera për personat e privuar nga liria - Udhëzime të përkohshme" i cili synon të "ndihmojë vendet për të përgatitur plane të veçanta dhe/ose të mendojnë aktivitete shtesë për burgjet dhe institucionet e tjera për personat e privuar nga liria, si përgjigje ndaj epidemisë ndërkombëtare me KOVID-19"¹³²

Në lidhje me personat e mitur të privuar nga liria, Komiteti i Kombeve të Bashkuara për të drejtat e fëmijëve u bëri thirrje shteteve të kenë parasysh se "ndërsa këto masa kufizuese mund të konsiderohen të nevojshme në një periudhë afatshkurtër, ato do të kenë një efekt të dukshëm dhe të pafavorshëm të fëmijët në planin afatgjatë". Fëmijët në çdo kohë duhet të lejohen të mbajnë kontakte të rregullta me familjet e tyre, dhe nëse jo personalisht, me anë të komunikimit elektronik ose përmes telefonit. Nëse zgjatet periudha e gjendjes së jashtëzakonshme, duhet të merret në konsideratë një rivlerësim i masave që ndalojnë vizitat."¹³³

Duke ndjekur rekomandimet e organizatave dhe organeve ndërkombëtare, si dhe masat e qeverisë për të parandaluar dhe mbrojtur nga përhapja e koronavirusit, Drejtoria për Ekzekutimin e Sanksioneve më 10 mars miratoi një vendim që kufizonte të drejtat dhe privilegjet e personave të dënuar si: vizitat nga familjet brenda institucionit dhe jashtë institucionit, pushimet gjatë fundjavës, angazhimet në punë jashtë institucionit dhe pushimet vjetore. Ky vendim ishte arsyeja që institucionet ndëshkimore-korrektuese të gjenin zgjidhje të tjera alternative për të mundësuar të dënuarit të kishin kontakte me familjet e tyre. Disa nga institucionet siguruan telefona celularë dhe tabletë, kurse të parburgosurve në INK Burgu Shkup iu lejua të kishin vizita individuale, pa kontakte në hapësirat e destinuar për vizita, pas së cilave kryhej një dezinfektim i rregullt.

Në bashkëpunim me Shoqatën Maqedonase të Avokatëve të Rinj, Komiteti i Helsinkit u parashtrori institucioneve kompetente rekomandime të përbashkëta për zbatimin e masave të intensifikuara për mbrojtjen e personave të privuar nga liria në kushtet e pandemisë. Rekomandimet në përgjithësi kanë për qëllim parandalimin, me propozime për të zvogëluar numrin e personave të privuar nga liria (përmes përdorimit të masave alternative dhe probacionit - lirim me kusht, etj.) si dhe marrjen e masave për të garantuar mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe dinjitetit njerëzor të personave privuar nga liria edhe në kushtet e një pandemie.

Për zbatimin e protokolleve në secilin institucion ndëshkimore-korrektues dhe edukativo-korrektues aplikohen këto masa: dezinfektim i përditshëm i ambienteve ku qëndrojnë të dënuarit, shpërndarja e paketave për higjienë personale për secilin të dënuar, vendosjen e aparateve të dezinfektimit në hyrje të secilit institucion për dezinfektimin

¹³² Fundamental rights agency (FRA), Coronavirus pandemic in the EU- fundamental rights implications - <https://fra.europa.eu/en/publication/2020/covid19-rights-impact-april-1>

¹³³ Committee on the Rights of the Child (CRC), Statement: The Committee on the Rights of the Child warns of the grave physical, emotional and psychological effect of the COVID-19 pandemic on children and calls on States to protect the rights of children - https://tbinternet.ohchr.org/Treaties/CRC/Shared%20Documents/1_Global/INT_CRC_STA_9095_E.pdf

e duarve dhe këpucëve, termometra pa kontakt me të cilët do të kontrollohet rregullisht temperatura e trupit e të dënuarve, dhe çdo person i dënuar ose i paraburgosur i sapoardhur të akomodohet në një dhomë të izoluar për një periudhë prej 14 ditësh.

Drejtoria për Ekzekutimin e Sanskioneve në përgjithësi ka trajtuar mirë pandeminë e shkaktuar nga virusi Kovid-19 dhe si rezultat, vendi ynë ka një numër të vogël të burgosurish që janë pozitivë ndaj virusit. Shumica e njerëzve të infektuar ishin regjistruar në INK Shtip dhe në INK Idrizovë, ku vdiq një person si pasojë e virusit. Megjithatë, është shqetësues fakti në lidhje me efikasitetin e zbatimit të masave të mbrojtjes në institucionet e vuajtjes së dënimit që ende përballen me rrezikun e mbipopullimit, si dhe sigurimi i mjediseve të izolimit për personat që në asnjë mënyrë nuk duhet të jenë të njëjta me mjediset për vuajtjen e masës disiplinore të izolimit në vetmi, si dhe në institucionet ku kushtet higjienike janë në nivelin më të ulët për shkak të problemeve me furnizimin e rregullt me ujë.

Për të parandaluar përhapjen e virusit Kovid-19 në institucionet ndëshkimore-korrektuese, gjatë gjendjes së jashtëzakonshme u miratua vetëm një dekret me fuqi ligjore për zbatimin e Ligjit për Ekzekutimin e Sanskioneve. Dekreti zgjati lëshimin e akteve të referimit deri më 1 shtator 2020 dhe shtyu ekzekutimin e akteve të lëshuara të referimit deri në 1 shtator 2020.

VIZITAT MONITORUESE

Pas lehtësimit të masave kufizuese, në muajin gusht, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut së bashku me Shoqatën Maqedonase të Juristëve të Rinj filluan zbatimin e vizitave monitoruese në terren në të gjitha institucionet ndëshkimore-korrektuese dhe edukativo-korrektuese. Deri në fund të vitit 2020, u kryen gjithsej 29 vizita në të gjitha institucionet. Në lidhje me këto vizita është përgatitur një raport¹³⁴ që përmban një përmbledhje të monitorimit të kryer në terren, duke u përqëndruar në progresin dhe sfidat kryesore të dokumentuara gjatë vizitave, si dhe sfidat në lidhje me kujdesin shëndetësor dhe të drejtat e të dënuarve që duhet t'i gëzojnë edhe gjatë pandemisë me Kovid-19. Raporti gjithashtu përmban rekomandime për secilin institucion ndëshkimor-korrektues dhe edukativo-korrektues, si dhe rekomandime të përgjithshme për institucionet kompetente me qëllim të përmirësimit të situatës dhe kushteve në institucionet ndëshkimore-korrektuese dhe edukativo-korrektuese. Konstatimet e raportit tregojnë se megjithëse janë vërejtur disa përmirësime, sistemi penitenciar ende përballlet me probleme dhe sfida të mëdha, veçanërisht përsa i përket kushteve materiale, kujdesit shëndetësor, arsimit dhe risocializimit të të dënuarve, të cilat kërkojnë zgjidhje sistematike dhe fonde financiare, dhe mbi të gjitha një vullnet politik.

Në vitin 2020 u hapën ambiente të reja në INK Idrizovë, të cilat synojnë të akomodojnë 546 persona të dënuar. Ndërtesat e reja janë parashikuar si objekte për departamente të hapura dhe gjysmë të hapura, me qeli katër shtretërshe dhe në përputhje me standardet ndërkombëtare. Në kohën e vizitës, në ambientet e reja ishin akomoduar rreth 200 persona të dënuar. Kushte më të mira materiale u janë siguruar edhe personave të dënuar që po vuajnë dënimin me burg në INK Manastir. Për më tepër, këtë vit përfundoi edhe rindërtimi i Burgut të Manastirit, i cili u financua nga Bashkimi Evropian. Rindërtimi përfshiu punime ndërtimore dhe një skemë krejtësisht të re të dhomave të gjumit, duke zvogëluar numrin e personave të dënuar që qëndrojnë në një dhomë, si dhe pajimin e plotë të mjediseve ku do të qëndrojnë personat e dënuar.

Disa nga rekomandimet kryesore në raport që mund t'i veçojmë janë: të merren masa të menjëhershme dhe urgjente nga Ministria e Shëndetësisë për të siguruar qasje të papenguar në kujdesin shëndetësor për të gjithë personat e dënuar, regjistrimin e të gjitha akuzave për torturë, keqtrajtim dhe trajtim çnjerëzor ndaj personave të

¹³⁴ Raporti mbi situatën dhe kushtet në institucionet ndëshkimore-korrektuese dhe edukativo-korrektuese në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2021), i disponueshëm në: <https://mhc.org.mk/wp-content/uploads/2021/02/izvestaj-helsinski-popravni-domovi-mk-1.pdf>

dënuar, pa marrë parasysh a janë nga punonjësit në institucion ose midis të dënuarve, punësimin e personelit të duhur në institucione sa i përket risocializimit, dhe zhvillimin dhe zbatimin e programeve të përshtatshme të risocializimit, si dhe sigurimin e aksesit në arsim. Për më tepër, ende mbetet një sfidë mbështetja post-penale dhe nevoja për bashkëpunim ndërmjet Agjencisë së Punësimit dhe qendrave për punë sociale.

NDIHMJA JURIDIKE PËR PERSONAT E DËNUAR

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, së bashku me Shoqatën Maqedonase të Juristëve të Rinj, ofruan ndihmë juridike të drejtpërdrejtë për 119 persona të dënuar gjatë vitit 2020, kurse 151 personave iu dha ndihmë juridike në lidhje me përdorimin e mekanizmave për mbrojtje kundër torturave dhe trajtimit çnjerëzor.

Çështjet më të zakonshme juridike për të cilat është ofruar ndihmë juridike janë: lirimi me kusht, qasja në kujdesin shëndetësor, qasja në asistencë psikiatrike dhe psikologjike, ankesa për shkak të kushteve materiale joadekuate ose vakteve joadekuate, privilegjeve të kufizuara, etj. Me pëlqimin e personave të dënuar dhe një autorizim të lëshuar prej tyre, avokatët e angazhuar nga Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj gjithashtu parashtruan 24 parashtrës në institucionet shtetërore për mbrojtjen e të drejtave të personave të dënuar.

**ПРАВЕН СОВЕТ
ЗА ОСУДЕНИ ЛИЦА**

ПРИЈАВИ НА 075 277 924 ОСУДЕНО ЛИЦЕ КОЕ ИМА ПОТРЕБА ОД ПРАВЕН СОВЕТ ВО ВРСКА СО ИЗДРЖУВАЊЕ НА КАЗНАТА ЗАТВОР
Правната помош не се однесува на криминално дело на кое е осудено лицето.

 **ПРАВЕН СОВЕТ
ЗА ОСУДЕНИ ЛИЦА**

Donbas бр.14-1/6 | Naum Naumovski Borchе бр.83
02/3220-870 | 02/3119-073
contact@myla.org.mk | helkom@mhc.org.mk

**KËSHILLA JURIDIKE PËR
PERSONAT TË DËNUAR**

PARAQIT NË 075 277 924 NJË PERSON TË DËNUAR QË KA NEVOJË PËR KËSHILLA JURIDIKE NË LIDHJE ME VUAJTJEN E DËNIMIT ME BURG
Nuk do të ofrohet ndihmë juridike për veprën penale për të cilën personi është dënuar.

 **KËSHILLA JURIDIKE PËR
PERSONAT TË DËNUAR**

Donbas No.14-1/6 | Naum Naumovski Borchе No.83
02/3220-870 | 02/3119-073
contact@myla.org.mk | helkom@mhc.org.mk



(nga fushata e përbashkët me Shoqatën Maqedonase të Juristëve të Rinj)

SHTËPIA EDUKATIVO-KORREKTUESE TETOVË

Në fillim të muajit nëntor, Institucioni Shtëpia edukativo-korrektuese Tetovë në fshatin Vollkovi, e cila më parë vepronte në kuadër të Burgut Ohër, përfundimisht u fut në funksion. Megjithatë struktura në Vollkovi ka një kapacitet për mbi 100 fëmijë dhe mund të strehojë përkohësisht të gjithë fëmijët, përfshirë fëmijët e dënuar me burgim për të mitur, transferimi iu bë vetëm fëmijëve që vuanin një masë edukativo-korrektuese. Fëmijët që vuajnë dënimin me burg mbetën brenda institucionit në Ohër, i cili nuk i plotëson standardet ndërkombëtare nga cilido aspekt.

Institucioni i ri në fshatin Vollkovi ofron kushte më të përshtatshme materiale për fëmijët, por arsimit, procesi i risocializimit dhe ndihma post-penale për fëmijët mbetet ende një sfidë, si probleme sistematike që tërhiqen për bite me radhë.

Për qëllime të risocializimit, Komiteti Hollandez i Helsinkit së bashku me Komitetin e Helsinkit për të Drejtat e Njeriut po zbatojnë një projekt që synon të përmirësojë procesin e risocializimit të fëmijëve duke forcuar kapacitetet e brendshme të punonjësve të institucionit. Si hap i parë, në vitin 2021, do të kryhen gjithsej 5 trajnime për punonjësit e SHEK Tetovë nga ekspertë nga Holanda, të cilat do t'i referohen: qasjes profesionale, integritetit, rregullave, procedurave, sigurisë dhe vetëdijes për sigurinë, të drejtat dhe detyrimet e personave të mitur dhe menaxhimin e sjelljes së të miturve, sidomos menaxhimin e zemërimit (nervozitetit).

TORTURA DHE TRAJTIMI ÇNJERËZOR

Përmes kërkesave për qasje në informacionin publik, Komiteti i Helsinkit mori informacion që në vitin 2020 në Prokurorinë Themelore Publike - Njësia për hetimin dhe ndjekjen e veprave penale të kryera nga persona me kompetenca policore dhe anëtarë të policisë së burgut nga ana e Departamentit për kontroll të brendshëm, hetimet penale dhe standardet profesionale, u ngritën gjithsej nëntë kallëzime penale, kurse nga ana e Avokatit të Popullit u ngritën dy kallëzime penale. Prokuroria kompetente informoi se në **39** raste kundër **80** policëve procedura është ende në proces e sipër.

Numri i përgjithshëm i rasteve të torturave dhe trajtimeve çnjerezore nga anëtarët e policisë së burgut është **katër**, kundër **tetë** anëtarëve të policisë së burgjeve. Në **tre** raste procedura është në vazhdim e sipër, kurse për **një** rast është marrë një vendim nga ana e prokurorit publik.

Gjykata Themelore Penale Shkup dorëzoi informacion se në vitin 2020 kundër oficerëve të policisë dhe anëtarëve të policisë së burgjeve janë vetëm tetë procedura gjyqësore që janë në vazhdim e sipër ose të përfunduara, të gjitha për veprën penale "Torturë gjatë kryerjes së detyrave zyrtare".

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut dhe Shoqata Maqedonase e Juristëve të Rinj ngritën tri akuza penale për brutalitet policor në zyrën e prokurorit kompetent dhe siguruan avokatë për dy viktime të brutalitetit policor, të cilët duhej të paraqiteshin në cilësinë e palëve të dëmtuara përpara zyrës së prokurorit kompetent.

MEKANIZMI I MBIKËQYRJES

Republika e Maqedonisë së Veriut është ende duke luftuar për të krijuar mekanizma efektivë të brendshëm dhe të jashtëm për parandalimin dhe ndjekjen penale të autorëve të krimeve në të gjitha rastet e torturave dhe trajtimeve çnjerezore në burgje dhe institucionet e paraburgimit. Dy vjet pas ndryshimeve në Ligjin për Avokatin e Popullit, mekanizmi i kontrollit civil ende nuk po funksionon, për shkak të koordinimit dhe komunikimit joadekuat me Avokatin e mëparshëm të Popullit. Në mënyrë që të krijohen kushte për fillimin përfundimtar të punës së organit për kontroll të jashtëm brenda Avokatit të Popullit, është veçanërisht e rëndësishme të zhvillohet dhe miratohet një metodologji për punën e institucionit në kohën më të shkurtër të mundshme, e cila do të pranohet dhe miratohet nga të gjithë palët e interesuara.


KUADRO JOADEKUATE NË POZITA DREJTUESE

Në vitin 2020, u bënë ndryshime në disa nga pozitat menaxheriale në institucionet ndëshkimore-korrektuese në RMV. Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut ka shprehur shqetësimin nëse kandidatët e sapozgjedhur kanë kompetenca të mjaftueshme për t'u përgjigjur nivelit të detyrës. Gjegjësisht, personat që administrojnë këto institucione duhet të kenë përvojë të mëparshme në fushën e ekzekutimit të sanksioneve. Ata duhet të kuptojnë mirë problematikën në mënyrë që të përfaqësojnë institucionin, të kujdesen për promovimin e të drejtave të të paraburgosurve dhe të dënuarve, të vendosin për privilegjet dhe detyrimet e tyre, për trajtimin e tyre dhe angazhimin në punë në mënyrë që të risocializojnë dhe më tej integrimin e tyre shoqëror në jetën shoqërore. Vite më parë, ne kemi bërë thirrje mbi nevojën e emërimit të njerëzve në poste drejtuese në institucionet ndëshkimore-korrektuese, të cilët jo vetëm që kanë ekspertizë dhe përvojë në sistemin e burgjeve, por gjithashtu janë sensibilizuar për nevojën e promovimit dhe mbrojtjes së të drejtave themelore të njeriut të të dënuarve dhe të paraburgosurve. Emërimi i kuadrove joadekuate është plotësisht në kundërshtim me përpjekjet e tilla dhe mund të çojë në regres, në vend të përmirësimit të sistemit penitenciar në vendin tonë.


GJUHA E URREJTJES

Në vitin 2020, në portalin në internet www.govornaomraza.mk u regjistruan **gjithsej 1233** denoncime në lidhje me gjuhën e urrejtjes, që ishte një rritje prej **130%** në krahasim me vitin 2019. Nga analiza e kryer nga Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, katër kategori u identifikuan si më të ndjeshme në kontekstin shoqëror: *gjuha e urrejtjes për shkak të përkatësisë etnike (42%), përkatësisë politike (23%), orientimit seksual (18%), nga numri i përgjithshëm i denoncimeve për vitin 2020.*


Grafiku 1 – Pasqyrë e gjuhës së urrejtjes sipas kategorive për vitin 2020



Grafiku 2 – Tendencë vjetore e gjuhës së urrejtjes për vitin 2020



Grafiku 3 – Rritja e gjuhës së urrejtjes nga viti 2019 deri në vitin 2020



Aspekti negativ bazohet në pandeminë globale me Kovid-19 dhe masat e miratuara nga ana e Qeverisë për të trajtuar krizën shëndetësore, si dhe reagimet e publikut ndaj këtyre masave. Viti 2020 ishte gjithashtu një vit zgjedhesh, respektivisht në korrik 2020 u organizuan zgjedhje të parakohshme parlamentare, të cilat çuan në një polarizim shtesë politik në shoqëri. Karakteristikë për vitin 2020 është rritja drastike e denoncimeve bazuar në përkatësinë etnike. Arsyejt për këtë tendencë janë shtjelluar më hollësisht në tekstin më poshtë.

Gjatë gjithë vitit, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut i bëri thirrje Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, posaçërisht Ministrisë së Punëve të Brendshme, që menjëherë të marrin masa brenda kompetencës së tyre për të sanksionuar këtë fenomen - gjegjësisht punë më intensive me organizatat e shoqërisë civile dhe një fushatë publike për edukim shtesë të qytetarëve. Në vendin tonë ende nuk ka praktikë gjyqësore në këtë fushë.

Ky fenomen ishte aktualizuar edhe në nivel të Bashkimit Evropian, sidomos përmes miratimit të Kodit të sjelljes të kompanive të mëdha të teknologjisë informatike, që ka për qëllim sanksionimin e gjuhës së urrejtjes në mediat sociale¹³⁵. Rekomandimet që përmban Kodi, në masë të madhe korrespondojnë me konstatimet e Komitetit, veçanërisht sa i përket nevojës për partneritet midis institucioneve kombëtare dhe organizatave të shoqërisë civile për formimin e një rrjeti të monitorimit. Është konstatuar gjithashtu nevoja për fushata publike për edukimin e publikut, si dhe trajnime të specializuara për të gjithë nëpunësit që punojnë në këtë temë.


Janar - prill 2020

Gjatë kësaj periudhe, gjuha e urrejtjes u rrit për shkak të orientimit seksual dhe identitetit gjinor si reagim ndaj fushatës publike "Diskriminimi përfundon me mua!" të Rrjetit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Një nga tre videot promovuese në këtë fushatë kishte të bënte me promovimin e të drejtave dhe mbrojtjen e komunitetit LGBTI, e cila shkaktoi gjuhë urrejtjeje në mediat sociale, përdorimin e gjuhës diskriminuese dhe poshtërimin.


Komiteti i Helsinkit, bazuar në analizën e tij të vitit 2019, paralajmëroi për një rritje të gjuhës së urrejtjes, veçanërisht pas shpërbërjes së Kuvendit dhe fillimit të fushatës politike në prag të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të vitit 2020. Shumica e rasteve të regjistruara në muajin mars kishin të bënin me situatën me pandeminë e virusit COVID-19, shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme nga Presidenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe reagimet e publikut ndaj masave të miratuara nga Qeveria. Shumica e trafikut digjital, dhe kështu edhe reagimet në mediat sociale u vunë re pas përfundimit të konferencave zyrtare për shtyp të Ministrisë të Shëndetësisë në emër të Shtabit të Krizave (shih Grafikon 5).

¹³⁵ European Commission (February 2019) *How the Code of conduct helped countering illegal hate speech online*. I disponueshëm në https://ec.europa.eu/info/sites/info/files/hatespeech_infographic3_web.pdf

Grafiku 4 – Pasqyrë e gjuhës së urrejtjes sipas kategorive për vitin 2020 (janar – prill 2020)




Grafiku 5 – Tendenca e gjuhës së urrejtjes (janara – prill 2020)



Ngjashëm me muajin mars, në muajin prill shumica e denoncimeve (ose 61%) përsëri i referoheshin përkatësisë etnike dhe përkatësisë politike. I inkurajuar nga situata e re e posakrijuar, Komiteti i Helsinkit me prezantimin e kategorisë së gjuhës së urrejtjes bazuar në gjendjen shëndetësore, Komiteti i Helsinkit ka përmirësuar sistemin e tij të monitorimit. Mbi këtë bazë, në muajin prill u regjistruan 11% e numrit të përgjithshëm të denoncimeve. Pas një periudhe të gjatë pas rishikimit të metodologjisë për monitorimin e gjuhës së urrejtjes, u verifikuan edhe denoncime mbi bazën e origjinës sociale, si dhe fesë dhe besimit fetar. Siç kemi theksuar më lart, rritja është përsëri për shkak të zgjatjes së gjendjes së jashtëzakonshme në vend për të parandaluar përhapjen e koronavirusit. Pati gjithashtu në mënyrë aktive një diskutim negativ midis mbështetësve të partive në pushtet dhe opozitës, veçanërisht në lidhje me mënyrën se si vendi po trajton krizën, si dhe iniciativën e një grupi deputetësh për të thirrur Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut për të konfirmuar vendimin e Presidentit për zgjatjen e gjendjes së jashtëzakonshme.

Komiteti i Helsinkit gjatë kësaj periudhe paralajmëroi për një rritje drastike të gjuhës së urrejtjes, veçanërisht në kontekstin e ri të posaktijuar me shpalljen e pandemisë dhe shpalljen e gjendjes së jashtëzakonshme në vend. Komiteti paralajmëroi gjithashtu se nuk duhen të keqpërdoren mekanizmat në dispozicion që ka pushteti ekzekutiv dhe se duhet të informojnë rregullisht Presidentin e shtetit, mediat dhe organizata e shoqërisë civile për masat e miratuara dhe efektin e tyre. Kjo ishte veçanërisht e rëndësishme në mungesë të një Kuvendi funksional, për mundësinë e mbikëqyrjes efektive të punës së ekzekutivit në kohën e gjendjes së jashtëzakonshme.


Grafiku 6 – Pasqyrë e gjuhës së urrejtjes (maj - gusht 2020)



Siç mund të shihet nga tabela mbi tendencën e gjuhës së urrejtjes në mediat sociale për muajin maj 2020, shumica e denoncimeve u regjistruan në dy periudha - mbajtjen e ritit fetar për Ditën e Shën Gjergjit në Strugë - megjithë rekomandimeve të Qeverisë për distancimin shoqëror dhe protokollet përkatëse¹³⁷, dhe para festës myslimane të Ramazan Bajramit, ngjashëm si në muajin prill me rastin e festës fetare të Pashkëve). Përkundër rekomandimeve të qarta të Qeverisë për të respektuar masat për parandalimin dhe përhapjen e KOVID-19, disa nga udhëheqësit fetarë kishin pikëpamje dhe rekomandime të kundërta në atë periudhë dhe lejuan mbajtjen e këtyre riteve fetare.

Shumica e denoncimeve në muajin maj (ose 67% e numrit të përgjithshëm të denoncimeve të verifikuara) përsëri u referohen dy kategorive, përkatësisë etnike dhe përkatësisë politike. Kjo është për shkak të zgjatjes së gjendjes së jashtëzakonshme në vend për parandalimin dhe përhapjen e KOVID-19. Kishte gjithashtu në mënyrë aktive edhe një diskutim negativ midis mbështetësve të partive në pushtet dhe opozitës, veçanërisht në lidhje me mënyrën se si vendi po e trajton krizën dhe debatin mbi një datë të mundshme për mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare.

Grafiku 7 – Tendenca e gjuhës së urrejtjes (maj - gusht 2020)




¹³⁷ Protokollet e sigurisë së Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për të parandaluar përhapjen e Covid-19. I disponueshëm në: <https://vlada.mk/protokoli-koronavirus?fbclid=IwAR1w6Y8bSmsKrVT-W2JI9XhweWRFuHK4tOeQcRSC6kGVuDSseMs65nYS-hhw>

Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut në muajin qershor regjistroi një numër denoncimesh (105) të gjuhës së urrejtjes në mediat sociale. Shumica e rasteve të regjistruara gjatë këtij muaji kishin të bënin me situatën me pandeminë KOVID-19 dhe vendimin për të mbajtur zgjedhje të parakohshme parlamentare në muajin korrik. Reagimet në mediat sociale kishin të bënin me rritjen drastike të njerëzve të infektuar rishtas me KOVID-19 që nga fillimi i muajit. Kjo situatë mori edhe një ngjyrim etnik dhe shkaktoi rritje të gjuhës së urrejtjes në mediat sociale. Numri më i madh i denoncimeve u regjistruan pas karantinës së fundit në lidhje me festën e krishterë Rrëshaja (e diel, 16-19 qershor). Ngjashëm me qershorin e vitit të kaluar (2019), kur u mbajt para e parë e krenarisë në Maqedoninë e Veriut, në tri ditët e fundit të muajit, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut vuri re një tendencë të shtuar të gjuhës së urrejtjes bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor, e gjithë kjo si rezultat i një sërë eventesh në lidhje me festimin e Muajit të krenarisë.

Numri më i madh i rasteve në muajin korrik kishin të bënin me mbajtjen e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare (15 korrik 2020) dhe atmosferën politike përgjithësisht negative. Kjo ka rezultuar në një numër të lartë denoncimesh për gjuhë të urrejtjes bazuar në përkatësinë politike dhe etnike. Për shkak të mënyrës ndryshe të mbajtjes së këtyre fushatave politike për shkak të kushteve të imponuara nga pandemia, shumica e mesazheve nga partitë politike u transmetuan dhe diskutuan në mediat sociale. Megjithatë një pjesë e madhe e fushatës u zhvillua në mënyrë virtuale, megjithatë kishte edhe një fushatë tradicionale me tubime, në të cilën nuk respektoheshin plotësisht masat mbrojtëse (sidomos mbajtja e maskave). Kjo kontribuoi në shkëmbimin e gjuhës së urrejtjes në mediat sociale, të cilat, përveç se ishin politike, kishin edhe një kontekst etnik. Për krahasim, nga 1 prilli 2019 deri në fund të raundit të dytë të zgjedhjeve presidenciale, Komiteti i Helsinkit ka regjistruar 63 denoncime. Gjatë kohës së zgjedhjeve, pati një rritje me mbi 80% të denoncimeve për të njëjtat kategori.


Diskursi negativ nga periudha paszgjedhore në korrik vazhdoi edhe në muajin gusht 2020 me retorikë jashtëzakonisht të intensifikuar dhe ofenduese. Negociatat mbi qeverinë e re prodhuan gjuhë urrejtjeje, kryesisht të një natyre etnike, në kontekstin e negociatave midis Lidhjes Socialdemokrate të Maqedonisë (LSDM) dhe Bashkimit Demokratik për Integrim (BDI). Gjuha fyese u përdor drejtpërdrejt kundër politikanëve të caktuar, duke i quajtur ata "të shitur", "tradhtarë", etj. Gjatë këtyre muajve, Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut vuri re një fjalim jashtëzakonisht nacionalist, plot urrejtje. Numri më i madh i rasteve u regjistruan më 25 gusht 2020, pas shpalljes së një koalicioni pas-zgjedhor midis LSDM-së dhe BDI-së.

Grafiku 8 – Pasqyrë e gjuhës së urrejtjes (shtator – dhjetor 2020)



Në shtator të vitit 2020, ngjashëm me periudhën e mëparshme, Komiteti vuri re një numër të lartë denoncimesh në lidhje me gjuhën e urrejtjes, të cilat nga kjo fazë u përshkallëzuan në vepra të gjuhës së urrejtjes. Dy incidente të dhunshme në një javë, të shkaktuara nga një grup tifozësh në Shkup, edhe një herë treguan se nevoja për t'u marrë me të vërtetë me këtë fenomen shkatërrues nuk duhet të shpërfillet më. Përkundër numrit të madh të thirrjeve publike për veprim aktiv në terren dhe në mediat sociale, ka ende inerci dhe mosrespektim nga institucionet, veçanërisht nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Prokuroria Publike.

Sidoqoftë, Qeveria e Republikës së Maqedonisë së Veriut në seancën e saj të 4-të shqyrtoi rastin e gjuhës së urrejtjes që ndodhi në sheshin "Maqedonia" dhe "dënoi fuqishëm sjelljen e tifozëve që shkaktuan urrejtje, përçarje dhe intolerancë mbi baza etnike". Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut e mirëpriti këtë angazhim politik dhe tregoi se pret masa më konkrete nga institucionet kompetente të obliguara për parandalimin dhe sanksionimin e kësaj dukurie. Komiteti i Helsinkit gjithashtu beson se duhet të hapet një debat më i gjerë publik mbi këtë çështje, në të cilin do të marrin pjesë të gjithë palët e interesuara. Duhet të përmirësohet procesi i krijimit të politikave publike në këtë fushë, duke pasur parasysh që gjuha e urrejtjes ka trajtimin e saj të duhur në Kapitullin 23 - Gjyqësori dhe të Drejtat Fundamentale dhe Kapitullin 24 - Drejtësia, Liria dhe Siguria. Komiteti i Helsinkit konsideron se numri i vazhdueshëm në rritje i rasteve që lidhen me gjuhën e urrejtjes është për shkak të njohjes së pamjaftueshme të problematikës, trajtimit të saj brenda Bashkimit Evropian dhe vendeve anëtare të tij dhe mungesës së praktikës gjyqësore (si dhe mosndëshkueshmërisë së vazhdueshme me rastin e shkeljes së Nenit 319 të Kodit Penal).



Një nga rekomandimet kryesore të Komisionit Evropian¹³⁸ është që ka mospërputhje ligjore në rregullimin e gjuhës së urrejtjes. Kërkohet një rishikim i kornizës ligjore në përputhje me praktikën më të mira evropiane. Komisioni arrin në përfundimin se gjuha e urrejtjes është një vepër penale, por që është e përhapur në mediat sociale. Gjithashtu, Komiteti i Helsinkit përmes monitorimit të tij bie dakord që korniza ligjore duhet të rishikohet dhe të merren masa konkrete për ta sanksionuar atë duke ndërtuar kapacitetet e Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe Prokurorisë Publike. Konstatimet e Komitetit të Helsinkit konfirmojnë se mekanizmat parandalues kombëtarë për trajtimin e gjuhës së urrejtjes janë të papërshtatshme.

Shumica e rasteve në fund të vitit iu referuan përsëri pretendimeve të gjuhës së urrejtjes bazuar në përkatësinë etnike. Mesatarisht, nga 45% prej numrit të përgjithshëm të denoncimeve për muajin tetor, nëntor dhe dhjetor ishin mbi këtë bazë. Me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Tolerancës më 16 nëntor 2020, Komiteti i Helsinkit publikoi një seri thirrjesh publike tek institucionet kompetente për veprim aktiv në terren dhe në mediat sociale. Mesazhi i Komitetit të Helsinkit është se ne jetojmë në një pjesë të botës që shumë herë në të kaluarën është përballur me pasojat shkatërruese të intolerancës dhe produkteve të saj: urrejtja dhe dhuna dhe "... prandaj, ajo gjithmonë dhe kudo duhet të përsëritet se toleranca është thelbësore për ruajtjen e paqes dhe progresit ekonomik dhe shoqëror të të gjithë njerëzve, dhe kjo veçanërisht është indikative për shoqëritë që janë multietnike dhe multikulturore. Nga ana tjetër, pabarazia shoqërore, diskriminimi dhe gjuha dhe veprat e urrejtjes nuk duhet të shpërfillen, të cilat vijnë pikërisht nga intoleranca ndaj njerëzve të tjerë dhe të ndryshëm¹³⁹".

¹³⁸ Raporti i Komisionit Evropian për Republikën e Maqedonisë së Veriut. https://ec.europa.eu/neighbourhood-enlargement/sites/near/files/north_macedonia_report_2020.pdf, fq. 30.

¹³⁹ Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut (nëntor 2020) *Raport mujor për të drejtat e njeriut për muajin nëntor 2020* <https://mhc.org.mk/reports/mesechen-izveshta%d1%98-za-chovekovite-prava-vo-republika-severna-makedoni%d1%98a-noemvri-2020/>

Komiteti i Helsinkit vazhdoi me identifikimin e toneve jashtëzakonisht homofobike në ligjërimin publik, duke përdorur gjuhë fyese dhe diskriminuese. Deri në fund të vitit, kishte një rritje të gjuhës së urrejtjes bazuar në orientimin seksual dhe identitetin gjinor, veçanërisht pas njoftimit për formimin e Grupit Ndërparlamentar për Mbështetjen e të Drejtave të Komunitetit LGBTI brenda përbërjes së re parlamentare.

Tendencat negative të përhapjes së gjuhës së urrejtjes në vend mund të parandalohen vetëm me ndryshime rrënjësore, si në aspektin e trajtimit të këtyre fenomeneve nga institucionet kompetente, ashtu edhe në aspekt të reformave të nevojshme në arsim dhe kulturën e komunikimit në përgjithësi. Lufta kundër keqinformimit dhe lajmeve të rreme, të cilat rregullisht ushqejnë atmosferën e urrejtjes në ligjërimin publik, është veçanërisht e rëndësishme, veçanërisht në situata ku mungojnë informacionet e sakta, në kohë dhe të verifikuara nga burimet përkatëse.




Gjatë vitit 2020, Komiteti i Helsinkit gjithashtu implementoi një projekt pilot për monitorimin e gjuhës së urrejtjes në nivel lokal. Procesi i mbledhjes së të dhënave në qytetet Tetovë, Manastir dhe Shtip tregoi se përkatësia etnike mbizotëron si bazë për gjuhën e urrejtjes në nivelin lokal. ¹⁴⁰

¹⁴⁰ Raport vjetor nga monitorimi i gjuhës së urrejtjes në nivel lokal në qytetet Tetovë, Manastir dhe Shtip. I disponueshëm në: <https://mhc.org.mk/reports/godishen-izveshta%d1%98-od-monitoring-na-govor-na-omraza-na-lokalno-nivo-vo-gradovite-tetovo-bitola-i-shtip-2020/>

VEPRAT NGA GJUHA E URREJTJES

Në vitin 2020, Komiteti regjistroi gjithsej 104 incidente të krimeve të urrejtjes. Incidentet u regjistruan menjëherë pasi u raportuan nga media ose Ministria e Punëve të Brendshme. Në të njëjtën kohë, 37 incidente (36%) u konfirmuan, ndërsa 67 (64%) janë ende të pakonfirmuara.¹⁴¹ Shumica e rasteve të pakonfirmuara kanë të bëjnë me situata ku, sipas treguesve të tjerë¹⁴² ka arsye për të besuar se këto incidente të njëanshme janë motivuar për shkak të përkatësisë etnike të viktimës. Megjithë kërkesën tonë për konfirmimin e treguesve, Ministria e Punëve të Brendshme nuk i ka konfirmuar ende këto krime/incidente të urrejtjes. Baza etnike (76 incidente) dhe përkatësia politike (12 incidente) marrin përsëri pjesën më të madhe të bazave për krime të kryera të urrejtjes gjatë vitit 2020. Gjithashtu, në 5 krime të urrejtjes, shënjestër ishin migrantët ose refugjatët si rezultat i statusit të tyre, motivi në 4 incidente ishte kombësia e ndryshme, 3 incidente kanë ndodhur si rezultat i besimeve fetare, 2 incidente ishin të motivuara nga orientimi seksual, 1 incident ishte kryer në bazë të aftësisë së kufizuar intelektuale dhe 1 incident mbi baza gjinore. Viktimat dhe autorët e krimeve janë zakonisht të rinj dhe anëtarë të bashkësive të ndryshme etnike.¹⁴³ Shpesh ndodh që një incident t'i plotësojë kriteret për të dyshuar në ekzistencën e dy ose më shumë veprave penale, kështu që numri i veprave penale është më i madh se numri i incidenteve. Shumica e incidenteve janë kryer si rezultat i përkatësisë politike ose bindjes politike kur viktimat nuk janë njerëz, por persona juridikë si për shembull shtabe partish politike, si rezultat i faktit që shumica e këtyre incidenteve kanë të bëjnë me dëmtimin e pronës dhe dëmeve të shkaktuara materiale.




¹⁴¹ Incidentet u regjistruan menjëherë pasi u raportuan nga media ose Ministria e Punëve të Brendshme. Një incident i konfirmuar konsiderohet të jetë një incident në të cilin me siguri bëhet fjalë për një vepër penale nga urrejtja bazuar në informacionet e deklaruara nga personat e interesuar, media dhe/ose Ministria e Punëve të Brendshme. Rastet e pakonfirmuara kanë të bëjnë me situata ku sipas treguesve të tjerë ka arsye për të besuar se këto incidente të njëanshme motivohen nga përkatësia etnike e viktimës, por nuk mund të konfirmohet me siguri se është një vepër penale nga urrejtja.

¹⁴² Vendi, mënyra e kryerjes, pjesëmarrja e të miturve dhe nxënësve të shkollave të mesme.

¹⁴³ Kryesisht midis maqedonasve dhe shqiptarëve

Numri më i madh i incidenteve janë kryer nga të rinj, ndërsa shumica e autorëve nuk janë identifikuar. Viktimat dhe autorët e krimeve janë zakonisht anëtarë të bashkësive të ndryshme etnike,¹⁴⁴ ndërsa incidentet e raportuara kanë të bëjnë me vepra të caktuara penale të përfshira në Kodin Penal.



Shumica e incidenteve - 72 (69.2% e numrit të përgjithshëm të incidenteve të regjistruara) ndodhën në Shkup dhe komunat përreth. 7 incidente kanë ndodhur në Kumanovë, 5 në Manastir, 4 në Ohër, 3 në Tetovë, 3 në Kërçovë, Veles, Strugë dhe 2 në Prilep dhe nga 1 incident në Krushevë, Koçanë, Dellçevë dhe Strumicë, ndërsa për 1 incident vendi i ndodhjes është i panjohur.

Këto të dhëna janë një ekstrakt nga Raporti vjetor për veprat nga gjuha e urrejtjes¹⁴⁵, të cilin Komiteti i Helsinkit e përgatit për të tetin vit radhazi dhe që përmban një vështrim më të thellë të situatës, si dhe përshkrime të hollësishme të incidenteve të regjistruara.

¹⁴⁴ Kryesisht, por jo vetëm: maqedonas dhe shqiptarë.

¹⁴⁵ Raporti vjetor për veprat nga gjuha e urrejtjes për vitin 2020, nga Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut, i disponueshëm në: <https://mhc.org.mk/reports/godishen-izveshtaj-za-kriminalot-od-omraza-vo-2020/>



Foto nga aksioni i vjeshtës për heqjen e përmbytjeve me gjuhë të urrejtjes nga sipërfaqet publike.

Autor i fotografive: Vildan Drpljanin

Titullar i të drejtave: Komiteti i Helsinkit për të Drejtat e Njeriut

QENDRA PËR MBËSHTETJE LGBTI

Efektet e pandemisë në komunitetin LGBTI

Pandemia me KOVID-19 nuk është vetëm një problem shëndetësor, por edhe një tronditje për çdo shoqëri që ndikon fuqishëm mbi mirëqenien dhe cilësinë e jetës së personave LGBTI. Në kohë krize, komunitetet e marginalizuara janë më të prekshme dhe dhuna ndaj pakicave gjinore dhe seksuale është gjithnjë në rritje. Me sigurinë dhe shëndetin e rrezikuar, komuniteti është i stigmatizuar në mënyrë shtesë. Ndikimi disproporcional i pandemisë mbi grupet e marginalizuara, ndikoi gjithashtu edhe mbi komunitetin LGBTI, të rinjtë LGBTI dhe adoleshentët, të cilët edhe në rrethana të tjera janë ndër grupet më të ndjeshme shoqërore. Situata e krizës ka rritur rrezikun e diskriminimit të shumëfishtë dhe ndërsektorial në fusha të ndryshme - tregu i punës, shëndetësia, shërbimet sociale, si dhe aksesit në shërbime të tjera (të përcaktuara nga masa të përkohshme për të zvogëluar pasojat e trajtimit të krizës shëndetësore dhe ekonomike shkaktuar nga koronavirusi KOVID -19 për grupet e identifikuara të prekshme).

Për shkak të masave kufizuese për të trajtuar pandeminë, personat LGBTI u përballën me frikë dhe rreziqe shtesë - jetesë e detyruar në një mjedis homofobik për shkak të lëvizjes së kufizuar, orës policore dhe mbylljes; familjeve që nuk i mbështesin; rritjen e rrezikut nga mungesa e strehimit dhe dhuna; shëndetin të dobët dhe higjienës dhe rrezikut në rritje të problemeve mendore. Në këtë drejtim, mjedisi i sigurt dhe i besueshëm i ofruar nga Qendra e strehimit - Shtëpia e Sigurt, ishte thelbësore për procesin e forcimit të shëndetit fizik dhe mendor të përdoruesve të shtëpisë. Në kushtet e reja të krizës, është më e rëndësishme që kjo strehimore të adresojë nevojën për një qasje gjithëpërfshirëse ndaj nevojave dhe të drejtave të viktimave të dhunës në familje, dhunës me bazë gjinore dhe dhunës bazuar në orientimin seksual dhe/ose identitetin gjinor, respektivisht nevojat për sigurimin e një pakete minimale shërbimesh me veçori dhe cilësi adekuate.

Masat mbrojtëse nga KOVID-19 që kishin të bënin me kufizimin e lëvizjes ishin diskriminuese, veçanërisht për çiftet LGBTI. Një shembull tipik i kësaj është kur, gjatë lehtësimit të masave në fillim të verës, Qeveria vendosi që në një tavolinë të restoranteve mund të socializoheshin persona të cilët mund të dëshmonin se janë anëtarë të një familje. Personat LGBTI që ende fshehin identitetin e tyre gjinor/seksual, dhe të rinjtë LGBTI janë sidomos më të prekur këtu, u është dashur të qëndrojnë në shtëpitë e prindërve dhe familjeve të tyre, të cilët shpesh janë armiqësorë dhe madje të dhunshëm ndaj tyre. Personat LGBTI kryesisht ndërtojnë komunitetin dhe marrëdhëniet e tyre në hapësirat për socializim, të cilat janë të pakta në vendin tonë dhe të cilat kanë mbetur të mbyllura gjatë kësaj periudhe. E gjithë kjo ka pasur një ndikim dhe presion të madh në shëndetin mendor të personave LGBTI, të cilët në rrethana normale, për shkak të stigmës shoqërore, janë shumë më të predispozuar ndaj depresionit, ankthit, izolimit dhe tendencave vetëvrasëse.

Në përgjigje të këtyre problemeve dhe nevojës për socializim, solidaritet dhe mbështetje të ndërsjellë, u krijua një grup online "LGBTI së bashku në vetizolim". Platforma është përdorur në shumë mënyra. Njerëzit nga komuniteti u inkurajuan të flasin për problemet dhe sfidat me të cilat përballen si rezultat i vetizolimit, por gjithashtu filluan të organizonin evente virtuale brenda grupit të tilla si diskutimet online për tema të ndryshme, shfaqje atraktive, performanca muzikore, etj. Ekzistenca e një komuniteti të tillë "virtual" LGBTI ka ndihmuar në uljen e efekteve negative të izolimit. Një numër i madh eventesh në kuadër të "Skopje Pride 2020 - virtual edition" u organizuan pikërisht në këtë platformë online.

Nga ana tjetër, gjatë vitit 2020 patëm mundësi të shohim një forcim të lëvizjes lezbike-feministe në vend. Grupi joformal Lesfem nisi një fushatë për të festuar 26 prillin, Ditën Ndërkombëtare të Dukshmërisë së Lezbikeve me hashtag-un #LezbejkaeUbavZbor. Në muajin shtator, grupi organizoi një kamp lezbik 2-ditor, ku pjesëmarrësit patën mundësinë të ndiqnin trajnime mbi mbrojtjen nga dhuna në familje, mbrojtjen nga diskriminimi, identifikimi i gjuhës dhe

veprave nga urrejtja, si dhe të merrnin pjesë në një diskutim për të ndarë përvojat personale me pjesëmarrësit e tjerë. Pjesëmarrëset patën mundësinë të njihen me aktivizmin krijues dhe të zhvillojnë ide që do të donin t'i realizonin në të ardhmen. Gjatë muajit dhjetor, Lesfem zhvilloi një studim mbi nevojat dhe dëshirat e komunitetit LB+, rezultatet e të cilit do të jenë baza për aktivitete të mëtejshme që synojnë përforcimin e këtij komuniteti.

Përfaqësimi

Përfaqësimi për avancimin e të drejtave LGBTI të njeriut në vend ishte një sfidë e madhe gjatë vitit 2020. Përveç krizës shëndetësore, e cila po zgjat ende dhe lë pasoja të përhershme, veçanërisht për komunitetet më të marginalizuara, ne gjithashtu u përballëm edhe me një situatë të paqëndrueshme politike. Për shkak të shtyrjes së zgjedhjeve të parakohshme parlamentare, institucioni ligjvënës nuk funksionoi për më shumë se tetë muaj. Kjo situatë e bëri më të vështirë procesin e avokimit dhe përfaqësimit, sa i përket përmirësimit të legjislacionit. Përfaqësimi me përbërjen e mëparshme parlamentare u zhvillua dhe zbatua përmes bashkëpunimit me Grupin Parlamentar Ndërpartiak për avancimin e të drejtave të personave LGBTI, i cili ishte mbështetja më e madhe në përfaqësimin e përgjithshëm për një legjislacion më të mirë për të drejtat LGBTI në vend, dhe ekzistenca e të cilit u bë e pasigurt me shpërndarjen e Kuvendit për shkak të zgjedhjeve të parakohshme parlamentare.

Ndërkohë, në maj të vitit 2020, Gjykata Kushtetuese vendosi të shfuqizojë Ligjin e miratuar mbi Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, për shkak të mungesës së shumicës së kërkuar në votimin e saj. Ligji u miratua në vitin 2019 pas një procesi të gjatë përfaqësimi dhe për herë të parë përfshinte orientimin seksual dhe identitetin gjinor si një bazë diskriminuese që duhet mbrojtur. Kjo krijoi një boshllëk në legjislacion, i cili rezultoi në një situatë edhe më të paqëndrueshme në lidhje me mbrojtjen e të drejtave të njeriut të komunitetit LGBTI gjatë kohës së një pandemie. Zgjedhjet u zhvilluan në muajin korrik, kurse Qeveria dhe Kuvendi i ri u formuan në muajin gusht. Pas formimit të Kuvendit, aktivitetet e përfaqësimit kishin për qëllim propozimin e sërishëm të ligjit dhe sigurimin e mbështetjes për miratimin e tij nga deputetët e sapo zgjedhur. Në të njëjtën kohë, problemi tjetër ekzistues që lindi me shfuqizimin e ligjit ishte zgjedhja e Komisionit për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi. Zgjedhja e një Komisioni të ri u shty përsëri përsëri derisa ligji të miratohej, që praktikisht do të thoshte se shteti qëndroi pa një organ të barazisë për më shumë se një vit. Në këtë drejtim, përveç miratimit të sërishëm të ligjit, përfaqësimi u shtri në zgjedhjen e një Komisioni të ri, si dhe në formimin e Grupit Parlamentar Ndër-Partiak. Pas një serie aktivitetesh përfaqësimi që kishin për qëllim përmbushjen e këtyre tri përparësive, Ligji Kundër Diskriminimit u miratua përsëri në muajin tetor, dhe kah fundi i vitit u bë një njoftim i ri për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit dhe një seancë konstituive u mbajt për të formuar Grupin Parlamentar Ndërpartiak, në të cilën morën pjesë 14 deputetë.

Në të njëjtën kohë, përfaqësimi për futjen e njohjes ligjore të gjinisë së personave transgjinorë në legjislacionin kombëtar vazhdoi gjatë gjithë vitit në nivelin kombëtar dhe ndërkombëtar. Projekt-ligji mori versionin e tij përfundimtar në fund të vitit 2020 dhe pritet të miratohet në gjysmën e parë të vitit 2021.

Gjuha e urrejtjes kundër personave LGBTI shënoi rritje gjatë vitit (më hollësisht në pjesën Gjuha e urrejtjes të këtij raporti) dhe në atë drejtim u përgatitën reagime të shumta nga Qendra së bashku me Rrjetin Kombëtar kundër Homofobisë dhe Transfobisë. Qendra për Mbështetje LGBTI vazhdoi të raportojë rregullisht mbi situatën e të drejtave të njeriut të personave LGBTI dhe dha kontributin e saj për raportin mbi situatën e të drejtave të njeriut të personave LGBTI në nivel të Evropës, përgatitur nga ILGA Europe, si dhe për raportin e Komisionit Evropian.

RAPORT VJETOR PËR TË

DREJTAT E NJERIUT

NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SE VERIUT
PËR VITIN 2020

